

CANCEL CULTURE (kultura e anulimit) NË OPTIKËN E IMZOT GJERGJ METËS, RITA PETROS DHE AZEM DELIUT



DEBATI MBI ANTOLOGJINË

NJË ANTOLOGJI QARTËSISHT E CUNGUAR

Nga Klara Kodra (fq. 7)

Replikë me akademikun Ali Aliu

SHKRIMI I NJË AKADEMIKU QË NUK IA VLEN TË HARROHET

Nga Rudolf Marku (fq. 6)

OBJEKSIONE DHE PËRSIATJE, ("VESHUN ME DIELL, MBATHUN ME HANË")

Nga Dr. Durim Çaça (fq. 8)

SHËNIME MBI LIBRAT

Romani "ESKADRONËT E VDEKJES" (Kronikë e një kasaphane), i Bardhyl Mahmutit

KAPËRCIM NËPËR NËNTË RRATHËT E FERRIT

Nga Xheladin Mjeku (fq. 14)

Romani "Eskadronët e vdekjes" mund të përkufizohet me një fjalë që shpalos gjithçka brenda këtij libri, ku vdekja dhe jeta bashkëveprojnë në çdo çast, për të zbërthyer një realitet që bota i bëri sehir për shekuj...

Studim krahasues i romanit "Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit" të Jusuf Buxhovit me rastin e botimit në frëngjisht nga "L'Harmattan" i Parisit

MIDIS KAMYSË DHE KADARESË

Nga Aleksander Zoto (fq. 13)

Shtjellimet që paraprijnë, sidoqoftë, e vertetojnë mjaftueshëm: ekzotizmi oriental nuk e bën romanin e Buxhovit një vepër thjeshtë argëtuese, një arratisje thjesht romaneske. Ngarkesa e tij emocionale dhe rëndësia e çështjeve që ai shtron, e mendimeve që ai ushqen, e prekin edhe më me siguri lexuesin...


Përgatiti Andreas Dushi

PËR Ç'ARSYE DHE SI E HARTOVA ANTOLOGJINË E POEZISË SË PËRSHPIRTSHME SHOIPE (1555 – 2019)

Nga Anton Nikë Berisha

Në Antologji kam përfshirë 104 poetë shqiptarë të të gjitha trojeve, të arbëresheve të Italisë dhe të diasporës, duke nisur nga Psalmet e Gjon Bdek Buzukut të botuara më 1555 në "Mesharin" e tij e deri në vitin 2019.

(fq. 4)



Profil i studiueses Floresha Dado

NJË JETË NË "PERBALLJE" ME SFIDAT LETRARE

Nga Ymer Çiraku (fq. 16)

PËR NJË "MBRETËRESHË" TË POEZISË

Bllaga Dimitrova

(2.01.1922 -- 2.05.2003)

Nga Abdurrahim Myftiu (fq. 22)



BIBLIOTEKË

Stefan Çapaliku (fq. 18)

Tri miniatura

Gjergji Mihallari (fq. 17)

Botë e çmendur

Lirika suedeze (fq. 20)

(Përktheu nga origjinali Qerim Raqi)

Harallamb Fandi (fq. 19)

Sa të bukur, sa të freskët
ishin trëndafilat

Dy zonat e mëdha të epikës sonë legjendare dhe dallimet midis tyre

Prof. as. dr. Anton Papeleka (fq. 10)

Në qoftë se këngët kreshnike shqiptare do të ishin huazuar nga sllavët e jugut, ato do të kishin një lëndë më arkaike dhe me shumë vlera poetike në një trevë fqinje me botën sllave dhe me një komunikim më intensiv me të, siç është zona lindore. Përkundrazi, vihet re se tekstet e mbledhura në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore paraqesim një trajtë më të zhvilluar, përmbajnë rinovime më të shumta sesa tekstet e zonës perëndimore...

CANCEL CULTURE (kultura e anulimit) NË OPTIKËN E IMZOT GJERGJ METËS, RITA PETROS DHE AZEM DELIUT

Përgatiti *Andreas Dushi*

Duke parë reagime dhe sjellje që imponojnë zhbërjen e disa tipareve thelbësore të një veprë arti me arsyetimin e të qenurit *korrekt me të gjithë* dhe të shmangies së diskriminimit, reduktimin e njeriut vetëm në seksualitetin e tij, gjithëpranimin etj., kërkuam të dinim çfarë mendojnë disa personalitete me një zë publik në Shqipëri për këto zhvillime digresive. Këto ditë, për shembull, librat e Virginia Woolf-it po ribotohen pa termin *negro* apo ato të Roald Dahl pa fjalën *shtrigë*. Gjithashtu po kërkohet të mbulohen apo hiqen nga muzeumet disa vepra arti... Pra, pak a shumë, kultura e krijuar dhe po gjykohej e parë nga një pikëpamje e sotshme *politikisht korrekte*.

Nga autorët e gjallë, dy shembuj që kishin dhe vijnë të kenë jeohë të fortë në publik, për hir të medieve si dhe nga vetë lexuesit janë ai i Salman Rushdie-s dhe ai i J.K. Rowling. Autori me një *fatwa* mbi vete për vite me radhë, vitin e shkuar u sulmua me thikë para një auditori që po mbushej me dëgjuesit e referimit të tij. Ndërsa autorja e "Harry Potter" prej vitesh mbart damkën e të qenurit *transofobe* pasi nuk bie dakord me ndërrimin e gjinisë para se të arrihet moshë e pjekurisë së individit. Të dy rastet kanë veçantitë e veta, i pari shumë i njohur nga të gjithë, unik për shekullin kur ndodhi, ndërsa i dyti shumë më larg të mpleksurit disi me botën e debatit në Shqipëri, ku ndryshimi i gjinisë diskutohet vetëm në studio televizive kur asgjë s'ka ndodhur dhe duhet diçka për të mbushur hapësirën e emisionit.

Paçka se Billy Bragg nuk do të ishte dakord me mua, J.K. Rowling po vuan një lloj bullizimi kolektiv pasi akuzohet se po bullizon një grupim të caktuar njerëzish, dhe kjo po ndodh në një arenë virtuale ku vetë *target-i* i interesuar është shumë pak i përfshirë. Ndërsa Rushdie vetë, prej thujse katër dekadash

tanimë e ka mbështetjen e të gjithë botës, të shprehur në shumë mënyra, mes të cilave edhe letra e famshme firmosur nga shkrimtërt më të mëdhenj të kohës.

Po t'i futemi një krahasimi mes dy rasteve, ngjashmëritë i gjejmë veçse në disa pika krejtësisht të diskutueshme si thelbësore ose të parëndësishme, prandaj shkrimi në vijim bazohet në disa raste të tjera, ku diskutimi nuk mund të realizohet duke u vendosur në një boshllëk gri, por vetëm në një anë, atë me ngjyrë të bardhë ose atë me ngjyrë të zezë.

Mendimi im si Andreas kornizohet vetëm në pak fjali, dhe pikërisht nevoja për ta shtrirë këtë çështje në një hapësirë më të gjerë përqasjesh të thjeshta e më të ndërlikuara, nxiti këtë shkrim ku ftova dhe pranuan Imzot Gjergj Meta, ipeshkëv i Rrëshenit dhe publicist i njohur; Rita Petro, shkrimtare e botuese si dhe Azem Deliu, shkrimtar nga Kosova, i ri në moshë dhe me plot risi në vepër. Ata i pyeta bazuar shembujt e pushimin nga puna të një drejtoreshe shkollë në Florida pse u tregoi nxënësve një fotografi të "Davidit" të Mikelanxhelos pasi kjo u quajt "nuditet"; tentativën për të rishkruar veprat e Virginia Wolf-it duke shmangur fjalët "zezak" dhe të tjera me natyrë diskriminuese... ndalimin e veprës së Dostojevskit si masë kundër Rusisë për agresionin e saj të pajustificuar ndaj Ukrainës etj.

Sipas meje, kjo dukuri është një prej lëvizjeve të përkohshme që nuk lënë ndonjë gjurmë domethënëse në rrjedhën e evoluimit të botës, artit dhe kulturës së saj si veçanti e secilit komb e në të njëjtën kohë, si tërësi për hir të globalizmit. Pikërisht globalizimi, kam përshtypjen se *ka marrë kot* por përkohësisht, dhe kjo *kotmarrje* ka sjellë këtë *kotsjellje* (po t'ia besojë krijimin e këtyre fjalëve parimeve të gjuhës së Orwell-it, jo pa qëllim: *Kultura e anulimit* më duket një manifest shumë pranë reales i asaj çka profetizonte Orwell-i).

Imzot Gjergj Meta duke e quajtur *Cancel culture* si antikulturë, thotë:

Nuk jam fort i sigurt nëse *cancel culture* është kthyer aktualisht në një fenomen masiv, por s'ka dyshim që përdoret fuqishëm nga grupime të ndryshme të tipit politik apo ideologjik. Kjo nuk do të thotë se shumë shpejt nuk mund të bëhet realitet pjesa e parë e fjalisë hyrëse. Megjithatë, "nuk ka asgjë të re nën diell", sikurse thotë libri i Kishtarit.



Në kuptimin zanafillor të saj, *cancel culture* ka të bëjë me botën virtuale dhe pikërisht me opsionin "cancel" në tastet fizike dhe/ose virtuale të një kompjuteri, tableti apo smartphone-i. Shprehur thjesht: ti fshin një koment prej postimeve të rrjeteve të ndryshme sociale apo heq dikë prej listës së miqve a të ndjekësve virtualë, sepse nuk i përshtatet mendimeve të tua, nuk bashkëndani të njëjtat interesa ose sepse iu qaset gjërave në mënyrë krejt të ndryshme dhe/ose të kundërt në krahasim me ty a thjesht sepse ti nuk e quan etik. Në këtë pikë, "cancel" dhe "censurë" janë sinonime. Kjo është një përvojë shumë njerëzore, që ka ngjarë edhe përpara se të ekzistonte kompjuteri, të cilën e shprehim metaforikisht me formulime të tipit: "Të kam fshi nga jeta ime," apo për të qenë më konkretë dhe praktikë, të cilën e kemi provuar sa e sa herë kur kemi fshirë me gomë gabimet në detyrat e shtëpisë apo të klasës.

Me kalimin e kohës, kjo lloj mendësie është shtrirë tek personat e ashtuquajtur "VIP-a", artistë, shkencëtarë apo politikanë, të cilët për shkak të një

fjalimi, një qëndrimi, një veprimi të papëlqyer, etj. "bojkotohen" nga fansat e tyre. Ajo ka mbërritur po ashtu edhe në fushën ekonomike. Kemi parasysh këtu bojkotimin e mallrave ose prodhimeve të një x vendi apo marke, jo për shkak të cilësisë së mallit, por për shkak të qëndrimeve politike, ekonomike apo ushtarake të atij vendi ose të asaj marke të caktuar.

Le të vazhdojmë tani me tipologjinë më të butë të *cancel culture*, e cila sipas mendimit tim, shkakton pasojat më afatgjata dhe konkretisht, e kam fjalën për rastet kur kjo e ashtuquajtur "kulturë" prek sferat e artit, letërsisë, filozofisë e shkencës. Edhe këtu nuk ka ndonjë gjë të re, nëse i referohemi faktit se një nga përkufizimet e ideologjisë është pikërisht "leximi i së kaluarës me kriteret interpretuese të së tashmes". Pak a shumë kjo ka ndodhur në fillimet e komunizmit në shumë vende ku janë dënuar fjala vjen priftërinj katolikë, duke i akuzuar për djegien e Giordano Bruno-s në turrën e druve, për Natën e Kristaleve apo për Kryqëzatat ose së paku janë përdorur si argumente sulmi ndaj tyre disa gjëra, shekuj më vonë pasi kanë ndodhur si ngjarje. E jo vetëm kaq, por gjatë komunizmit e në përgjithësi në sistemet diktatoriale, e kaluara modifikohet për të nxjerrë në pah diçka që nuk është e vërtetë ose një të vërtetë të ndryshuar, në mënyrë që t'i shërbejë mbajtjes së pushtetit dhe eliminimit (edhe kujtimor) të armiqve.

Kur flasim për *cancel culture* në kontekstin bashkëkohor, kemi të bëjmë me një fenomen që nisat kinse nga të drejtat e njeriut dhe nga moscënimi i dinjitetit të tij. Kur këto të fundit kthehen në ideologji, mëtojnë të modifikojnë jo vetëm të tashmen, por edhe të kaluarën. Në pamje të parë, motivi duket shumë fisnik: shmangia e një fjalori diskriminues, e shprehjeve ksenofobe, raciste apo seksfobe e kështu me radhë, për ta ruajtur të paprekur dinjitetin e një personi ose një grupi personash. Për më tepër, me të drejtë kërkohet që shprehje të tilla të mos përdoren në asnjë lloj ligjërimi publik, siç edhe me pa të drejtë, kërkohet që shprehje të tilla, nëse ekzistojnë, të fshihen nga tekste të ndryshme që janë shumë larg në kohë në krahasim me mendësinë aktuale.

Ky i fundit është një problem që sipas meje vjen për dy arsye thelbësore, të cilat do të mundohem t'i shpjegoj më poshtë.

Arsyeja e parë është kryekëput ideologjike. Aq e fortë bëhet një bindje dhe aq rrënjësisht ngulen në të disa grupime të caktuara, saqë ajo bindje bëhet fundamentale, duke u kthyer në fundamentalizëm dhe lobet përkatëse në fundamentaliste. Në këto lloj lobimesh nuk ekziston gjë tjetër veçse bindja apo interesi i tyre dhe në emër të atyre, ata mund të flijojnë gjithçka tjetër. Që Dante Alighieri mund të ketë pasur mendimin e tij, jo në përputhje me mendimet e sotshme, sa i përket fjala bie, Islamit apo homoseksualëve, kjo është e qartë, por që Dante Aligieri të ndalohej që të studiohet në shkollë ose t'i hiqen (fshihen) pjesë të veprave të tij për këtë shkak, kjo është ideologji e pastër dhe antikulturë. Lentet me të cilat shihet historia e kulturës, e letërsisë apo e filozofisë nga qarqe të tilla, është totalisht antihistorike dhe

antishkencore.

Ka dhe një arsye të dytë, që për mua është shumë më shqetësuese, ndonëse në dukje shumë praktike. Ka vite tashmë që në shumë institucione shkollore të perëndimit, raporti me klasiken ka humbur shumë. Klasike në përgjithësi është një vepër letrare, arti apo një autor i mendimit a i letërsisë, që i ka rezistuar kohës. Kështu, mund të quajmë klasik si Homerin ashtu edhe Hygo-në; si Platonin ashtu edhe Hegel-in apo Marx-in; si Giotto-n ashtu edhe Caravaggio-n, pavarësisht se në të gjitha rastet, çiftet e mësipërme i ndajnë shekuj. Prej disa kohësh, mësimi i gjuhëve klasike: greqisht e latinisht, por edhe i gjuhëve semite apo persishtes, gjuhë në të cilën janë shkruar tekstet zanafillore të njerëzimit, është gjithnjë e më i paktë, ndoshta edhe më i rrallë, jo vetëm në licetë klasike, por edhe në universitete. Kjo sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XX, gjë që ka sjellë dobësimin e cilësisë së atyre që kanë për detyrë të përcjellin dijet klasike tek studentët. Prandaj, munda i një pune studimore dhe hermeneutike zëvendësohet me *kulturën e fshirjes*, gjoja në emër të dinjitetit të personit.

Sot, një nga rrymat filozofike më të njohura dhe më avantgardë është *hermeneutika* apo thënë ndryshe *filozofia e gjuhësisë*. Ajo është e hershme dhe e ka zanafillën qysh në përpjekjet për të kuptuar *mens auctoris* në veprat e antikitetit grek (Homerit p.sh.). Zhvillohet dukshëm brenda krishtërit, për të kuptuar tekstet e shenjta, sidomos duke nisur me Reformën luterane. Pretendimi i një hermeneutike universale lindi diku nga shekulli XVIII, në ambientin gjerman, me Schleiermacher-in. Më vonë, kjo u shtri edhe në fusha të tjera tekstuale, sidomos në filozofi, letërsi dhe gjuhësi, duke arritur kulme të tilla si M. Heidegger, H. -G. Gadamer dhe P. Ricoeur.

Është më se e qartë atëherë se detyra e një mësuesi nuk është që t'i diktojë nxënësit se cilin kapitull të mësojë e cilin të fshijë e as të përcaktojë se cilat fjalë duhet t'i zëvendësojë me të tjera, meqenëse të parat janë fyese, por t'i shpjegojë atij fjala vjen, se pse Parmenidi në shekullin V p.K. apo Dante Alighieri në shekullin XIV, kanë thënë këtë apo atë shprehje, cili ka qenë *mens auctoris* dhe ta ndihmojë dishepullin e tij që nëpërmjet analizave filologjike, tekstuale dhe kontekstuale, ta kuptojë vetë vlerën e një fjale ose fjalie të ngulitur në një kontekst konkret historiko-kulturor.

Një mungesë e tillë, që unë do ta quaja *dembeli hermeneutike*, sjell në injorancë e kështu në trashëgiminë e saj tek brezat e ardhshëm. Derisa injoranca të jetë e pavetëdijshme, edhe mund të rikuperohet, por kur ajo bëhet e qëllimshme kthehet në kriminale.

Në fakt, historia e letërsisë, e filozofisë apo e njerëzimit në përgjithësi, i ngjan jetës personale. Nuk fshihet asgjë, sepse është e pamundur, por bëhen përpjekje për të kuptuar e integruar edhe çka nuk ka qenë bash krejt e drejtë në jetën tonë. Duke sintetizuar për sa thashë më sipër, mund të përfundoj me fjalët që *cancel culture* është një kulturë e mohuar, pra një antikulturë e që për mua do të thotë se *nuk është kulturë*.

RITA PETRO: Ca mendje të sëmura duan të na kthejnë në Mesjetë

Rastet që përmendni janë kaq shumë të pranishme sot dhe ne i hasim shumë shpesh në punën tonë me librat. Veçse janë shumë të ndryshme nga njëri-tjetri.

Rasti i mësueses në Florida që u tregoi nxënësve fotografi të Davidit të Mikelanxhelos dhe reagimin e kundërt që patën prindërit, mbledhja e bordit të shkollës dhe largimi i saj nga puna, është vërtet njëfarë tragjikomedie. Në shekullin e sotëm, kur zhvillimet teknologjike po ecin me shpejtësi marramendëse, dhe mendohet se dhe mendja njerëzore duhet t'i përgjigjet këtij zhvillimi, ca mendje të sëmura duan të na kthejnë në Mesjetë. T'i heqësh artit nuditetin, provokimin e bukur artistik dhe ta barazosh me pornografinë, kjo do të thotë që t'i lësh fëmijët pa formim thelbësor. Aq më tepër kur flitet për vepra të tilla gjigante. Kur e lexova këtë lajm m'u kujtuan dy raste teksa punonim me tekstet shkollore gjatë fundit të viteve '90 dhe fillimit të 2000-shit, kur dhe shoqëria jonë ishte hapur drejt Perëndimit. Së bashku me autorin që do të trajtonte pjesën e letërsisë moderne botërore po zgjidhnim disa ilustrime në përshtatje me jetën dhe analizën e poezisë së Bodlerit. Më pëlqeu jashtë mase skulptura kushtuar një prej të dashurave të tij, Apollonie Sabatier-it, (Gruaja e kafshuar nga një gjarpër; Auguste Clesinger) nudo e shtrirë me një lëvizje të zhdërvjellët trupi, aq shumë në përshtatje me logjikën poetike bodleriane. Teksa ia tregova bashkëpunëtorëve të mi, njëri prej tyre reagoi duke qeshur por dhe që tregonte frikë: -Do të na bëjnë namin për këtë imazh. -Jo, thashë – nuk ka mundësi, është art, jo poronografi. E lamë foton dhe me gjak të ngrirë prisnim ndonjë reagim, veçanërisht të prindërve.

Nuk ndodhi. Por, ama, ndodhi me një ilustrim në një atlas biologjie në klasën e 9-të. Sepse ishin nudo një djalë dhe një vajzë pranë njëri-tjetrit. Dhe ku, në një shpjegim shkencor?! Pra, reagimet e disa prindërve tregon se sa mendjembyllur janë disa prej tyre dhe politikat e edukimit nuk mund të shkojnë paralel me ta, përkundrazi. Raste të tilla mendoj se mbeten të izoluara. Fakti që shkolla në Florida u tërhoq pasi plasi skandali jo për mësuesen, por për masën që ata morën ndaj saj.

Rasti i dytë që lidhet me krijimtarinë e Virginia Wolf-it, mund të jetë shqetësues, por një libër mendoj se duhet të mbetet siç është në origjinal, aq më tepër kur kemi të bëjmë me një libër për të rritur. Në fund të fundit, këta libra janë edhe pasqyrë e kohës me kufizimet e veta, kur kanë shkruar shkrimtarët. Një autore aq e madhe si Wolf, që i jep dhe i flet aq fuqishëm lexuesit të sotëm dhe arrin t'i futet në shpirt e ta bëjë atë të ndiejë katarsis brenda vetes, nuk mund të ndikojë negativisht, pavarësisht disa etiketimeve apo qëndrimeve të asaj kohe. Nga ana tjetër, do të thosha se këto probleme ne i kemi hasur teksa përgatisnim kolanën me veprat e klasikëve për fëmijë. I njëjtë si rasti i Wolf, paraqitet dhe Mark Twain. Ka momente që ndihet një lloj racizmi tek ai. Është problem. Jemi munduar ta zbutim pak, veçanërisht dhe rastet e bullizmit shumë të theksuar dhe te ndonjë shkrimtar shqiptar për fëmijë para viteve '90. Më parë dhe personazhet negative për fëmijë thërriteshin me nofka që bullizoheshin. Sot kohët kanë ndryshuar. Nuk të lejon kush të thuash sakat për një person me aftësi ndryshe (disa vite më parë quheshin me aftësi të kufizuar). Gjithsesi një roman, një libër artistik duhet dalluar nga librat

didaktikë apo nga ata me karakter kulturologjik.

Në rastin e ndalimit të veprës së Dostojevskit kemi të bëjmë me censurë politike. Edhe në këtë rast mendjengushtësia e disa personave që marrin vendime dhe nuk arrijnë të dallojnë politikat e mbrapshta nga arti, se duan apo s'duan ata letërsia dhe arti i kanë kapërcyer vetë kufijtë dhe çdo ndalim ka qenë kaq i përkohshme dhe i kufizuar. Gjuha e Dostojevskit është aq universale sa edhe sot ngrihet kundër politikanëve (aktualisht Putinin), që nxisin te njerëzit e thjeshtë instinktin e dhunës dhe të krimit, në vend që t'i udhëheqin ata si liderë të vërtetë shpirtërorë drejt paqes.

Azem Deliu: Përndryshe, do të përfundojmë duke censuruar gjithçka



Unë besoj që veprat artistike, jo vetëm ato letrare, bartin me vete shenja të epokave nga të cilat kanë ardhur. Është e papërligjshme në sytë e mi, që për çfarëdo moraliteti të kohës së sotme, të lexojmë me syzet ideologjike të tashme tekste që burojnë nga botë e epoka të tjera.

Besimi se mund të ndërhyjmë duke censuruar atë që koha s'e ka hedhur vetë në kosh, përkundrazi e ka rikonfirmuar si vlerë, është shenjë e ndjenjës së vetëvlerësimit të tepërt të njeriut të sotëm.

Sidomos kur e ke parasysh që elementet që goditen te veprat e caktuara, fort shpesh nuk janë fare qëndrore, përkundrazi. Nuk dua të them që duke mos qenë qëndrore këto elemente nuk reflektojnë bindje të papranueshme me standardin e sotëm, por dua të them që këto bindje, nëse s'i ndajmë, s'kanë pse na shqetësojnë.

Përndryshe, do të përfundojmë duke censuruar gjithçka sepse çdokund mund të gjejmë diçka nga e cila të fyhesh, nëse e sheh me syzet e duhura.



I.

Poezitë kushtuar Zotit – Hyjit dhe Mbretërisë hyjnore bëjnë një pjesë të rëndësishme të qenësisë dhe të zhvillimit të poezisë sonë shqipe në rrjedhë të qindvjetshave. Përkundër kësaj të dhëne atyre nuk iu kushtua kujdesi i duhur, qoftë në rrafshin e botimit, qoftë në rrafshin e studimit. Botimi i vëllimit *Burim drite e dashurie - Antologji e poezisë së përshpirtshme shqipe 1618-1998* (Shpresa 1999), ku qenë përfshirë 223 tekste të zgjedhur nga veprat e 70 poetëve, e plotësoi sado pak këtë zbrazëti. Zgjedhja gjakoi të përmbushte, pos tjerash, dy qëllime kryesore:

a) Njohjen me një numër të mirë tekstesh të poezive të përshpirtshme shqipe, të shkruara dhe të botuara në periudhën kohore prej 380 vjetësh, që cilësohen, qoftë për shtjellime të ngritura tekstore, shprehëse e poetike, qoftë për shumësinë kuptimore dhe pasurinë tematike dhe

b) cytjen e studimit më të gjithanshëm e më të plotë të kësaj pjese të rëndësishme të poezisë sonë në vijën vertikale.

Derisa qëllimi i parë përmbushet me tekstet e botuara, të krijuara në kohë e në rrethana të ndryshme, e dyti mbetet edhe më tej detyrë e studiuesve të letërsisë dhe e kritikëve letrarë.


Vëllimi *Antologji e poezisë së përshpirtshme shqipe 1555 – 2019*, që po del në dritë nga shtëpia botuese “Faik Konica” e Prishtinës, synon ta pasurojë këtë traditë; në të janë përfshirë 105 poetë, duke filluar nga viti 1555 e deri në vitin 2019.

*

Poetët shqiptarë, qoftë të traditës gojore, qoftë të traditës së shkruar, pos dukurive të shumta të jetës së përditshme, të natyrës dhe të botës së brendshme, bënë objekt trajtimi artistik Zotin dhe Mbretërinë hyjnore. Vepruan në këtë mënyrë për arsye se Hyji dhe besimi në hiri e Tij qe dhe mbeti pjesë e pandashme e gjallimit të poetëve tanë dhe e njerëzve tanë në përgjithësi, e veprimit dhe e mendimit të tyre. Këtë e thoshte dhe Atë Anton Harapi në veprën e tij “Vlerë shpirtërore” (Shkodër 1936): “Shpirti i shqiptarit, me gjithë besimet e ndryshme, e ndien fuqishëm se një i njejtë Zot i vërtetë asht, Zoti i muhamedanëve, Zoti i ortodoksëve e Zoti i katolikëve. Në sajë të një Zoti, Babë i mirë, i drejtë për të gjithë, na jemi vllazën, pse jemi të gjithë bijtë e një Zoti qi na ka falë. Pra Zoti i të gjithë neve, e na të gjithë të Zotit. Në themel të këtij imperativi na jemi një”.

Ky besim shprehet nga fakti i qenësishëm: afrimi dhe njësimi me Hyjin shenjëzon në qenësi dashurinë, mirësinë, mirëkuptimin dhe pasurinë shpirtërore. Kjo përligjet dhe nga mendimi “*Ji i përsosur siç është i përsosur Ati yt*”, parim ku mbështetën dhe poetët shqiptarë të këtyre poezive dhe mbi bazën e të cilit ato u përfatuan.

Trajtimi artistik i botës dhe i fatit të njeriut përballë mëshirësisë dhe dashurisë së Hyjit, përpjekja për ngritjen



e mirëqenies dhe të fisnikërimit sa më të plotë, gjakimi për pasurimin e pareshtur shpirtëror e artistik, nënkupton me një anë shpalimin dhe shqiptimin e ndjesive më të qenësishme dhe më të fshehta të njeriut, dhe më anë tjetër, domosdonë që ai ta kuptojë më mirë vetveten, të përsoset vijimisht, po njëherit të aftësohet për ta kuptuar, për ta ndjerë, për ta nderuar e për ta

çmuar edhe tjetrin. Së këndejmi, duke bërë objekt trajtimi artistik Zotin dhe Mbretërinë hyjnore, dritësinë, fuqinë dhe ngushëllimin që jep besimi në Hyjin për përballimin e vështirësive të jetës së përditshme, poetët shqiptarë dëshmuar, pos tjerash, aftësinë, shkathtësinë dhe guximin e tyre të merren me çështje sa thelbësore aq edhe të ndërliqshme të botës e të njeriut.



Në këto krijime të përshpirtshme shqiptohet qenësia e së vërtetës, e drejtësisë dhe e dashurisë; ndriçohet rëndësia e mbajtjes gjallë të parimit se kush i shërben mirësisë dhe të vërtetës, në qenësi i shërben dhe e don Perëndinë. Pra, ai që e dashuron Hyjin, në të vërtetë, e dashuron dhe e çmon së pari veten, njeriun e vet, atdheun dhe kombin që i përket e pastaj edhe të tjerët, njeriun kudo dhe kushdo qoftë ai. Pikërisht besimi në Hyjin dhe dashuria për Të dhe nevoja që kjo dashuri të zbatohet e të mbretërojë midis njerëzve, shpreh një nga qenësitë kryesore të mesazheve të këtyre poezive. Në to del ajo që e thekson me shumë të drejtë Branko Merxhani: “Dhe para se të mësojmë të mendohemi, duhet të mësojmë të dashurohemi. Duhet të mësojmë të besojmë” ose siç thoshte Nëna Tereze: “Të besosh domethënë të jetosh [...] Besimi është e vetmja gjë që qenësisht është e jona¹ [...] Feja është një dhuratë e Zotit. Pa të nuk mund të kishte jetë. Vepra jonë, për të dhënë fryt, që të mos i përkasë kujt tjetër pos Zotit, për të qenë e bukur, duhet të jetë e ndërtuar mbi fenë”.

Nevoja e besimit në Zotin, në të vërtetë nënkupton kërkesën e ndërgjegjësimit të individit për veprimet që bën ai në jetën e përditshme, pikërisht atë që vë në dukje Nietzsche (Niçe): “Çdo njeri, çdo popull, që të jetojë dhe të tregojë (dëshmojë) vetveten, para së gjithash, duhet të rregullojë kaosin, që gjendet brenda unit të tij”.

Në qenësinë e këtyre krijesave e të mesazheve poetike të tyre shprehet në mënyrë të thellë njësimi shpirtëror dhe mendor me Hyjin, me dashurinë, me mirësinë e me përvujtërinë - dëshmohet se “[...] *kurgja nuk na vllaznon ma fort se Zoti*” (Anton Harapi). Në to përligjet pandërmjetësisht ajo që ndjejnë dhe mendojnë poetët tanë e që është pjesë e shpirtit, e mendimit dhe e veprimit të tyre konkret jetësor; ata nuk dalin ligjëruar dhe mësues, po dëshmitarë të hirit të Zotit dhe të bashkimit me Zotin (Papa Pali IV thoshte: “*Kemi më shumë nevojë për dëshmitarë sesa për mësues*”).

Në qoftë se këtë dëshirojmë ta shprehim me gjuhën e artit të fjalës, atëherë themi se këto poezi janë shqiptim dhe dëshmi e besëlidhjes shpirtërore e artistike e poetëve tanë me dritën dhe dashurinë e hirit të Zotit, besëlidhje me frymëzimin hyjnor dhe me të vërtetën hyjnore, që kanë një rëndësi të pazëvendësueshme për jetën e njeriut. Së këndejmi, nëpërmjet vështirimit të së vërtetës e të dashurisë së Hyjit e të shenjtërve të tjerë, pastaj nëpërmjet theksimit të bukurisë së Shën Mërisë ose të Krishtit fëmijë, në të vërtetë shprehet qenësia e jetës, e besimit, gjakohet dhe njëherit përligjet në artin e fjalës e madhërishtja dhe e bukura shpirtërore – metafizike.

Përshpirtshmëria në këto poezi shprehet si qenësi gjallimi, si gjakim për vetëpasurim, si përtëritje, po edhe si mundësi njohjeje thellësore

¹ *Thirsting for God. A Yearbook of Prayers, Meditations, Anevdots*, Edited by Angelo Devananda Scolozzi, Servan Books, Ann Arbor (USA) 2000, f. 114. Shih Gloria Germani, *Teresa di Calcutta una mistica tra Oriente e Occidente*. Paoline, Milano 2003, f. 195.

² Madre Teresa di Calcutta, *Tu mi porti l'amore. Scritti spirituali*. Città Nuova Editrice, Roma, X edizione, 2005, f. 8.

të fshehtësisë (misterit) shpirtëror, të botës dhe të natyrës; ajo, thënë poetikisht, shenjëzon frymëmarrjen shpirtërore të njeriut në shtegtimin e shkurtër të jetës tokësore; perceptohet e shqiptohet si shpërndërrim i jetës së përditshme (si vrazhdësi e ashpërsi) me ëndrrën e saj, me atë që gjakohet e përfytyrohet.

Nevojën e përshpirtshmërisë – të besimit në Hyjin – poetët tanë e vëzhgojnë në rrafshin shpirtëror dhe në rrafshin konkret. Me një anë, krijesat e tyre artistike shprehin nevojën e afrimit dhe të njësimi me hirin e Zotit, me ngritjen dhe pasurimin e botës shpirtërore, e cila ndërlidhet ngushtë me jetën qiellore, me qetësinë dhe përjetësinë e shpirtit: *Atjë shpirti s’ká të ngímun, / áisht një dét gjith núr lulzimesh* (Leonardo De Martino) dhe, më anë tjetër, shenjëzojnë qenësinë e shëlbimit dhe të mëshirës së Perëndisë në jetën e mbidheshme të njeriut vdekatar.

Ky përcaktim dhe ky përnjësim vërehet që në katër psalmet – poezitë e hartuara nga Gjon Bdek Buzuku, të botuara më 1555 në veprën “Meshari”³. Përmes tyre ai donte ta lavdëronte Hyjin krijues për dashurinë dhe besnikërinë e tij të amshuar ndaj krijesës së vet⁴.

II.

Në *Antologjinë e poezisë së përshpirtshme shqipe 1555 – 2019* përfshiva disa nga poezitë artistikisht më të ngritura të poetëve shqiptarë që i kushtohen Zotit – Hyjit dhe Mbretërisë hyjnore, që brenda krijimtarisë së tyre me këtë tematikë, paraqesin krijesat më cilësore, qoftë si shtjellime tekstore, qoftë si pasuri shprehëse poetike, si kumte poetike. Mora kryesisht autorët që kanë bërë emër si poetë, një pjesë e madhe e të cilëve, pa pikë dyshimi, paraqesin kulmet e artit poetik shqiptar si De Rada, Santori, Skiroi, Mjedja, Fishta, Poradeci, Noli, Asdreni, Ujko, Perrone, Camaj, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Ramadan Musliu, Visar Zhiti, Preç Zogaj, Agim Mato, Visar Zhiti, Sabit Rrustemi, Flutura Açka, Mimoza Erebara, Agron Tufa etj. Në dy-tre raste përfshiva edhe poezitë e autorëve që janë të njohur në botën shqiptare, po jo dhe si poetë, si, fjala vjen, Pjetër Bogdani dhe Aleksandër Sirdani. Një numër poezish me temë të përshpirtshme të autorëve pak të njohur, të botuara në revista e gazeta të ndryshme, nuk i mora, edhe pse si të tilla, si vlera, ato kanë mundur të kenë vendin në këtë zgjedhje.

Vëllimi zë fill me poezitë e Gjon Bdek Buzukut – katër Psalmet e hartuara nga ai⁵, që e lidhin letërsinë tonë me një traditë të lashtë të poezisë së *Biblës së Vjetër*, pastaj me poezitë e Pjetër Budit, të botuara më 1618, i cili



më të drejtë çmohet poeti ynë i parë i mirëfilltë i njohur deri më sot (pa hequr nga mendja të dhënë e përmendur nga vetë Budi se ai i kishte shfrytëzuar edhe poezitë në dorëshkrim të Pal Hasit, një poet shqiptar për të cilin dihet fare pak) dhe mbaron me poezitë e botuara në vitin 2019 – me poezitë e Elisa Velaj, një kohëzgjatje prej mbi katër shekuj e gjysmë. Natyrisht, nuk i mora poezitë e poetëve tanë të shkruara në gjuhë të huaja, as shqipërimet ose përshtatjet e poezive, as poezinë në njëmbëdhjetërrokësh nga vepra *E mbësuar e krështerë* (1592) e Lekë Matrëngës.

Nga disa poetë si, fjala vjen, Leonardo De Martino, Françesk A. Santori, Naim Frashëri, Zef Skiroi, Fishta, Asdreni, Vinçenc Prennushi, Fan S. Noli etj. mora më shumë poezi për arsye se mundësia e zgjedhjes që më e madhe dhe vlera e tyre poetike më e ngritur.

Poezitë në këtë *Antologji* botohen sipas botimeve – veprave të poetëve ose të marra nga revistat “Hylli i Dritës”, “Leka”, “Shëjzat” etj., ku ato u botuan për herën e parë, si u veprua me poezitë e Pjetër Zarishit, Ndje Mjedjes, Aleksander Sirdanit e të ndonjë tjetri.

Në raste më të shpeshta shfrytëzova botimet e para ose ato që janë besnike origjinalit. Botimet e bëra në Tiranë e Prishtinë gjatë kohës së sistemit komunist (të Prishtinës shpesh ribotime të Tiranës) mjerisht, nuk janë të sakta; në to janë bërë ndryshime, jo vetëm të pikësimeve, veçmas të theksave (madje edhe në poezitë e Naimit e të Poradecit!), po edhe të natyrave të tjera, prandaj këto botime i përdora vetëm atëherë kur nuk pata rrugëdalje tjetër.

Ndreqa ndonjë gabim shtypi dhe njësova sidomos shenjat e theksave. Aty-këtu shtova edhe ndonjë shenjë pikësimi.

*O Zot i gjallëvet e i vdekunet,
Shelbuosi i gjithëve,
qi ti z do mortnë e t përkatënuomit,
ma aj të konvertonetë e të gjellinjë, ndijemë,
u t̄y të lus, e m ī afërë muo Dom Gjonit.
E muo shkatëro të shkruomitë e gjithë katet mive.
E t̄y tue t u pëlqyem, përzë oratëtë e mī
qi u m t̄y përdā, për muo
e për gjithë njerëzit të mī ̄ jakut sim,
e për miq të mī e pr anëmiqt të mī,
për të gjallë porsi për të vdekurnitë.*

(Nga Gjon Bdek Buzuku, “Meshari”, XIX)

Sqarimet e fjalëve më pak të njohura te disa poezi i dhashë se ashtu ishin në origjinal.

Renditjen e autorëve e bëra sipas datëlindjes e jo sipas datës së shkrimit dhe të botimit të poezive, që do të ishte më e rëndësishme, po më e vështirë për t’u përmbushur për arsye se shpesh mungojnë të dhënat e sakta. Renditjen e poezive të një autori e bëra herë në bazë të rëndësisë e të veçantisë poetike, herë sipas afrisë dhe ngjasimit shprehës kuptimor.

Disa poezi, që nuk ishin të emërtuara, i emërtova në bazë të vargut të parë ose të ndonjë vargu tjetër që shpreh ose synon të shprehë ndonjë nga qenësitë e poezisë përkatëse. Për shkak të përsëritjeve ose për të shprehur më plotësisht qenësinë e krijimit përkatës, shkurtova ose ndërrova titullin e ndonjë poezie.

Në disa raste, kur pozitë qenë të gjata, për shkak të natyrës së vëllimit, qeshë i detyruar të merrja vetëm ndonjë pjesë të tyre, prandaj ato këtu nuk e kanë vlerën që e kanë në botimet origjinale, ku janë të plota. Shkurtime të shënova me shenjë [...]

Transkriptimin e disa teksteve arbëreshe e bëra vetë, pa zbatuar ndonjë kriter të rreptë shkencor, disa të tjera i shfrytëzova nga botimet e mëparshme, me ndonjë ndryshim të vogël. Në pak raste (sidomos në tekstet e Fishtës dhe të Skiroit) y-në me theks hundor e zëvendësova me y-në me theks të gjatë (ý).

Përfshiva edhe pak poezi, në të cilat mbipeshon atdhedashuria si, fjala vjen, ato kushtuar 28 Nëntorit - Ditës së republikës, shqiptarit, gjuhës, flamurit e të ngjashme. Veprovë në këtë mënyrë për arsye se këto (si shenjëzime dhe objekte artistike) trajtohen e shqiptohen para së gjithash si krijesa të Zotit, si vepra të Hyjit. Me fjalë të tjera, në to Zoti nuk përmendet rastësisht dhe nuk del vetëm si emër, po si qenësi, si krijues dhe përcaktues i Shqipërisë, i gjuhës, i flamurit shqiptar dhe i fatit të shqiptarëve.

Për përgatitjen e këtij vëllimi zgjodha edhe disa poezi në dorëshkrim, të lëna nga poetë të vdekur, si ato të Frangjisk Anton Santorit, ose të dërguara nga poetë bashkëkohorë (të shënuara në Burimet). Pra, në këtë *Antologji* botohen për herën rreth 30 poezi.

Për mirëkuptimin dhe besimin e treguar të poetëve bashkëkohorë ndaj punës sime, duke m’i dërguar poezitë e pabotuara, u shpreh mirënjohjen time të thellë.

Meqenëse në këtë vëllim përfshihen poezitë e 104 autorëve, të botuara brenda një kohe mbi 450 vjet, punën në përgatitjen e tij e përcollën dhe e cilësuan vështirësi të ndryshme, shpesh jo të lehta të kapërcehen. S’ka dyshim se kanë mbetur dhe autorë dhe poezi të tjera, që kanë mundur të gjejnë vend në këtë zgjedhje, sidomos ato të botuara në vitet e fundit.

Duke qenë i vetëdijshëm për këtë gjë, kërkoj ndjesë dhe mirëkuptim nga autorët dhe lexuesit për mangësitë që do t’i hetojnë. Së këndejmi, i mirëpres me nderim vërejtjet dhe sugjerimet e tyre dhe do t’i kem parasysh me rastin e ndonjë botimi të ri të mundshëm të kësaj *Antologjie*.

3 Shi më gjerësisht për këtë studimin tim “Meshari” – *vepër e hartuar nga Gjon Buzuku*. Fondazione Universitaria “Francesco Solano”. Comet Editore Press. Cosenza 2014. Shih dhe botimin e dytë “Faik Konica”, Prishtinë 2014.

4 Shih më gjerësisht parathënien time me titull “Qenësia e Hyjit dhe e mbretërisë hyjnore në poezinë tonë, f. 7 – 29.

5 Shih dhe tekste të tjera të Buzukut në studimin tim *Gjon Buzuku poeti ynë i parë*. Studim. Faik Konica, Prishtinë 2016. Botimi i dytë Pellegrini Editore, Cosenza 2016 dhe “Meshari” – *vepër e hartuar nga Gjon Buzuku*. Fondazione Universitaria “Francesco Solano”. Comet Editore Press. Cosenza 2014. Botimi i dytë “Faik Konica”, Prishtinë 2014.

Në numrin e kaluar të gazetes Exlibris (e Shtunë, 22 Prill 2023, Numër 229), në faqen 11, është botuar dhe një shkrim i akademikut Ali Aliu, "Antologjia e Rudolf Markut, një zhgënjim që duhet harruar". Shkrimi, (dhe vetë autori), ndonëse është një shënim i shkurtë gazetaresk, lajmërohet me gërma të mëdha, dhe sinjifikativisht, me gërma të kuqe, në faqen e parë të Gazetës, duke nënkuptuar me këtë se Ali Aliu është një ndër autorët më të respektuar, nga titulli i lartë akademik, ose dhe nga kontributi i madh i artikullshkruesit në fushën ku ai fituar titullin e lartë të nderuar akademik, ose dhe nga vetë pritshmëria për artikullin e botuar.

Në fakt, pasi e lexon shkrimin, vë re se ky shërbim që i bëhet këtij akademiku me emër të dyfishtë, dhe të katërfisht nga përkatësia (lindur në Shkup, studjuar në Beograd, doktoratuar në Prishtinë dhe me ec e jakje të panderprera në Tiranë), të lë një shije të keqe, për ato që thotë, dhe për ato se si i thotë!.

Profesor Ali Aliu është një emër jo i panjohur në shtypin shqiptar. Por është një nga emrat paradoksalisht të njohur nga se janë krejtësisht të panjohur, ngase askush nuk e ka të qartë se cili është kontributi i tyre në kulturën shqiptare. Emëra të cilët i pranojmë thjesht se duhen pranuar, ngase "ata janë ata që janë,- siç thotë një poet anglez për politikanët e vendit të vet! Me pak fjalë, ashtu siç ndodh jo rrallë tek ne, profesor Ali Aliu është i njohur pikërisht se askush nuk e njeh!

Nga shënimet biografike për autorin, mësoj se akademiku Aliu, falë një ngjashmërie a një paracaktueshmërie të dublikimit të emrit- Ali Ali-, ka një veprimtari çuditërisht të dublikuar profesionalisht me të kundërtat- mbaron studimet në Universitetin e Beogradit, në vitin 1960, dhe përfundon Doktoraturen, plot 13 vite më vonë, në Universitetin e Prishtinës. Ishte, që nga viti 1972, ligjërues në Fakultetin e Filozofisë, ku ka ligjëruar Teorinë e letersisë, dhe në të njëjten kohë në shkrimin që boton tregon një mosnjohje të dukshme të teorisë së letersisë. Them kështu, se në shkrimin e vet kundër Antologjisë së Poezisë Moderne Shqipe nuk mund të gjesht qoftë dhe një fjalë të vetme a një term të vetëm që të ketë lidhje me teorinë e letersisë. E pra, ky është një shkrim kundër botimit të një Antologjie Poetike, gjë që do t'i jepte shansin akademik Ali Aliut, të shpaloste dijet e veta për të argumentuar prapshinë e Librit që ka marr përsipër ta diskretitojë. Por ai, çuditërisht, ashtu si dhe disa kolegë të vet të rrjeshtuar së bashku në të njëjtën llogore kundër Antologjisë, ka preferuar të luftojë brenda fushës së letersisë me armët asgjësuese të politikës!!!

Në 1996 Ali Aliu zgjidhet anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Është studiues i letersisë bashkëkohore shqiptare, por është dhe Themelues i LDK dhe ka drejtuar zyrën e Kosovës së LDKsë në Tiranë deri në vitin 1991. Aktualisht ligjëron në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Të paktën, derisa del në pension.

Në shkrimin e tij, zoti Ali Aliu, si një udhëheqës i dikurshëm autoritar, na kujton se si vepra "Antologji e poezisë moderne shqipe" e Rudolf Markut i ka sjellur ndërmend një kujtim të hidhur nga vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar: se si një botuesi maqedonas në Shkup Ali Aliu i ka ofruar për botim një antologji të poezisë bashkëkohor shqipe, e se ai, botuesi maqedonas, e pranoi; se si u zgjodh grupi i përkthyesve

Një replikë me akademikun Ali Aliu

SHKRIMI I NJË AKADEMIKU QË NUK IA VLEN TË HARROHET

Nga Rudolf Marku

nga gjuha shqipe në maqedonisht, dhe pas disa muajve dorëshkrimi shkoi për radhitje në shtypshkronjën e njohur Goce Dellçev; por se, në procesin e lidhjes, një politikan i lartë shqiptar, (S.S.), e denoncoi përmbajtjen e antologjisë, e cila u tërhoq dhe u ndalua, me akuzën se në të janë përfshirë poetë nga shteti (armiqësor) shqiptar dhe, si e tillë synon Shqipërinë e madhe.... Ali Aliu pastaj e përfundon këtë rrëfënjë me një Happy-End-, se si ajo antologji, me tridhjetë e një poetë, rreth gjysma nga Shqipëria, pa dritë në Shkup pas afro tridhjetë viteve, më 2001. Dhe një vit më vonë, pra më 2002, me plus tetë poetë të rinj, u botua edhe nga shtëpia botuese Albin në Tiranë... Por atë që nuk e thotë akademiku Ali Aliu është një fakt shumë interesant që lidhet pikërisht me këtë Antologji që ai vetë e përmend si një vepër me të cilën ka bindje shumë të forta se jo vetëm ka arsye të krenohet, por dhe

e sjell si antipod të Antologjisë së Poezisë Moderne Shqipe, hartuar nga Rudolf Marku. Mendoj se duhet ta kujtojmë këtë Antologji të Ali Aliut, fillimisht botuar në vitin 1996 në Shkup, vit kur ai është zgjedhur dhe anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, edhe për një arsye tjetër, ngase Revista prestigjioze 'Hylli i Dritës, Vjeti XXIV, 1996, Nr 5-6 (240-241), pat botuar një shkrim memorable në lidhje me botimin e Ali Aliut, përmes kryeartikullit të titulluar "Anno Domini 1997,.. Mes të tjerash, në këtë kryeartikull lexojmë:


E dimë se, si ne vjetët 1991, 1992, 1993, 1994, 1995, as ne vitin 1996 lexuesi nuk kishte kohë për të bjerrur. Të kishte, do ta ftonim t'ia hidhte një sy librecit të botuar tash n'e së voni në Skopje të Maqedonisë me titull pretencioz Sovremena poezija na Albanija, që në shqip po donte me thënë

diçka si 'Poezia bashkëkohore e Shqipërisë'. U përgadit kjo vepër vetëm prej njërit nga doktorët e panumërt të kulturës 'shqiptare,- dr. Ali Aliut. Nuk e dimë sigure nëse ky Ali në katror është po ai që tash dyzet vjet stërkalat fletoret letrare e politike si shkrues recensionesh për librat dalë taze në çarshi të Shkupit a të Prishtinës. Çka dimë është se për doktorin e vitit 1996, poezia 'sovremena, shqipe po fillonte me Seremben e po vijonte me N. Frashërin, N. Mjeden, F.S. Nolin, L. Poradecin, për të kërcyer pupthi e te... realizmi socialist.

Edhe gjatë vitit 1996 pra, nuk mungoi një kritik kërcuq...që vazhdoi ta rrejë mendja se mjaftuakësh një 'izbor, a një 'voved, për t'i shuar prej faqeve të poezisë shqipe emra zulmëmëdhenj: të (Budit e Bogdanit dhe) Gjergj Fishtës, Ali Asllanit, Vinçens Prenmushit, Lazër Shantojës, Ernest Koliqit, deri te lirikë vizlues ditësh tona si Camaj, Trebeshina apo Bilal Xhaferri...

Artikulli përfundon duke na kujtuar një këshillë të At Gjergj Fishtës, të përjashtuarit të madh nga Antologjia Shqipe e akademikut të vogël: "të gjithë njatà qi e kanë me detyrë, si dhe ata qi ia kanë vu vedit me detyrë me organizue jetën shoqnore e të gjytetnueme në Shqypni, per n'daçin pernjimend bashkimin e kombit shqyptar, pà të cillin bashkim nuk mund të perbahet kurr një komb i gjytetnuem, má së parit të caktojnë se mbas të cillës kulturë duen me e organizue kombin shqyptar, e mbasandej me ligjë, me punë e me kohë të mundohen me i ba shqyptarët qi të mendojnë e të veprojnë mbas parimesh t'asaj kulture..."

Artikullshkruesi i 'Hyllit të Dritës, në fakt është treguar zemërgjërë, sa kohë që nuk i ka shkruar ndërmend të ankohej dhe për mungesën e Pjeter Budit e të Pjetër Bogdanit në Antologjinë e Aliut. Emrat e tyre, në fjalinë e mësipërme, të futur në kllapa, janë shtuar prej meje! Dhe më duket e drejtë dhe me vend risjellja e fjalëve të Fishtës. Sepse të përjashtosh Budin, Bogdanin dhe Fishtën prej Historisë së Letersisë Shqipe, jo në vitin 1972 e as në vitet 1980 a në vitet 1985, po në vitin 1996 a në vitin 2001, apo ta akuzosh Bogdanin në mënyren më groteske si një plagjiat të Biblës, siç bën dhe sivellai i vogël i Ali Aliut, Sokol Çungu, në artikullin e vet, tani kur mbarëshqiptarët nuk janë të detyruar t'i përcaktojnë zgjedhjet e tyre sipas melodive të censurës komuniste të Tiranës a asaj të Beogradit a Shkupit dhe Podgoricës- ky përjashtim i autorëve madhorë të letersisë shqipe është thjesht një akt i përcaktuar prej shijeve a ca bindjeve personale fondementaliste, dhe është konfuzioni intelektual dhe shpirtnor i mospërcaktimit se "mbas cilës kulturë dhe gjyqetnim duen me shkue disa shqiptarë".



...Është thënë dhe më parë, se katalogët e Bibliotekes Kombëtare të Tiranës (pa përfshirë- Prishtinën- Shkupin dhe Podgoricën) dëshmojnë, veç gjatë tridhjet viteve të fundit, afërsisht që nga viti 1996, kohë e botimit të Antologjisë së Ali Aliut në maqedonisht, Shkup, e deri më sot, botimin e 380 Antologjive të Poezisë Shqipe, me autorë nga më të ndryshmit. Pyetja ime do të që: Cilët autorë, zoti akademik, ke përfshirë në Antologjitë tuaja të mëvonshme nga letersia Shqipe? Dhe sidomos cilat poezi nga këto autorë? Dhe cili ishte impakti i botimit të këtyre Antologjive në promovimin e vlerave të Poezisë Shqipe te lexuesi mbarëpërfshirës shqiptar dhe te lexuesi i Huaj? E bëj këtë pyetje, sepse shumica e Antologjive të Poezisë Shqipe, sponsorizuar, siç i ka qejfi akademikut ta theksojë, nga fondet e Ministrisë së Kulturës shqiptare (dhe mund t'i vija në ndihmë kujteses së zotit Ali Aliu, pa përjashtuar dhe sponsorizimet me fondet e Ministrisë së Kulturës Serbe, Maqedonase, dhe asaj të Malit të Zi) me anonimin e tyre të mosvlerave, jo vetëm që nuk kanë kontribuar në promovimin me dinjitet të Poezisë Shqipe, por kanë bërë të kundërtën, duke e diskretituar, me zgjedhjet me të këqia prej Antologjistëve si professor Ali Aliu, poezinë Shqipe dhe vlerat e saj! Kam parasysh dhe shumë Antologji të tjera të botuara duke lënë jashtë përfaqësimit poetë si Zef Zorba, Martin Camaj, Frederik Reshpja, Trifon Gjashikaj, Vilson Blloshmi, Genc Leka, e shumë e shumë të tjerë, pa përmendur autorët klasikë të poezisë Shqipe, të përjashtuar ose, të keqpërfaqësuar, me poezitë e tyre më mesatare.

Por professor Ali Aliut i ka shkruar ndërmend t'i japë një mesim të mirë patriotik Rudolf Markut. Ai shkruan: *Në vitin 2023, në Tiranë, botohet një antologji e poezisë shqipe, pa gjysmën e saj, që të le pa fjalë; mendësi që të sjell në kujtesë politikën e Beogradit, ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe në ish Jugosllavi, përmes së cilës afirmonte idenë se ne, në Kosovë jemi botë ndryshe nga ajo e Shqipërisë, që kemi një tjetër gjuhë, një tjetër histori, etni..., ngjashëm me këtë të antologjisë së Rudolf Markut... Një zhgënjim që duhet të harrohet! Pse e bën këtë Rudolfi? Ne, të zemëruarit, nuk kemi të drejtë të kërkojmë nga ai, që të ndryshojë qëndrim, bindje, të heqë dorë nga antologjia e vet, nuk kërkojmë të pamundurën, të heqë dorë nga vepra e vet, që ai të mos jetë i tillë çfarë është, por kemi të drejtë dhe obligim t'i shtrojmë pyetje: pse mendon, pse vendosi t'a heqë gjysmën e poezisë shqipe, nga tërësia e saj!*

Nuk është e çuditshme, madje është logjike, që akuzat për mosbindje patriotike të vijnë nga njerëz të lidhur ngushtë me strukturat e dikurshme të Beogradit, të Shkupit dhe të Podgoricës. Ali Aliu nuk harron të mërmëris refrenit e preferuar të tij: *...Dhe ai (R.M) e ka hartuar dhe botuar këtë Antologji me fondet e Ministrisë së Kulturës...*

Vetë Ail Aliu, me fondet e Ministrisë së Arsimit e asaj të Kulturës së Maqedonisë së Veriut, por dhe nga burime fondesh të tjera, ka hequr nga të gjitha Antologjitë e Poezisë Shqipe, krijimtarinë e at Gjergj Fishtes dhe të ngjashmeve te tij, dhe ka botuar të gjithë krijimtarinë e vet, e cila në mënyrën më të palavdishme përmbledh pak a shumë frytin e punës 70 vjeçare të akademikut, me këto vepra : *Kërkime/ shqyrtime/ Reflekse letrare/Antologji e poezisë Shqipe* 2002/*Klubi letrar Tetovë; Antologjia na albanskata poezija*, Shkup 2004/*Letersia bashkëkohore shqiptare*- Koautor për klasat e katërta të

shkollave të mesme *Tiranë – Tetovë* 2001, Libri shkollor Prishtinë më 2002; Don Kishoti në Shqipëri (botim në Shkup dhe Tiranë). Një tjetër kryevepër e kërkimeve të thella akademike studimore është vepra e viteve të fundit të Doktor-Profesorit të hapsirave mbarëpërfshirëse, Ali Aliut, ajo me titullin bashkëkohor “ *Majlinda Nana Rama dhe universaliteti krijues i saj*”- Agora, Tiranë, 2018 (ngase zonja Majlinda Nana Rama qënka jo vetëm autore universale, por dhe një biznesmene e sukseshme në Shqipëri, këtë rradhë burimi i fondeve të akademikut Ali Aliu për botimin dhe lavdërimin e autores ka një adresë, ç'është e verteteta, të ndryshme nga ajo e Ministrisë së kulturës Shkup a Tiranë a Prishtinë!). Ali Aliu ka dhe dy vepra botuar në maqedonisht, njëren prej tyre me bashkautor Gane Todorovskin Shkup 2005, një në bullgarisht dhe një Anglisht. Kjo e fundit, në anglisht, përgaditur nga National and University Library, Skopje 2011!... I përmenda të gjitha këto, për t'ia kujtuar zotit të nderuar profesor, përpara se ai të gjykonte rreptësisht, me akuza politike, librin e një kolegu, do të kishte bërë më mirë të shihte librat e botuar gjatë gjithë jetës së vet, dhe t'i vinte në peshoren e gjykimit të kritikës letrare dhe në peshoren e pa-anshme të Teorisë së letersisë, profesor i së cilës është ai vetë. Dhe të kujtohej se shkrimtarët kontribuojnë në çështjet e vetëdijës së kombit të tyre jo me vepra dhe manuale botimesh pa vlerë estetike, por me vepra që janë letërsi e vertetë, që pranohen si të tilla jo vetëm nga kolegët hossanë që e rrethojnë akademikun, dhe jo vetem nga Çarshitë e Shkupit, Çajhanet e Prishtinës a Kafetë e Tiranës, por dhe nga kritika e huaj dhe nga lexuesit e huaj!

Dua të sqaroj edhe njëherë atë që e kam sqaruar në pasthënjën e Librit, me qëllim që spekulantët patriotikë të mos lodhen të përsërisin refrenin e tyre shterp: Antologjia e Poezisë Moderne Shqipe e Rudolf Markut nuk ka patur qëllimin të krijojë Antologjinë Mbarëshqiptare të të gjitha trojeve Ilirike dhe Arbërore-Dardane. Pjesa e dytë e kësaj Antologjie përfshin poetët që kanë lindur dhe kanë krijuar brenda Shtetit zyrtar shqiptar, sepse hartimi i një Antologji Mbarëshqiptare do të kërkonte të paktën dhe 1000 faqe të tjera, dhe do të donte një punë studimore jashtë mundësive të mia, studimin dhe evidentimin e poetëve bashkëkohor shqiptar të Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi. Sepse jam i bindur se kjo poezi nuk ka vetëm emrat e respektuara të Ali Podrimës a të Azem Shkrelit, por dhe dhjetra emra të tjerë. Janë pikërisht akademikët si Ali Aliu a si Mehmet Kraja a Agim Vinca të cilët duhej ta kishin bërë me kohë këtë vepër. Antologjinë mbarëpërfshirëse, dhe jo ta kërkojnë këtë Antologji, të munguar që prej disa dekadash, prej meje!

Sa për refrenin mjeran të *fondeve* që paskam marr nga Ministria e Kulturës, mund ta qetësoj akademikun (jo ekonomist) Ali Aliun se në jetën time nuk kam marrë as dhe një qindark të vetëm prej Ministrisë së Kulturës shqiptare, pa le pastaj nga Ministrinë a Institucionet studimore të letersisë të Serbisë, Prishtinës, Podgoricës a Shkupit. Një betim të cilin jam i bindur se asnjëri perj atyre qe e sulmojnë botimin e Antologjisë së Poezisë Moderne Shqipe, nuk do të guxonte të bënte përpara Bibles, a përpara Kuranit e as përpara Talmudit!



NJË ANTOLOGJI QARTËSISHT E CUNGUAR

Nga Klara Kodra

Kisha pritur me shumë dëshirë Antologjinë e Poezisë Moderne Shqipe të Rudolf Markut, duke pasur parasysh shijen e hollë dhe talentin e këtij poeti. Po mbeta thellësisht e zhgënjyer.

Duke hartuar këtë antologji, Rudolfi synonte sigurisht, siç kishte pohuar edhe vetë, te fryma moderne dhe, mbase, te niveli estetik europian i autorëve të zgjedhur.

Fryma moderne, e kuptuar gjerësisht, mund të rrokë disa drejtime letrare, duke nisur nga romantizmi dhe duke përfunduar te pasmodernizmi.

Më e rëndësishme është vlera estetike apo *literaliteti* i veprave që shpreh *thelbin* e tyre.

Po mendojmë se duhet pasur parasysh se në vlerën estetike të veprave të çdo kombi është tretur edhe ngjyra kombëtare.

Edhe gjenitë që i përkasin tërë botës kanë zhvilluar, së pari, në gradë të lartë identitetin e tyre *kombëtar*.

Bie fjala, para se të jetë botëror, Danteja është *italian*, Shekspiri *anglez*, Gëteja *gjerman*. Ata kanë pasuruar në fillim me ngjyra *kombëtare* spektrin europian, më vonë janë bërë pjesë e letërsisë *botërore*.

A mund të përfytyrohet një Antologji e Poezisë Moderne Shqipe pa ngjyrën *shqiptare*?

Dhe ngjyra *shqiptare* mos u takon vallë vetëm poetëve shqiptarë që u përkasin kufijve zyrtarë shtetërorë të Shqipërisë, pa vëllezërit kosovarë, shqiptarëve të Maqedonisë e Malit të Zi, pa arbëreshët e Italisë që krijuan letërsinë e tyre duke ruajtur gjuhën e zakonet e veta për pesë shekuj?

Nuk u gjëndkan vlera *estetike* dhe *moderne* midis këtyre vëllezërve që ndodhen jashtë atdheut?

Rudolfi mund të ketë sigurisht shijet e veta. Po një hartues antologjie që synon ta bëjë atë t'i rezistojë kohës duhet të ketë parasysh edhe vlerësimet e kritikës dhe të publikut.

Objektiviteti *absolut* në kritikë është *i pamundur*. Po synimi i një hartuesi antologjie, pra, një përzgjedhësi duhet të jetë ta kufizojë sa më shumë subjektivizmin e pashmangshëm.

Antologjia e Rudolfit mund të mos jetë e *shëmtuar* si pohon me mllef një nga kritikët e saj, po me siguri është e *cunguar*.

Antologjitë e dikurshme të kohës së diktaturës që linin jashtë poetë me nivel të lartë estetik i cungonte *ideologjizimi*. Po çfarë e shtyn një hartues të kohës së sotme, i lirë nga barrierat ideologjike, të krijojë bariera të tjera të padukshme, pra, të ngrerë mure të tjera?

Më vjen ndërmend një metaforë që kam përdorur në një novelë për De Radën ku poeti i përfytyron dy Arbëritë, atdheun e origjinës dhe vendlindjen, të ndara nga një shpatë magjike e padukshme.

Po cila shpatë magjike e ndan në dysh antologjinë e Rudolfit, duke ndarë shqiptarët nga shqiptarë të tjerë?

Në përgjigjen që Rudolfi u jep kritikave flet për një ringjallje të censurës. Po le të mos shqetësohet Rudolfi, nuk jemi në diktaturë dhe asnjë censurë, e dhathtë apo e majtë, s'do t'ia djegë Antologjinë, apo t'ia bëjë karton.

Gjykimin përfundimtar mund ta japë dhe do ta japë vetëm koha.

Mendimi im dhe besoj edhe ai i kritikëve të tjerë të Antologjisë është se kjo Antologji, duke qenë e *cunguar*, do të jetë edhe *jetëshkurtër*.

Po e them këtë, jo me mllef, po me dhimbje.

I.PASAKTËSIA E KONCEPTIT TË MODERNES.

Koncepti i “modernes”, (megjithëse Marku shprehet në Pasthënien e tij, se e ka përdorur termin “poezi moderne” në një këndvështrim, thjesht, personal), në të cilin, sipas tij, futet poetika e këngëve të 10 sibilave të Bogdanit (këtyre profeteshave të lashta pagane, sipas gojëdhënave antike, ritualet e të cilave u përshtatën më pas nga prekursorë të krishterimit, për nevoja të përhapjes dhe popullarizimit të besimit të ri), - me vargun më të bukur dhe më antologjik të krejt poezisë shqipe (të këngës së njëres prej këtyre sibilave, asaj të dytës, Libikes), që është vënë, i përshtatur, edhe si titull i antologjisë në fjalë,- në të vërtetë, poetika e Bogdanit i përket estetikës klasike, një përpunim i stilit klasik latin, (Virgjilit, - që, gjithashtu, u frymëzua dhe përshkroi sibilën e parë, atë të Kumes, - Juvenalit, etj., poetë që dhe i përktheu poeti ynë), shtoi këtij stili poetik dhe “stilin latin biblik”, si klerik që ishte dhe ku inkudron potencialin ekzistues gjuhësor të gjuhës shqipe, (me vargun 11 -rrokësh të sistemit silabik, me cezurën 6,5 dhe 7,4 si dhe me strukturën e rimës trokaike e jambike) dhe, me veprën e tij madhore “Çeta e profetëve”, Bogdani krijoi stilin klasik të shqipes sonë të mesjetës, (I Rugova).

Kujtojmë se stili i klasikes ka të bëjë, sipas perceptimit që në retorikën antike, me lapidaren, të rregulltën, madhështoren, aticisten, (me prejardhje nga Atika e Athinës, vendi i monumenteve letrarë të tragjikes së Eskilit, Sofokliut, letërsisë së lartë klasike), me thelbësoren, të madhërishtmen, të qartën, të hijshmen, të harmonishmen, monumentalen, ndërsa stili i modernes ka të bëjë me të kundërtën e skajshme, me teprimin, paqartësinë, fillimin e sajuar prej jothelbësore, lojçaken, të shqetësuarën, asianiken, (me prejardhje nga Azia e Vogël), me të shpërpjestuarën, të turbulltën, të tensionuarën.

Nëse do të krahasonim poetikën e Bogdanit (që lindi në shekullin XVII, me atë të, thajse, bashkëkohësit të tij, Luis de Gongorës, poetin e modernes spanjolle, që vdiq në të njëjtin shekull), do të kuptonim fare qartë poetikën dhe estetikën klasike të madhështores e të së harmonishmes, të “Sibilave” bogdaniane, për episode të jetës së Krishtit, me atë të modernes, manieristes së gongorizmit. Kështu që, disa nga “Këngët e sibilave” të Bogdanit, fare mirë mund të përfshiheshin, me titullin – vargun e një bukurie të pamatshme “Veshun me diell e mbathun me hanë”, dhe pse një përshtatje e Bogdanit nga “Zbulesa” e Gjonit të “Testamentit të ri” të shenjtë, - në një antologji të lirikës klasike shqipe ku do përfshiheshin lirikat neoklasiciste të “Lyra”, me të famshmen “Nymfat e Shkumbinit”, të Haxhiademit (që, gabimisht, përfshihen në antologjinë e Markut, si poezi moderne), tingëllimat e Mjedës, etj..

Për të përmbledhur, modernia, që nga antikiteti deri në kohën tonë lidhet me të renë, novatoren, risinë, revolucionarën e shprehësisë, të veçantën, të papërsëritshmen, në raport me poetikën e mëparshme, traditën shprehësores artistike, konservatoren prozodike, kanonet e artit të lartë, parimet e përcaktuara stilistike të krijimit poetik, etj.. Ndërkohë që modernia e kohës së re (e fundit të shek.XIX, shekullit XX e deri në ditët e sotme, u zhvillua si modernitet në pesë drejtime, pamje, “fytyra” kryesore (M. Calinesku): modernizmin, (që përfshin simbolizmin, - me simbolistët francezë të dhjetëvjeçarëve të fundit të shek.XIX, që bënë shpërndarjen e madhe nga poetika romantike e herojve të jashtëzakonshëm në rrethana të jashtëzakonshme; ekspresionizmin, dhe akmeizmin rus); pararojën, (avant-gardën) të fillim-shekullit XX, që përfshin dadaizmin, futurizmin, surealizmin, kubizmin, formalizmin rus); dekadencën, (vitet ’30 - ’40); Kitchin, (vitet ’50 – ’60); dhe postmodernizmin (vitet ’60 – ’90 të shek. XX). Ndërkohë, një art i ri, ai i performatizmit, shpërfaqet në këto dhjetëvjeçarë të parë të shek.XXI.

Ndërsa, kuptimi për modernen që jep Gëzim Basha në parathënien e tij të përmbledhjes në fjalë, është e karakterit historik të zhvillimit të qytetërimit teknologjik e shoqëror, (me kapitalizmin, revolucionin industrial, kulturën borgjeze) në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XIX, përfshirë dhe konceptin estetik të modernitetit, me pesë drejtimet e tij kryesore në fundshekullin XIX dhe gjatë shek. XX, që vumë në dukje më parë.

Dhe, jo një kuptim të kësaj modernie, (të ndier intuitivisht nga antologjisti ynë), të karakterit estetik për të cilin këmbëngul Marku, në pasthënien e përzgjedhjes së vet, që e cilëson si të “tjetërsjtë”, për t’i paraprirë polemikës (që ka parandjerë) për antologjinë e tij simpliste, të thjeshtëzuar (në konceptualitet, vetëm si estetike), dhe sipërfaqësore, (në përzgjedhjen e autorëve të përfshirë).

(Kujtojmë që debatet kritike për konceptin e modernes ndaj klasikes, i gjejmë që në antikitet, me Ciceronin, shek. I p.e.s. i cili përshtati për këtë koncept termin grek me fjalën latine neoterius; gjer në përdorimin për herë të parë të termit latin modern, (për njerëzit) dhe moderne (për letërsinë), në shek.VI, nga Kasidorusi, në kuptimin e diçkaje të re, të sotme, të kohës së tanishme, për të vijuar më pas gjer me të famshmen esenë satirike të Swift-it “Beteja e librave”, (1704), si betejë midis “gjigantëve” dhe “xhuxhëve”, midis të lashtëve dhe modernëve dhe Bodler-in, (1867), një nga artistët e parë që ia kundërvuri modernitetin e tij estetik simbolist, jo vetëm traditës, por dhe modernitetit praktik të qytetërimit borgjez me “bukurinë transhendente, kalimtare, ajo që arratiset tutje, të pasigurtën, gjysmën e artit, gjysma tjetër e së cilës është e përjetshmja dhe e pandryshueshmja”.

Ndaj, arti poetik i Bogdanit, për t’u rikthyer në argumentin tonë, nuk i përket estetikës së modernes, por traditës së poetikës klasike, stilit klasik latin të Virgjilit, etj. dhe stilit latin biblik të doktrinës së krishterimit, stile që ndërthuren gjërisht në veprën e tij monumentale artistike – kulturologjike.

OBJEKSIONE DHE PËRSIATJE, (“VESHUN ME DIELL, MBATHUN ME HANË”)

Nga Dr. Durim Çaça

Në vijim të një vale të gjerë komentesh, diskutimesh, debatesh, që merr, herë-herë, pamjen e një polemike të dhembshme e zemërake, rreth botimit të ri antologjik “Veshun me diell, mbathun me hanë”, përcaktuar si “Antologji e poezisë moderne shqipe”, përgatitur nga poeti Rudolf Marku, po shprehim dhe ne disa objeksione e përsiatje, në një parashtrim “të qetë”, pa ato shkulme indinjate të krijuesve e intelektualëve shqiptarë, në trojet tona e kudo që gjenden në emigracion, nëpër botë, për të cilat vepra në fjalë, si antologji kufijsh politikë, jep shkas jo pak. Në këtë gjykim, po e shpërfaqim një opinion tonë, në këto tre aspekte kundrimi.



2.”PRANIA E MOSPRANISË” SË POETËVE TË SHQUAR

Një tjetër mangësi në konceptin e antologjisë në fjalë qëndron në atë që do ta quanim “prania” e poetëve antologjikë shqiptarë, me mospraninë e tyre të përzgjedhjes në fjalë, “prania si mungesë”, në kuptimin që kjo përmbledhje të sjell më shumë ndërmend individualitete të shquar të lirikës moderne shqiptare, të papërfshirë në këtë përpilim të Markut, sesa kureshtjen për ata që paraqiten si pjesë të saj, disa prej të cilëve të panjohur apo pak të njohur, ose që nuk thonë shumë në artin tonë të sotëm poetik. (Këtë e ka parashikuar dhe antologjisti në fjalë i cili shprehet, (në Pasthënien e tij, si një kujtesë paraprake), se: “një nga mënyrat për të vlerësuar një antologji nuk është të vëresh se cilat poezi apo autorë janë përfshirë aty, se sa cilat poezi dhe autorë nuk janë përfshirë”.

Kështu, përzgjedhja në fjalë, na kujton se nuk janë në të Ali Podrimja, Azem Shkrelit, etj. për fat të keq, dhe poetë të tjerë të Kosovës e të trojeve, prej të cilëve u zhvillua më fuqishëm modernizmi i poezisë së re shqipe, ku dhe poetët shqiptarë kishin të gjithë liritë artistike të modernizmit europian, përveç lirisë themelore, asaj kombëtare, që e kishin të ndaluar ta kërkonin, nën shtypjen e pushtetit shovinist serb.

Ndërkohë që në Shqipëri, (përgjashtoj ndonjë vëllim poetik, të viteve ’60, si “Shekulli im” i Kadaresë, - që mbetet kështu dhe një poet i shquar, përveç se një prozator i famshëm, - ndoshta dhe “Poema dhe vjersha” të F. Arapit dhe, me një farë mëdyshjeje dhe “Mesditë” e D. Agollit, për lirikën e thellë reflektive - meditative), vazhdoi për shumë dekada shabllonizmi zhdanovist i të ashtuquajturit, “realizmi socialist”, me një letërsi të varfër propagande politike të partisë-shtet, ku poetët nuk mund të ishin artistë, por thjesht leva të edukimit politik të partisë diktatoriale që, vetëm kështu, iu jepte atyre të drejtën e publikimit, botimitin falas dhe në mijëra kopje nga shteti i saj. Por që, në të shumtën e rasteve, ky art masovik agjitacioni komunist ishte i pavlerë. Si, bie fjala, poema “madhore”, “Nënë Shqipëri”, e Agollit, botuar në 100 mijë kopje, e ashtuquajtur “Iliada e socializmit”, ku moderne për poetin dhe artin e tij propagandistik ishin të rinjtë me kominoshet e aksioneve vullnetare e të kantierëve dhe lufta e klasave kundër “lubonjëve” e “paçramëve” të shfaqjeve borgjezo-revizioniste, etj. etj.. (Ndërsa guximi për lirinë artistike paguhej me heqjen e së drejtës së botimit, burgosjen, persekutimin gjer dhe dërgimin e tyre, siç dihet, tashmë, nga historia jonë e re e dhembshme, para togës së pushkatimit, apo litarit, përveç asgjësimit të veprës së tyre të botuar më parë).

Një vend të gjerë zënë, në këtë përmbledhje që po shqyrtojmë, poetë të Shqipërisë të brezit të përgatitës të saj, (të viteve ’70-’80, të shek. XX), përfshirë, siç duket, prej tij, për nostalgji apo për “qokë”, - shkëmbim “nderesh”, reçencash e lavdash reciproke për publikimet e tyre, (B.Xhaferri, V. Ziko, etj.). Apo, në gjykimin tonë, autorë të mëvonshëm, që janë shpërfaqur më shumë si prozatorë të spikatur, ndërsa poezia e tyre paraqitet e një niveli mesatar, si B. Mustafaj, F. Aça, A. Tufa, (ku, i pari, paraqitet me një biografemë të gjerë politike, e dyta, më shumë si një veprimtare intelektuale dhe i treti si ndjekës i një numri të madh pro-

gramesh studimore specializimi filologjik, pa u vënë në dukje nga përpluesi, veçori a tipare të modernitetit të artit të tyre poetik).

Por asnjë prej këtyre poetëve të brezit të përgatitës, dhe të tjerë, pas tyre, nuk mund të përballet, madje dhe vetë poeti laureat Marku, (me asnjë prej librave të tyre më të mirë poetikë), - me fuqinë artistike të modernizmit, bie fjala, të poezisë ekzistencialiste të vëllimit të jashtëzakonshëm “Lum Lumi” të Podrimes, apo me “Lirikë me shi” të Shkrelit, apo ndoshta, pse jo, dhe me “Zomb”-in të post-modernizmit të A. Apollonit, (me tre botime të tij në Prishtinë), i papërfshirë, gjithashtu, në këtë antologji krejt subjektive. (Me përjashtim, ndoshta, të L. Lleshanaku, e shek. XXI, me “Homo antarktikus” e “Hapësirë negative”).

Ndërsa zënë vend në antologjinë e Markut autorë si: G. Krasniqi që është më shumë i njohur si romancier i bricolazhit dhe intertekstualitetit, se sa si poet; G. Kapllani që, me vëllimin e tij të vetëm, është thajse i panjohur si poet në jetën letrare të Shqipërisë (e që njihet më shumë si eseist, me “Ditar i shkurtër kufijsh”); apo M. Ademi, gjithashtu, thajse i panjohur dhe ky, me një libër të vetëm modest, - ndërkohë që poetë të rëndësishëm të arealit të lirikës së sotme shqipe, ndër më të spikaturit, si: S. Buçpapaj, (me një ndër vëllimet e tij poetike të një bukurie të fuqishme gjer në tronditje, “Frika nga atdheu”), H. Aliaj, N. Kacalidha, (me veprën e tij të shquar lirike “Pagëzimi i zogjve”), etj., por dhe “klasiku”, Ali Asllani, janë lënë jasht përzgjedhjes në fjalë.

Konceptuar si një oaz bukurie estetizante poetike, për një përtëritje të fuqive përjetuese dhe emotive, në shkretëtirën e sotme të virtualitetit teknologjik, antologjia e Markut, paraqitet si një amalgamë “rroksh mbresore” (me raportin e tyre ndjesor të jehonës së ankthit lirik), pa të rrokurit, “rrokjet” e tjera, atë humaniste dhe semantike, që janë hapësira tekstore të tekstit estetik, që mishërojnë literaritetin, (larg optikës së dijes së përbashkët), në optikën e shenjës artistike. - nëse do ta shikonim, në këtë vështrim, sipas semiotikanit të njohur zviceran, Zhak Geninaska, Si një amalgamë njohjes rastësore në rrjetet sociale si, bie fjala, poetja “antologjike”, M. Bashllari, apo G. Kone, gjithashtu, po me një libër poetik që, sigurisht, nuk afrohen për nga fuqia e tyre artistike, me kulmet e modernizmit të mëhershëm shqiptar si: “Ylli i zemrës”, vëllimi i dytë dhe i fundit i simbolistit Poradeci, apo “Vargjet e lira”, libri i vetëm poetik i ekspresionist Migjeni. Për të vijuar me përzgjedhje të një tjetër poetjeje, E. Çoku, në fillimet e saj të krijimit të një individualiteti artistik, etj., ndërkohë që L. Dushi, një zë i spikatur femëror në poezinë e sotme shqipe, nuk është pjesë e kësaj antologjie. Meqë jemi tek poeteshat, as që bëhet fjalë për F. Brovinën, e Kosovës, meqë krijuesit e trojeve janë lënë jasht projektit antologjik të Markut, sikur s’janë pjesa më e çmuar e poezisë së mirëfilltë shqipe të modernitetit.

Dhe as që mund të bëhet fjalë për poeteshën e kohës së re dhe interesante arbëreshe, K. Xukaro, pa le poetët e tjerë të njohur të sotëm arbëreshë, (V. Ujko, Zef Skiroi di Maxhio, (me vëllimin e tij të shquar poetik modernist “Ishuj” dhe “Poema arbëreshe”, ky i fundit, vlerësuar me çmimin special në panaririn kombëtar të librit në Tiranë), K. Kandrevë, etj. -kjo degë e blertë e lirikës së sotme shqipe). Edhe po të hiqeshin 15 a 20 nga autorët e përfshirë në përmbledhjen që po kundrojmë dhe të zëvendësoheshin me: E. Mekulin, S. Hamitin, (me poetikën moderniste të librit të tij

të shquar “Thikë harrimi”), E. Bashën, D. Mehmetin, A. Vincën, A. Islamin, R. Dedajn, B. Çapriqin, R. Musliut, M. Shabanin, Xh. Bajrajn, - poetë të shquar shqiptarë të kohës së re dhe bashkë-kohës në Malin e Zi, Kosovë dhe Maqedoni, (ky i fundit, ndër më të spikaturit e shekullit XXI, të diasporës së re, që e lëvroi poezinë shqipe në Meksikë), antologjia në fjalë, nuk do të humbte asgjë, veçse do të bëhej më dinjitoze dhe me një shpërfaqje të moder-nitetit estetik të shkallës më lartë.

Ndaj, një publikim i tillë antologjik i poezisë shqipe krejtësisht personal, subjektiv, përzgjedhur dhe përmbledhur thjesht për kënaqësinë estetike të “antologjistit”, që secili mund ta bëjë “sipas qejfit të vet”, “sipas shijes së vet” (TvABC, 19 prill) e që, për më tepër, promovohet zyrtarisht nga instanca të larta shtetërore të kulturës sonë, s’ka si të mos ngjallë, me të drejtë, indinjatën e krijuesve dhe intelektualëve shqiptarë.

Shqipëri: M. Buçpapaj, “Nacional”, (24 prill): Antologjia e R. Markut, e 378-a që botohet gjatë këtyre 33 vjetëve, (sipas Bibliotekës Kombëtare), nuk mund të anashkalohet, si të tjerat, për shkak të ngushtësisë së antologjisë së tij, para pritsmërisë së lexuesit në autoritetin e tij letrar”.

S. Çunga, (Portali intelektual, “Peisazhe të fjalës”): “Në këtë “antologji” të apologjisë, s’mund ta mbyllim si shumë herë më parë, (për institucionin e “Poetit laureat” dhe Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit”), se ai stan, atë bulmet ka? Vetëm se këtë herë kemi të bëjmë me një stan shtetëror, jo me stan privat”

S. Habilaj: Hartuesi i antologjisë ka konceptin (natyrisht, skandaloz), se poezia e një kombi, poezia e një gjuhe, mund të ndahet në disa shqipe, duke mbetur sërish shqipe dhe secila nga këto copëza të shqipes, mund të bëjë antologjinë e vet...

Kosovë: A. Apolloni, (Fb): Kjo s’është as antologji, as e poezisë shqipe, as moderne! Kjo është marre!

Mehmet Kraja, (ExLibris, 24 prill): Nuk mund ta besoj se, pas kaq kohësh të jetës së përbashkët, shfaqet një antologji me ndarje kufijsh...

Maqedoni e Veriut, A. Vinca, (“Nacional”, 24 prill): Nga 59 poetë, të përfshirë në këtë antologji, asnjë s’është jasht kufijve të Shqipërisë. Konferenca e Londrës, na dha ndarjen e parë, atë territoriale, më 1913, poeti refugjat që jeton në Londër, po na ndan, më 2023, në këtë ndarje të dytë që është ndarja shpirtërore. Si pati guxim ta bënte publike këtë antologji gjysmake?

A. Selmani, (Fb): Duke i parë emrat e poetëve të përfshirë, në këtë antologji, m’u kujtua poeti Podrimja, (që nuk është përfshirë aty), i cili, në poezinë “Etyd për Shqipërinë” thotë: Xhuxhe je / xhuxhe je, moj / pa mua...

A. Aliu, (ExLibris, 24 prill): Antologjia e Markut, që përjashton gjysmën e letërsisë shqipe, është një zhgënjim që duhet harruar sa më parë, si një nga ato qindra antologji të harruara tashmë përgjithmonë.

SHBA, D. Tuzi, (Shenasi Rama), Fb: Poetët që janë aty, (në antologji), mendoj se janë në vendin e gabuar, si krijues, në kohën e gabuar, si bashkëkohorë e, negativë, si shembuj artistikë...

U. Lushi, (ExLibris, 24 prill): Ky botim pa kritere dhe me injorim gjeografik të letërsisë shqipe, është një turp...

Përmendim, me këtë rast, se në “Antologjinë e poezisë shqipe, gjysmë - shekulli i artë”, 1950 -2000), të vitit 2002, të kritikut të njohur A. Aliu, që, sërish, ka si mangësi, përfshirjen më të shumtë të poetëve shqiptarë të trojeve dhe të atyre të sotëm arbëreshë të Italisë, ndërsa përzgjedh pak poetë të Shqipërisë shtetërore, subjektivizmi i tij nuk përfshiu R. Markun, (dhe pse në një pjesë të krijimarisë së tij, ky i fundit, paraqitet, përgjithësisht, si një poet i mire, me një ndër vëllimet e tij të spikatur të poezisë moderniste, “Vdekja lexon gazetën”, 1995, apo ndoshta, dhe vëllimi i mëvonshëm, “Një ballkanas në Londër”, po me materjen e tij të njohur estetike) dhe bëri pjesë të saj, poetë me një vokacion modest, si M. Hanxhari. (Mos ndoshta ky pezëm, - e ku më shumë se te poetët, shfaqet narcisizmi, - e detyroi Markun, t’i hynte kësaj pune të përpilimit të antologjisë së tij personale të poezisë shqipe, ku t’i bënte vend vetes, patjetër, në “lavdinë” e poetikës shqiptare.

Për ta promovuar me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit në Muzeun Historik Kombëtar, si arritje të kulturës së sotme, një antologji thjesht personale të shijes së vet individuale estetike, (të “antologjistit”, hartuesit të saj), si një përmbledhje mbresash leximesh të lira subjektive nga poezia shqipe, (nga ato përmbledhje që qarkullojnë brenda një rrethi të ngushtë privat miqsh të një ndiesie të përbashkët artistike),- me pompozitet mediash, ligjëruesish e poetësh “antologjikë” të cilët, këta të fundit, Mustafaj, Bejko, etj., me në krye përpiluesin (që “përzgjedhi” edhe veten e tij “poetike”, me poezitë e veta që përfshiu në të), në një atmosferë “solemne” butaforike, ngrinin veten në qiell, përmes lavdesh për përmbledhjen në fjalë, si një “madhështi” e një marrie ekzibicioniste.

Një përmbledhje përzgjedhjeje vetanake, e krijuar për kënaqësinë e vet individuale artistike e që s’është as plotërisht e poezisë së shqipes, as krejtësisht e poezisë së saj moderne dhe, aq më pak, të asaj kombëtare, (që, në fakt, kjo e fundit, siç bën të ditur vetë, nuk është synuar nga përgatitësi në fjalë e që, në thelb, mund të jetë e kuptueshme, në konceptualitetin e lirisë absolute, “hyjnore”, -poetët çmohen baraz me profetët,- të krijuesit, - në këtë rast, të përgatitësit i cili, fare mirë, mund ta kishte saktësuar, në nëntitull, karakterin e botimit të tij, që në ballinë si “Antogji personale e poezisë së Shqipërisë”, meqenëse, vetëm këtë pjesë të poezisë shqiptare shtetërore njeh më mirë, siç shprehet dhe vetë, me kulturën e tij të kufizuar “estetike”, (sipas kriterit të përcaktuar prej tij, siç bën, gjithashtu, me dije, po vetë në “Pasthënie” të tij, i ashtuquajtur “laureati i poezisë shqipe”, duke mënjanuar kështu gjithë këtë polemikë të sertë.

Ndërkohë që ironisë përtallëse e megalomane të këtij “antologjiku”, (në TvABC, 19 prill, 2023), se “ka lënë pa futur në këtë antologji të tij, poetët e Kumanovës, të Çërrikut e Rrogozhinës), mund t’i kujtojme se poeti i Rrogozhinës, Xh. Tosku, nuk qëndron më poshtë se poeti lezhjan, R. Marku. Gjithashtu, nëse nuk janë lapsus-e, përcudnimi i emrit të poetit të njohur, të viteve ’60, Vehbi Skënderi, në Skënder Vehbiu, apo cilësimi i kritikëve

të Antologjisë së tij, (duke dashur t’i ironizojë, e përcmojë, si të ngjashëm me mbikqyrjen shantazhuese të patronazhistëve të PS, në fushatat e saj elektorale), i cilëson këta krijues e intelektualë, si “patrozhanistë”, (ExLibris, 22 prill, 2023), reagimi nervoz i Markut do t’i ngjante një sjelljeje sharlatanizmi. Një “mbrojtje” në këto raste, edhe sulmi, edhe tërheqjeje, me aksiomat e njohura se “një njeri, aq sa di bën”, “një krijues, (në këtë rast, poet, madje dhe laureat), atë ç’ndien estetikisht, përzgjedh”, atë ç’përjeton shpirtërisht, përmbledh në shqipërishte, po të shpreheshim me një leksemë lasgushiane, (në frymën e përvetshme të “shqipes poetike”), se “fola dhe shpëtova shpirtin”, etj.etj..

3.NJË TRILL “ANTOLOGJIK” POETI

Vepra kulturore në fjalë, mund të shihet si një antologji personale e shijes vetjake estetike, “thjesht argëtuese, kënaqësimarrëse, kënaqësitrazuese të krijimit artistik”, (siç sugjeron vetë Marku në pasthënien e tij, “Një antologji e tjetërsojtje”), në ekstatën e krijuesit, si një përmbledhje ngazëllimore, lojcake, thuajse e qashtërsisë fëmijërore, e tingëllimit të bukur, të lirshëm, të melodishëm të shqipes estetike, si një kalamendje artistike e zbavitje relaksuese “të patëkeq” prozodike, jasht kanoneve e “apriorive”; si një “kapriçio” artistike, aventurë marramendëse perceptimi ekstatik, kuturisje poetike, si një pasion fantazist lirik “çmendurisht” i bukur, “ekzaltim të metafizikës e transhental-es të lirikës konceptuale”, (siç shprehet me këtë cilësim të fundit, Gëzim Basha, në Parathënien e tij, “Një antologji e munguar e poezisë shqipe”), si një shpallje e lirisë absolute të krijuesit, edhe kur përzgjedh në artin e poetëve të tjerë, larg çdo kriteri të ngurtë shkencor akademik, qëllimi pragmatist, parimi ideologjik, koncepti etatist, kanoni kombëtarist, veç kriterit ngazëllues estetik të së bukurisë poetike, pra, një trill “antologjik” poeti. Dhe pse Marku e sheh një antologji si një akt kritik, botimi i kësaj që po shqyrtojmë është, në të vërtetë, një akt hedonistik, i kënaqësisë estetike të leximit poetik, “vlerash estetike, paraqitur si sugjerim, vë në dukje autori i Parathënies, në kohën tonë kaotike të dyndjes së pafre të amatorizmit dhe gjithfarë spekulantëve botuesish e shpërndarësish çmimesh letrarë honorifikë”.

Duke gjykuar si “antologjinë më të mirë atë që krijohet nga një lexues i rreshkur që në fëmijëri e që bëhet më vonë shkrimtar, teksa i bashkon kështu përvojës së kultivimit të shijes së leximit, kulturën dhe përvojën e krijuesit letrar”, Marku paraqet kriterin estetik si devizë, si manifest të tij artistik, në botime të këtij karakteri, duke synuar të hapë kështu një tjetër horizont perspektiv të gjykimit kritik.

Ndërsa Marku klasifikon në tipologjinë e botimit të antologjive poetike, që nga ato pragmatiste shkollareske e akademike e gjer ato të biznesit të sipërmarrësve botues, që printojnë pafund, për përfitime, përmbledhje antologjike me pagesa autorësh të panjohur, për të dalluar karakterin e antologjisë së tij estetike, ne shohim në tipologjinë e këtyre botimeve, antologji poetike të përgjithshme, ato tematike, rajonale e lokale si dhe antologji të opusit poetik autorial, për të cilat po bëjmë, në këtë rast, një parantezë të gjerë.

Antologjitë poetike të përgjithshme individuale, (personale), që synojnë të shpërfaqin totalitetin hapësinor apo kohor historik të artit poetik të një gjuhe e kulture, paraqiten, përgjithësisht, me mangësi të theksuara; në rastin e parë, bie fjala, antologjia që përmendëm e kritikut A. Aliu, që përfshin poezinë shqipe të të gjithë trojeve të shqiptarëve, por vetëm në një gjysmë shekulli atë, të gjysmës së dytë të shekullit XX. Në rastin e dytë, antologjia që po kundrojmë, ajo personale, e poetit R. Marku, që merr përsipër të japë një pamje të bukurisë së poetikës shqipe që nga kohërat më të hershme të saj gjer në ditët tona, por vetëm në një pjesë të territorit shqiptar, atë të Republikës së Shqipërisë. Po kështu, antologjia individuale akademike e studiuesit R. Qosja, (1969), gjithashtu, paraqitet e ngurtësuar me kriterin e saj ideologjik e historik. Ndërkohë që antologjia më e mirë e poetikës shqiptare në shtrirjen gjithëhapësinore e gjithëkohore, (me gjithë ndonjë kufizim të lehtë ideologjik të kohës), mbetet vepra kolegjiale e një grupi bashkëpunëtorësh: poetë, kritikë, studiues e filologë, ndër më të spikatur të kohës, (D. Siliqi, Dh. Fullani, N. Jorgaqi, O. Myderrizi, R. Brahimi, Sh. Demiraj), nën drejtimin e Dh. Shuteriqit, një monument letrar i shqipes sonë poetike të traditës, “Poezia shqipe”, vëllimi I, (1965), në të cilin poezia shqipe nis me Lekë Matrengën dhe vijon me 52 poetë, deri te Mjeda, përfshirë dhe autorët anonimë të poezive të fuqishme: “Bendo Shapërdani” dhe “Zani i kasnecavet”.

Vepra të shquara kolegjiale antologjike janë dhe ato për poezinë franceze, greke, ajo e poezisë turke të shek.XX, antologjia akademike e poetëve maqedonas, antologjia e poezisë moderne të Iranit “Trëndafilët e Persisë”, etj. si punë e përbashkët e frymëzuar, grupesh poetësh, shqipëruesh e redaktorësh filologë. Ndërkohë që shpërfaqjen më pak të suksesshme antologjitë individuale (apo personale) si ato të Dritan Thomollarit për poezinë italiane, të shekujve XIX e XX dhe asaj të poezisë angleze të shek. XIX, të Rudi Bobratit për poezinë anglo-saksone,të shek. XX, të Simon Vakës, sërish për poezinë italiane që nga periudha e Rilindjes, të Artur Ballit për poetët romantikë anglezë e skocezë, (dhe ku bëjnë përjashtim dy antologjitë individuale të Aurel Plasarit: të poezinë spanjolle të shek.XX dhe të asaj rumune të shek. XX “Një flatër e një këmbë”).

Antologjitë poetike tematike, paraqiten përgjithësisht, të suksesshme, edhe pse janë, në të shumtën e rasteve, individuale. Kështu, mund të përmendim antologjitë interesante të Anton Nikë Berishës për poezinë liturgjike shqipe apo për poezinë e sotme arbëreshë; apo antologjia për poetët shqiptarë mesjetarë të Anton Papelekës, antologjia interesante e poetëve të harruar shqiptarë, të Shpëtim Kelmendit, gjer te antologjia e bukur me “Vargje për dashurinë” të poetit Mark Simoni, botuar në shkurt të këtij viti, (një muaj përpara publikimit të “Veshun me diell, mbathun me hanë”, mars, 2023), etj.

Antologjitë krahinore, lokale e të komuniteteve të emigrantëve, që kanë rëndësinë e vet nga që përmbushin nevoja kulturore e shpirtërore të komuniteteve ku krijohen dhe shërbejnë, për autorë që përfaqësohen në to, si “plasdarme” të shpërfaqjes së tyre në antologjitë kombëtare. Kështu, bie fjala, antologjia e bukur e poetëve të Kukësit, e poetit Rexhep Shahu, botuesit të njohur të shumë antologjive, mes të cilave, atë poetëve të sotëm të Ballkanit, të poezisë moderne të Iranit si dhe të revistës së shquar “Illz”, të Klubit të Poezisë së Tiranës; “Zëra të një qyteti” të poetëve Ramazan Hushi dhe Josif Doja, të krijuesve të trevës së Kavajës, etj.; “Pelegrini” të shoqatës kulturore të emigrantëve shqiptarë në Greqi, të shoqatës së krijuesve shqiptarë emigrantë në Suedi “Papa Klementi”, etj., etj.

Antologjitë poetike të një opusi autorial, në të cilat, gjithashtu, si më të sukseshmet paraqiten ato bashkëpunime kolegjiale grupesh poetësh e shqipëruesh si ato për veprën e Shekspirin, Gëtes, Pushkinit, Eseninit, etj. Bën përjashtim vetëm fuqia gjenuine e artit poetik të Poradecit që përballoi më së miri, shqipërimin dhe publikimin e antologjive poetike për Hajnen, Mickieviçin, Petëfin, etj., ndërsa rast i veçantë, është ai i Sotir e Cacit, me antologjinë poetike të Hygoit.

Të prekim, kalimthi, dhe çështjen e vënies së emrit të antologjistit, (hartuesit të antologjisë), megjithëse, në pamje të parë, pa kurrfarë rëndësie por, në një vështrim më të thellë, shenjon karakterin e botimit. Marku e paraqet antologjinë e tij si një vepër aitoriale, duke e vënë emrin e tij, në një disenjim grafik (“të skalitur”) në krye të ballinës, sipër titullit të antologjisë në fjalë, “shenjim” si të ishte një vepër origjinale kur, në të vërtetë, është antologji, vepër e “sajuar” me krijime të poetëve të tjerë. Kur, prej shekujsh, në traditën e botimeve të tilla antologjike, emri i hartuesit të tyre vendoset poshtë titullit të antologjisë, me foljen e veprimit përpara dhe emrin përkatës të hartuesit, madje, me tipografinë e thjeshtë normale, pra: përpiloi, përzgjedhi, punoi, përgatiti, përmbloodhi. Si, bie fjala, antologjia “Eni vjen prej Çamërie”, përpiluar nga: Ali Podrimja, (me vargje të 35 poetëve nga të gjithë trojet shqiptare për tragjedinë çame); madje, në antologjinë “Poezia e bejtexhinjve”, emri i përgatitësit, Hajdar Salihu, që e ka pajisur përmbledhjen në fjalë, me një studim prej 100 faqesh, nuk është vënë në ballinë, as në faqen e brendshme por në krye të studimit, në faqen 5. “Antologji e poezisë malazeze”, zgjodhi dhe përktheu, Dimitrov Popoviq; antologjia e poezisë ballkanike, “Diell pa hije”, zgjodhi e shqipëroi: Ramadan Musliu ; “Antologji e poezisë botërore”, përktheu e përgatiti: Faslli Haliti, etj. etj. Këtë parapëlqim të Markut, (edhe në antologjinë e tij të poezisë botërore), për të paraqitur publikime të këtij lloji si vepra aitoriale, nuk po duam ta shohim si shprehje të një egotike megalomane, por si një kurajo të tij të sugjerimit për të parë elemente të një lloj originaliteti, edhe në botime të këtij karakteri si: struktura, (kompozimi), shija subjektive e përzgjedhjes së autorëve dhe teksteve artistike, kriteri i veçantë estetik, në këtë rast, i këtij botimi antologjik, etj..

Pohimi i Markut, në polemikën e tij ndaj valës kritike (ExLibris, 24 prill) se ka përfshirë në antologjinë e tij, 95% të poezisë më të mirë shqipe, bie poshtë lehtësisht, ngaqë në këtë përpilim të tij nuk janë përfshirë 50% e poezisë më të mirë të modernitetit shqip të shekullit XX, të trojeve, të diasporës arbëreshë dhe diasporës së re të emigracionit si dhe 15% e poezisë së re moderne të Shqipërisë shtetërore, duke mbetur kështu, përmbledhja në fjalë, vetëm me 30% të kësaj shqipe poetike. Gjë që duhej ta pasqyronte, me nëntitullin, që në ballinë: “Antogji personale e poezisë shqipe të Republikës së Shqipërisë”. Dhe jo ta paraqesë me përcaktimin pretencioz, gjithëkohor e gjithëhapësinor, me kontekst të një dinjiteti të lartë kulturor të botimit, (që kërkon të parathotë dhe disenjimi i bukur grafik i paraqitjes artistike të librit), si “Antologji e poezisë moderne shqipe”.

Të vijmë tani, në përmbyllje, me objeksionet tona: Një antologji e dinjitetit të poezisë shqipe krijohet jo nga sipërmarrës të biznesit botues, me pagesa autorësh të panjohur që përfshihen në botime të tillë për të patur një emër; as përmes antologjish mediokre e vanitoze amatorësh e diletantësh për certifikata online “unionesh botërorë poetësh” e dëshmi (jo) penaliteti; as nga sipërmarrje institucionesh shtetërore e akademike dhe as nga sipërmarrje personale individuale poetësh, ashtu, siç “ia do qejfi i vet”, “mideja” apo “shija vetjake estetike”, por përmes një pune kolegjiale poetësh, eseistësh letrarë e filologësh, që nis me inspirimin e një poeti, i cili mund të ftojë për punë të frymëzuar, poetin e spikatur të çdo brezi krijuesish në Shqipëri, troje e diasporë, ose poetin e spikatur në çdo shtet të shqiptarëve apo ku jetojnë shqiptarë. P.sh. në një sugjerim të parë, më vijnë ndër mend, poetë, si: Luljeta Lleshanaku, (Shqipëri), Ag Apolloni, (Kosovë), Agim Vinca, (Maqedoni), Haxhi Shabani, (Mali i Zi), Skënder Buçpapaj, (emigracion, Zvicër), Mario Belici, (Kalabri); eseistët: Agron Tufa, Primo Shllaku, gjer tek më të rinjtë, Alisa Velaj. (Sigurisht, aq sa mund të afrohen në këtë bashkëpunim fisnik).

Apo, sipas brezave, çdo poet përzgjedh ato krijime dhe autorë të shquar të brezit të tij të kohës së re, në shtetin e tij dhe në trojet shqiptare e diasporën arbëreshë e të emigracionit, duke nisur, bie fjala, me Natasha Lakon e brezit të viteve ’60, e duke u ngjitur në vitet ’70 e deri në ditët tona, me Sabri Hamitin, Ilirian Zhupën, Arian Lekën, Arben Idrizin, Niko Kacalidhën, Zef Skiroi di Maxhion, Resul Shabanin, Milazim Krasniqin, Sali Bashotën, Nurie Emrullain, Plator Ulqinakun. Kuptohet, 6 - 7 prej tyre që mund të ofrojnë bashkëpunim në një grup pune kolegjiale. (Theksojmë, që janë emra të sugjeruar, thjesht, individualisht, që mund të jenë dhe të tjerë. Thelbi është kolegjialiteti i një veprimi publik kulturor e artistik, meqë veprimi personal, vetjak, siç pamë në këtë parashtresë, në të shumtën e rasteve, në botimet e këtij lloji, ku shpërfaqet shpirti i një populli, del i pasuksesshëm).

Duke patur kështu, përmes një antologjie të tillë kolegjiale krijuesish të spikatur, një tablo mozaikale të vlerave artistike, në kulmimet e tij klasike dhe të modernitetit, nëpër kohëra e hapësira të tij, të verbit lirik shqip.

Peter Burke shkruan se variacionet më të dukshme në kulturën popullore që kanë mbetur pothuajse deri në kohët e fundit, janë variacionet gjinore dhe krahinore.¹ Më tej, ai thekson se prapa variacioneve krahinore, fshihet uniteti që ndodhet në themel.² Sipas këtij autori, më tepër sesa me motivet që qarkullojnë në këtë apo atë krahinë, këto variacione lidhen me kombinimet e veçanta të motiveve.³ Pasi analizon dukuritë e ndryshme kulturore në Europë, në fillimet e kohës së re, ai arrin në përfundimin me rëndësi të madhe konceptuale: “Në kulturën popullore , variacioni individual, ashtu si variacioni krahinor, duhet të shihet në radhë të parë në drejtim të përzgjedhjes e të kombinimit”.⁴ Modelin e përfutur nga ndërveprimi i të gjitha kontrasteve, ai e ka përmbledhur si një dallin midis tri Europave: Europa jugore, mesdhetare, romano-folëse, katolike (me xhepa hugënotësh e myslimanësh etj.; Europa veriperëndimore dhe Europa lindore.⁵

Studiuesit kanë vënë në dukje se variancionet krahinore janë të pranishme edhe në një përbërës të rëndësishëm të kulturën popullore, siç është poezia epike. Sipas Stanesco-s, poezia mesjetare në Francë karakterizohet nga dy ndarje të mëdha: poezia e trubadurëve që u zhvillua në Jug të Francës dhe poezia e truverëve që pati si djep Veriun e këtij vendi.⁶ Ai shton se ndryshimet midis teksteve që u krijuan dhe qarkulluan në secilën nga këto zona, nuk qëndronin vetëm në rrafshin gjuhësor por edhe në atë zhanror, tematik, strukturor, stilistik etj.⁷

Për këtë dukuri kanë folur edhe studiuesit që janë marrë me poezinë epike të sllavëve të jugut. Më 1929, Mathias Murko-ja shkruan: “Në mënyrë të përgjithshme, kënga është më e zymtë dhe më e paqartë në veriperëndim të Bosnjës dhe ka më shumë gjallëri dhe është më e qartë në Hercegovinë e në Mal të Zi”.⁸ Nga ana e tij, Alois Schmaus-i që ka bërë një studim të gjerë për traditën epike boshnjake, shprehet kështu: “Por edhe sipas formës gjeografike, duhen dallue dy tipa të epikës muslimane, siç treguan hulumtimet e Murkos: tipi i ashtuquejtun hercegovas dhe i ashtuquejtuni tip krajinas”.⁹

Nga ky model i gjithmbarshëm nuk mund të bënte përjashtim as kultura popullore shqiptare dhe, në kuadër të saj, epika legjendare. Duke i përqsur tekstet dhe ciklet e kësaj epike, bien në sy elemente dhe veçori të përbashkëta, të cilat bëjnë të mundur që të flitet për një traditë poetike unike dhe homogjene, domethënë për traditën epike shqiptare.

Disa nga këto elemente dhe veçori të përbashkëta mund të jenë:

A.Elemente dhe veçori që lidhen me brendinë:

- Prania e dy vëllezërve kryekreshnikë, Mujit e Halilit, në shumicën e këngëve kreshnike.
- Vazhdimësia organike midis mitologjisë popullore shqiptare dhe mitologjisë së pranishme në epikën legjendare.
- Lidhjet e ngushta midis disa heronjve epikë dhe qenieve të mbinatyrshme.
- Zhvillimi i ngjarjeve në dy plane: në planin real, tokësor dhe në planin fantastik, të mbinatyrshëm.
- Roli që luajnë në sjelljen e kreshnikëve shfaqja dhe interpretimi i ogureve, sidomos i shenjave ogurkëqija dhe i ëndrrave (onirizmi).
- Marrëdhëniet e ndërsjellta midis epikës legjendare dhe prozës popullore si përrallat e legjendat, apo llojeve e nënllajeve të tjera të poezisë gojore.
- Mbizotërimi i konfliktit midis botës shqiptare dhe botës sllave.
- Lufta për mbrojtjen e kullotave si manifestim i përpjekjeve për t’i bërë ballë dyndjes sllave dhe për të mbrojtur trojet shqiptare.
- Idea e hakmarrjes është forca lëvizëse e disa kreshnikëve.
- Çlirimi i robërve dhe i robinave është një nga motivet themelore të epikës sonë legjendare.
- Përhapja e gjerë e martesave me rrëmbim, ose e raptit.
- Është i pranishëm motivi i vajzës luftëtare.
- Ndeshet arketipi universal i kreshnikut të mitur.
- Konflikti ndëretnik nuk i përjashton marrëdhëniet midis individëve me etni të ndryshme si miqësi, dashuri, martesë, vëllamëri...

¹ Peter Burke, Kultura popullore në Evropë në fillimet e Kohës së Re, 1996, f. 47

² Po aty, f. 52

³ Po aty, f. 54

⁴ Po aty, f. 142

⁵ Po aty, f. 55

⁶ La poésie médiévale, Paris, 1992, f. 10-15.

⁷ Po aty, f.

⁸ Mathias Murko, La poésie populaire épique en Yougoslavie au debut du XXe siècle, Paris, 1929, f. 20

⁹ Alois Schmaus, Studime mbi epikën e Krajnës, AIKP, Dosja 38/1, f. 10-11

DY ZONAT E MËDHA TË EPIKËS SONË LEGJENDARE DHE DALLIMET MIDIS TYRE

Prof. as. dr. Anton Papleka

15. Vlerësohet objektivisht kundërshtari, vihen në dukje meritat e tij.

16. Kreshniku i plagosur e pranon sfidën e Arapit ose të Balozit të Zi, të cilin e ndëshkon me vdekje.

17. Është i pranishëm motivi i mosbesimit ndaj gruas si dhe ai i pabesisë së saj.

18. Kreshnikët kanë nderim të madh për nënën e tyre.

19. Kreshnikët e respektojnë ligjin e ekzogamisë.

20. Kreshniku që u del zot të pafuqishëmve, nuk pranon pagesë.

21. Për të arritur qëllimin e tyre, disa kreshnikë përdorin teknikën e maskimit.

22. Kali i kreshnikut dhe zogjtë flasin si njerëz.

23. Gjatë koçisë, kundërshtari e mashtron disa herë kreshnikun shqiptar, por nuk e fiton garën.

24. Kali kërcënohet që të mos kryejë ndonjë veprim si dhe i bëhen disa premtime, po të plotësojë kërkesat.

25. Në situata të rënda, kreshnikët vështrojnë barin që rritet.

26. Personazhet merren vesh me anë të letrës së shkruar me gjak.

27. Prania e shtresës orientale dhe islamike në këngët kreshnike.

28.Ndërkallja e elementeve të poezisë gnomike në tekstet epike.

B.Elemente dhe veçori që lidhen me formën

- Shumica e këngëve fillojnë me formulën përthirrëse (invokative) *Lum për ty o zot e i lumi zot!*...
- Ka fillime këngësh që janë karakteristike për përrallat.
- Të shtënat me pushkën habetare shërbejnë për ndërrimin e skenës së ngjarjeve.
- Mbylljet e këngëve janë klishetike.
- Nuk ka prirje për epicizim.
- Mbizotëron vargu i bardhë.
- Mbizotëron trajta letrare në vargje.
- Ka prirje për tkurrjen e këngëve

C.Elemente dhe veçori që lidhen me interpretimin

- Në shumicën e rasteve, këngët kreshnike janë kënduar të shoqëruara me lahutë.
- Ka mbizotëruar të kënduarit homofonik.
- Këngët kreshnike janë ngjizur dhe kanë qarkulluar në mjediset fshatare.¹⁰
- Që nga mesi i shekullit XX ka rënë intensiteti i qarkullimit të këngëve kreshnike. Përveç elementeve dhe veçorive të përbashkëta që u përmendën më lart, në tekstet dhe ciklet e epikës sonë legjendare, të mbledhura në hapësirën ballkanike të qarkullimit të saj, vihen re edhe dallime, të cilat janë përfutur nën ndikimin e faktorëve objektivë e subjektivë. Duke marrë parasysh sasinë dhe intensitetin e këtyre dallimeve, mendoj se hapësira e mësipërme mund të ndahet në dy zona të mëdha: I.Zona perëndimore; II.Zona lindore.

Një kufi i përafërt midis këtyre dy zonave do të ishte vija imagjinare që do të zinte fill në perëndim të Sanxhakut, do të ndiqte kufirin shtetëror të Shqipërisë së 1913-s, do të kalonte në perëndim të Hasit, këngët kreshnike të të cilit kanë më shumë ngjashmëri me Kosovën¹¹, do të vazhdonte në lindje të Mirditës dhe do të zbriste deri në Librazhd. Sidoqoftë, në asnjë rast, kjo vijë ndarëse nuk duhet të kuptohet si një mur hermetik, po përkundrazi, si një kufi poroz që ka lejuar ndërdepërtime të shumta që lidhen si me substancën e teksteve poetike ashtu dhe me strukturën e tyre.

Para se të shqyrtojmë me hollësi dallimet që vihen re midis zonës perëndimore dhe asaj lindore, mendoj se është e udhës të zëmë ngoje sa më shkurt faktorët kryesorë që kanë kushtëzuar

përfitimn e atyre dallimeve, të cilat vihen re në zonën lindore ku rinovimet janë më të shumta e më të dukshme.

1. Faktori gjeografik

Viset e përfshira në zonën lindore kanë qenë më të rrafshëta sesa ato të zonës perëndimore, meqenëse në përgjithësi janë fushore. Për këtë arsye, shtetet e huaja e kanë pasur më të lehtë të depërtojnë aty me ushtritë e tyre pushtuese, të vendosin sundimin e tyre politik, ekonomik e kulturor.

Në mënyrë të veçantë, vlen të theksohet se gjeografikisht zona lindore ka qenë në kontakt më të drejtpërdrejtë me botën sllave dhe ka qenë rrugëkalim për Perandorinë Osmane drejt Europës Qëndrore.

2. Faktori politik

Sipas historianëve, zona lindore ka qëndruar për një kohë më të gjatë nën sundimin e shteteve sllave. Po ashtu, këto vise janë pushtuar më herët nga Perandoria Osmane, e cila ka vendosur aty regjimin e saj feudal-ushtarak me të gjitha institucionet e tij politike e juridike.

3. Faktori ekonomik

Nëpër viset e zonës lindore kanë kaluar rrugë të rëndësishme karvanesh që lidhnin jo vetëm Ballkanin Perëndimor, por edhe Europën Qëndrore me Perandorinë Bizantime (më vonë me atë Osmane), me Lindjen e Afërt dhe të Mesme.

Kullotat e pasura, tokat pjellore dhe xehet kanë krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e blegtorisë, të bujqësisë e të zejtarisë. Nga defterët e administratës Osmane dhe nga shënimet e udhëpërshkruesve, del se në këtë zonë, në fillimet e kohës së re, ka qenë më i shpejtë zhvillimi i qyteteve.

4. Faktori demografik

Për shkak të terrenit më të favorshëm për të siguruar të ardhura më të mëdha, ka pasur një rritje më të vrullshme të popullsisë dhe janë shtuar vendbanimet me shumë banorë.

Në zonën lindore ka pasur ngulime me popullsi sllavofone dhe turkofone.

Banorët e kësaj zone kanë pasur marrëdhënie më intensive me Bosnjën myslimane, siç kanë qenë martesat ndërteknike, të cilat kanë çuar në dukurinë e dygjuhësisë ose në humbjen e gjuhës shqipe nga disa banorë shqipfolës. Kështu ka ndodhur bie fjala në disa vendbanime shqiptare të Sanxhakut, në Plavë, në Guci etj.

5. Faktori kulturor

Në viset e zonës lindore janë tkurrur ose janë zhdukur më shpejt mbijetesat e mitologjisë pagane. Gjatë një ekspedite folklorike të zhvilluar në vitin 2000, në fshatin Brezovicë, në shpatet e Sharrit, disa pleq të moshuar thanë se nuk dinin gjë për Orët e për Zanat, për këto figura që janë elementi mitologjik themelor në këngët kreshnike shqiptare.

Islamizmi masiv i banorëve të kësaj zone ka filluar qysh në shekujt e parë të pushtimit osman dhe ka çuar pothuaj në një konvertim të plotë të tyre...

Në vazhdim të këtij shqyrtimi, do të përpiqemi të vëmë në dukje disa nga dallimet që janë përfutur nën ndikimin e faktorëve të lartpërmendur në këngët kreshnike që kanë qarkulluar dhe janë mbledhur në dy zonat e përcaktuara më parë. Dua të tërheq vëmendjen se në mjaft raste bëhet fjalë për elemente apo veçori që janë më të pranishme apo më të theksuara në zona lindore, por që nuk është e thënë të mungojnë krejtësisht në zonën tjetër.

DALLIMET KRYESORE MIDIS KËNGËVE KRESHNIKE TË MBLEDHURA NË ZONËN LINDORE DHE ATYRE TË ZONËS PERËNDIMORE

1. Në këngët kreshnike të mbledhura në zonën lindore është thurrur mjaft elementi mitologjik si dhe është dobësuar roli i tij në zhvillimin e subjektivit apo në përcaktimin e fatit të personazheve. Zanat dhe Orët ndeshen më rrallë. Ato nuk u shkojnë në ndihmë



kreshnikëve shqiptarë sa herë që bëjnë dyluftim me antagonistët e tyre, nuk ua heqin udhën apo nuk i marrin me ndore kur ndërmarrin udhëtime të gjata për të shkuar në krali, siç ndodh në rapsodinë *Martesa e Halilit*, mbledhur në Curraj t’Epër’: “Sa mirë Ora e paska msue!/-Pa mba vesh, or djalë i ri./p’e di mirë, pse kha je dalë,/se t’kam pa ndër Lugje t’verdha,/se t’kam dashtë si sytë e ballit,/t’kam ruejtë natën, t’kam ruejtë ditën,/m’ke pasë hije për mbas trupit”¹²; nuk u japim fuqi të mbinatyrshme kuajve, siç ndodh me kalin e Lule Frangut, pas përgjërimeve të Ajkës, në këngën e mbledhur në Pecaj të Shalës: “Të tri zanat iu kanë afrue./-Po pse kshtu, gjogo, ti me ba?/ Me dorë kreshtën po ja lmojnë./me bar malit po e fërkojnë./po ja lmojnë ato kopitat e kambvet/e ja lmojnë ato peshqit e shpinës/ edhe gishtat e gliqet e gjujvet./Ato lmo e jogju tue hingllue,/toje-toje shtati iu ka ba”.¹³

Ndryshe nga kënga paradigmatiche e zonës perëndimore: *Gjeto Basho Muji* (martesa)¹⁴, në këngën *Kur e ka marrë Muja nusen*¹⁵ të lahutarit Sefë B.Gashi nga Mleqani i Prekorupës, nuk ka as shkelje tabuje, as kult të mrizeve të shenja, as gurëzim të krushqve nga zanat, as kapje të dhive të shenja nga Muji. Në qoftë se në këngën *Fuqija e Mujit*, mbledhur në zonën perëndimore, Muji i lutet për ndihmë hyjnisë pagane, Diellit: “Fill kah dielli kenka sjellë/ edhe ndimë i paska lypë./-O ti diell, o diell i bardhë...”¹⁶; në këngën *Muja e Halili rrethohen në kullë* të lahutarit Shahsivar Sadiku nga Bare, Shala e Mitrovicës, kreshniku i lutet allahut: “Qyr Delija allahit ju ka lutë:/-Ni erë t’hollë prej bjeshke me ma lshue/ tanë kët tim e megjull m’e largue/për me pa e me mujtë me lfitue”.¹⁷ Protagonistit të këngës *Zuku Bajraktar*, mbledhur në Malci të Madhe, Shalë, sytë e verbuar ia shërojnë Orët e Malit,¹⁸ “...ndërsa Hasan Agës së ri, motërrim me plot elemente të reja në krahësim me të tjerët, sytë i vijnë si kushtëzim i pastërtisë morale, sepse nuk pranon të dashurojë gruan e Karahak Shabanit, i cili kishte marrë Hasanin e verbër për ta mbajtur e kujdesur në shtëpi, e kur e shoqja e mirëbërësit desht ta keqpërdorë këtë moment, Hyseni e mallkoi dhe ajo u verbua e atij i erdhën sytë, zgjidhje kjo në shtratin fetar, por gjithsesi si refleksim i botëkuptimit popullor.”¹⁹

2. Është më e theksuar prirja çmitizuese. Në tekstet e zonës lindore nuk ka gjurmë të ndonjë hyjneshe të etnomjekësisë apo të riteve të etnomjekësisë. Në vend të Zanave e të Orëve të malit, të gjarprit me nëntë melheme nën gjuhë, kreshnikët e plagosur i shërojnë doktorët: “Ça m’e pa at Bylykbashe Mujën-/t’dytën dit-o natje kur po çohet,/ pak ma mirë, bre, Muja qi ka ba./ Eu m’i britke Ajkune Devojkës:/A ngo kha, moj motra bash e jeme!/Çpejt n’çarshi, ti, motër, për me dalë,/E t’m’i prush ti dymdhet-o doktor!”²⁰

3. Gjurmët e kultit të ujkut janë zbehur fare. Elementi mitik që është i pranishëm në këngët e zonës perëndimore, në zonën lindore ka përfunduar në një element thjesht estetik, siç është figura e krahasimit: “I paymri ish kjenë petë në mal./Si ujku i palua kur kqyr gjanë,/i lyp me sy ma t’mirat ku janë...”²¹.

4. Ndryshon objekti ku banon shpirti i jashtëm i Zanave të Malit. Në qoftë se sipas teksteve të mbledhura në zonën perëndimore, ai banon te dhitë e egra, ndonjëherë edhe te pëllumbi, në zonën lindore, banon te dy rosa të buta dhe te kaprolli: “-A ngo khâ, moj nusja bash e mirë!/Kët kuvet m’e ditë ti ku e kam/n’Dri të Zi i kam dy rosa t’ buta,/n’Bjeshkë të kuqe ni kapruell e kam...”²²

¹² Epika legjendare, I, Tiranë, 1966, f. 76 (Më tej, EL, 1)

¹³ Po aty, f. 342

¹⁴ Po aty, f. 51

¹⁵ Këngë kreshnike, III, Prishtinë, 1993, f. 259 (Më tej, KK, III)

¹⁶ EL, I, f. 468

¹⁷ Këngë kreshnike, i, Prishtinë, 1974, f.37 (Më tej KK, I)

¹⁸ EL, I, f. 129

¹⁹ Dr. Demush Shala, Rreth këngëve kreshnike shqiptare, Prishtinë, 1985, f.308

²⁰ KK, III, f. 385

²¹ Po aty, f. 241

²² KK, I, f. 7

5. Është tkurrur shumë kulti i gjarprit, i cili mbijeton te ndonjë antroponim si Gjarpan Aga: “Hej m’ish kan-e aga Gjarpan Aga...”²³. Në vend të tre gjarpërinjve mitikë, kreshniku me fuqi mbinjërëzore ka në bark tri zemra: “Sa mirë Muja e kishte zdrue./Edhe krijet Savës ia kish marrë./ Ene zemrën kur ja ka çel,/Tre zemra Sava ka pas.”²⁴

6. Mungon tregimi mitik për lindjen e mëzit të mrekullueshëm siç ndodh në këngën *Gjogu i Mujit*, mbledhur në Malci të Madhe, Shalë: “Shpejt Ajkuna n’kambë asht çue,/po ma merr pishën në dorë,/m’ish kanë nata natë me orë,/kur ka ra grueja nderë të burgut./hingëlloi mazi mbrenda burgut,/ m’i ra drita qymes s’shtatit,/ ndriti qymja si bora e malit,/hyllin bardh shkruie n’shtet të ballit”²⁵

7.Nuk haset metamorfoza finaliste e kthimit të njerëzve në shpendë, por vetëm ajo e kthimit në bimë. Në këngën *Nanës Hasanit ka shkue i ka kallxue* të kënduar nga Daut Beqiri nga fshati Xhepçisht i Tetovës, thuhet: “N’vorr të gjalit ka bij trandofil,/N’vorr të çikës ka bij karanfil,/N’vorr t’haxhuzes kishte bij kaçen.”²⁶

8. Mungon miti i ringjalljes së kreshnikut të vdekur, siç ndodh në këngët *Muji i varruem*,²⁷ *Muji mbas deket* etj...²⁸

9. Mungon miti i mbylljes së kreshnikëve në shpellë pas shpikjes së armës së zjarrit siç ndodh në tekstet e zonës perëndimore: *Në shpellë të kreshnikëve*,²⁹ *Kur dul pushka s’parit*³⁰, *Në shpellën e Kreshnikëve* etj.³¹

10. Mungon motivi i vajtimit të Ajkunës mbi djalin e vrarë në luftë e të varrosur në bjeshkë, siç ndodh në *Këngën Ajkuna kjan Omerin*.³²

11. Janë më të rralla mbijetesat e ritit të inicimit luftarak, kur kreshniku i ri këput disa fije litar ose qëndron disa ditë në Bjeshkën e Thatë pa ngrënë bukë e pa pirë ujë.

12. Mungojnë elemente të tilla të mrekullishme si ujku që kryen porosinë e kreshnikut të burgosur apo këmisha që rri me vite të tëra pa u larë dhe pa u ndotur etj.

13. Ndeshen më rrallë ose mungojnë fare disa objekte magjike si bari magjik për të hapur derën e kullës së kundërshtarit,³³ shpata magjike, sofa e praruar, froni i praruar etj.

14. Në librin e tij *Les Slaves de Turquie*, Cyprien Robert shkruan: “Kjo krenari kombëtare (e shqiptarëve, N.P.), i bën të kenë përbuzje të madhe për turqit. Osmanlliu është i mirë vetëm për të ngrënë çorbë, thonë ata”.³⁴ Qëndrimi për të cilin flet C.Robert-i është shprehur edhe në këngët tona popullore, të cilat përshkohen nga një frymë e theksuar antiosmane “...nga milli u del u del jatagani/ në Stamboll dridhet sulltani.”³⁵ Kjo frymë është e pranishme edhe në këngët kreshnike shqiptare, ndonëse aty-këtu mund të nxjerrë krye edhe fryma proturke. Nga përmbledhjet e botuara deri sot, bie në sy se fryma proturke është më e dukshme në këngët kreshnike të zonës lindore. Pasi pohon se në fshatrat e Kosovës si dhe në Peshter e Sijenicë të Sanxhakut këngët antiosmane nuk ekzistojnë ose u është hequr pjesa e papërshtatur për sulltanin,³⁶ më tutje Veis Sejko thotë: “Qëndrimi antiosman i epikës malësore është e natyrshme të jetë më i zbutur në variantin mysliman kosovar, në të cilin janë hequr pjesët ku cenohet sulltani dhe turqëria”.³⁷ Ky studiues përmend këngën e njohur *Muji tu mbreti*, në të cilën kreshniku shqiptar i variantit të zonës perëndimore e tërheq zvrarrë sulltanin me gjithë qilim, kurse në variantin kosovar takimi i kreshnikut me sulltanin është i përzemërt.³⁸ Për të shpjeguar këtë dukuri, Sejko bën pohime që qëndrojnë larg të vërtetës: “Kurse Malësia siç dihet, ishte jashtë sundimit të sulltanit”³⁹

Me këngën *Muja e Halili shkojnë në Stamboll* të lahutarit Myrsel Muslia nga Zasella, Shala e Mitrovicës, sulltani i jep Mujit dekorata dhe e përcjell me ceremoni: “E nishanat Mujës ja ka kapë/edhe Mujës sulltani i flet:/-Edhe n’thirrsha, ma ti rue se vjen!/I ka marr-o muzikë e trompetë,/përte shehri djemt-o qi po i qet...”⁴⁰.

Sipas këngës *Muja në Stamoll* që lahutarit Lan I.Morina nga Ostrozubi i Podrimës, kryekreshniku shqiptar ka në Stamboll shumë shokë e miq për kokë: “Qyr, dyrbitë në sy qi po m’i vnon./prej Stambollit dyrbitë po i lshon,/po, tuj thanë:-O zot e i lumi zot,/po nan vjet n’Stamboll qi nuk jam kanë!/Po shum kam, bre, jarana e dosllarë,/paj, për shok-o malli qi m’ka marrë.”⁴¹

Në këngën: *Të shtatë kralat ankohen në Stamboll* të lahutarit Ali A.Dërvishaj nga Drelajt e Rugovës, thuhet se Halili shkon te sulltani si në shtëpinë e një miku: “Kur n’Klladush-e po djerg-o qi janë,/ki pa folë ai Sokolë Halili:/-Aman, bac, pash t’lumin more zot!/ A m’ep izë te krali dua me shkua/e n’mejdan, po, kralit për me i dalë?/Edhe Muja iz-e m’i ka dhanë./ E ç’m’e pa at Sokole Halilin-/e ka marrë, po gjogun e mejdanit/e te mreti n’Turkije m’â shkua,/e ni natë tu mreti e ka ba”.⁴²

Sipas këngës *Halili fiton në dyluftim Gjelinën e Jovanit* të lahutarit Isuf Thaçi nga Gërgoci i Gjakovës, Muji del si mercenar, të cilit sulltani i jepte një pagë mujore: “Shum igball na Ivan kena pasë-/qe ‘i javë Muja n’Stamboll qi â shkue,/ (e) ka thirrë mreti hajllak (rrogë, pagë mujore, N.P) për me i dhanë...”⁴³.

Si dalzotës i sulltanit paraqitet edhe kreshniku i njohur Gjergj Elez Alia: “At’herë â dalë Gjergj Elez Alija./Edhe mbreti duel me e përcjellë./-Udha e mbarë vetëm mbreti qi i tha./Edhe Gjergji dorën ja ka marrë./-A po ngon, bre? dovletit i tha,/se n’luftë, o mret, sa herë qi t’vyen,/ti ni letër mue sall me ma çue”.⁴⁴ Për shërbimet që i ka bërë, edhe këtij kreshniku sulltani i dërgon dekorata të shumta: “Kur njeu ai sulltani i shkretë,/sa kish pasë ba ma nuk bajke qef,/zullumqarin Gjergji qi e ka hjekë./Shum nishana gati i bajke vetë,/shum nishana e sheja i kish gatua/Gjergj Elezit edhe ia ka çua”.⁴⁵

15. Zë një vend më të gjerë shtresa islamike. Për këtë dukuri, etnologia Andromaqi Gjergji ka shkruar: “Por edhe këto ndikime që përmendëm nuk janë ndier me të njëjtin intensitet në gjithë zonën e shtrirjes së ciklit. Ashtu siç ka ndodhur edhe në sfera të tjera të kulturës popullore të kësaj treve, edhe në epikën heroike ndikimin oriental ndihet disi më i fortë në pjesën verilindore të saj”.⁴⁶ I këtij mendimi është edhe studiuesi kosovar Enver Mehmeti: “Prania e elementeve islame, qoftë në balada, qoftë edhe në këngët kreshnike, është më e madhe sidomos në ato zona folklorike në të cilat popullata shqiptare në masë të madhe është islame. Në këtë drejtim dallohen Kosova dhe Maqedonia”.⁴⁷ Më tej, ky studiues shton se në epikën legjendare shqiptare ka këngë me subjekte thjesht religjioze islame, siç janë këngët për Divin Marvon, të lokalizuara në Kosovë, në ambientin e bektashinjve.⁴⁸

Në zonën perendimore, jo vetëm në këngët e lahutarëve të krishterë, por edhe në këngët e lahutarëve myslimanë, ritet fetare islamike mungojnë fare ose janë fare pak të pranishme. Në këngën e Osman Nriçit nga Luzha e Tropojës thuhet: “Se në natjet Muja â çue,/Po pin kafe me shiqer,/Po pin duhan kadaif,/Ka ba qef me kafe e duhan./Nuses vet te m’i ka thirrë...”.⁴⁹ Kështu ndodh edhe në këngën e lahutarit Myftar Zenuni nga Shoshani i Tropojës: “Heret çohet Ali Bajraktari,/ Shum të fshtirë ni anër e kish pa./Xhezen n’zjarm e ka shti/E po pjek kafe me sheqer”.⁵⁰ Në këngën e lahutarit Ram Alia nga Berisha e Tropojës: “Sabah zoti kur ka çilë./Konka çue Sokole Halili,/Ni zjerm të mirë e ka

^[1] KK, III, f. 76

^[2] Po aty, f. 249

^[3] KK, I, f. 55

^[4] KK, III, f. 7


^[5] Po aty, f. 199

^[6] Çështje të folklorit shqiptar, 2, Tiranë, 1986, f. 115

^[7] Prof. dr. Enver Mehmeti, Studime në fushën e letërsisë gojore, Tetovë, 1996, f. 145.

^[8] Po aty, f. 146

^[9] KP Legj., f. 170

^[10] Po aty, f. 237


kallë,/Zhezen n’zjarm e ka shti,/Po pjek kafe me shiqer./Paskan pi kafe me shiqer./”Halil”-Muja i paska thanë...”⁵¹

Përkundrazi, në zonën lindore, protagonistët e këngëve kreshnike i kryejnë në mënyrë sistematike ritet e fesë islame. Në këngën e lahutarit Smajl Selmanmusa nga Strellci i Deçanit thuhet? “Lum e lum, ore i madhi zot!// Se ç’po ban ai Bylykbashe Muja-/heret n’natje Muja kanka çue,/i avdes t’paqët Muja e paska marrë,/mirë sabahin kreshniku po e fal./Zhezven n’zjarm-o Muja e ka ‘ndue,/ka nisë kafe trimi e po pin”.⁵² Të njëjtin veprim, Muji e kryen edhe në këngën e lahutarit Lam S.Morina, nga Oztrozubi i Podrimës: “Lum për ty-o, për zotin të lumin!// Heret Muja n’sabah çue m’ish kanun,/po mirë zjermin dhezun e kish pasun,/po dy zhezve binak qi po i ban,/po m’i merr o xhygym e legen,/e avdes të paqtë ai paska marrun,/paj sabahin me vakt po ma fal”.⁵³

Nga kënga e Isuf F.Thaçit nga Gërgoci i Gjakovës del se Muji nuk praktikonte vetëm faljen e sabahut, por edhe ritet e tjera të fesë islame, në çdo vend që të ndodhej: “Vakti i drekës qat’herë ishte kanë./Muja gjogun n’ledinë si p’e lshon,/asht përvjelë e avdes qi po merr/e n’namaz-o Muja kanka hi”.⁵⁴ Sipas këngës së lahutarit Maliq Tishuku nga Isniqi i Deçanit, para se të niset për të çetuar ose për të luftuar, Muji lutet duke thënë *bismillah*: “Qat’ herë Muja, more, n’kamë â çue,/n’shokë po i shtje ai armët e mejdanit,/ n’shalë po i vjerr ai armët e çetimit,/ n’shpindë po i bje’ o, ou, gjokut të mejdanit,/me bysmele rrugën e ka marrë”.⁵⁵

Në zonën lindore ka disa këngë kreshnike, në të cilat flitet për kremtimin e festës islame të bajramit: “At’herë Muja krejt shokt i tubon,/ni fjalim, atyne po jau mban:/-Ngoni, shokë, bre, Muja çka po u thotë,/na n’Bajram-o kysmet si do t’shkojmë/e Bajramin na domë për m’e falë”.⁵⁶ Në këngën e lahutarit Ejup Gërbeshi nga Marevci i Gollakut, është brendatrupëzuar (inkorporuar) riti islamik, me të cilin përcillet i vdekuri: “E kush don, shokë, me ardh-o me mue,/e kush don, shokë, me ne me ardhë,/ e qefinin me veti me e marrë,/e qefinin me veti e marrim/e talkinin shoqishojt ia thrasim”.⁵⁷

Në ndonjë rast, ritet islamike janë përfshirë edhe në ceremonialin e dasmës, siç ndodh në këngën e lahutarit Isuf Thaçi nga Gërgoci i Gjakovës: “... at’her hoxhës Tali i ka bërtitë:/-Çou, bre hoxhë, ti duvanë me na ba/se na dona dhanrrin për m’e shti!”.⁵⁸ Në vend të kanunit tradicional dhe autokton, marrëdhëniet shoqërore rregullohen sipas *sheriatit*, siç vëmë re në një këngë tjetër të lahutarit të sapopërmendur: “Mujs Sherjati po nusën ja jep,/se ma s’pari Muja e ka lypë...”⁵⁹

Disa personazhe të këngëve kreshnike betohen për *allahun*: Në këngën e Ejup Gërbeshit nga Marovci i Gollakut: “Njike Muja, po m’i vjen koskan./ Be nëallahin Muja qi po ban,/be nëallahin Muja kish marue...”.⁶⁰ Në këngën e lahutarit Halim Dauti nga Vllahia, Shala e Mitrovicës: “At’here nusja niske edhe p’e dvet: -Pas ni zot, moj nanë, ti me m’kallxue,/pash allahin, nane, qi t’ka falë...”⁶¹. Në këngën e lahutarit Adem S.Kurtaj nga Stankajt e Rugovës, edhe një personazh i krishterë, siç është Velike Kokona betohet në *kuran*: “-Po t’përbej, Halil, bre, në Kuran,/pash ni zot, bre, ty-o qi t’ka falë,/me duer t’mija veshë unë ty të kam”.⁶²

^[63] Po aty, f. 296

^[64] KK, I, f. 99

^[65] KK, III, f. 76

^[66] Po aty, f. 184

^[67] Po aty, f. 201

^[68] KK, I, f. 49

^[69] Po aty, f. 70

^[70] KK, I, f. 311

^[71] KK, III, f. 399

^[72] KK, I, f. 182

^[73] Po aty, f. 6

^[74] KK, III, f. 92

Në ndonjë rast, islamizmi ka depërtuar deri në indin gjuhësor të tekstit. Në zonën perëndimore, ngritja në këmbë me vrull e kreshnikut, shprehet me anë të ndajfoljes onomatopeike shqipe *braf* ose *praf*: “Muja at’fjalë kur e ka ndigjue./*braf*, në kambë atbotë ashtu çue...”⁶³ Ose: *Braf* në kambë Agë Turku asht çue...”⁶⁴: “Gjumi djalit i ka dalë,/ *praf*, në kambë djali ashtu çue...”⁶⁵ . Nën zonën lindore, në vend të ndajfoljes së mësipërme përdoret ndajfolja *jallah* apo trajtat e saj *jollah*, *jolla*. Në këngën e lahutarit Myrsel Muslia nga Zasella, Shala e Mitrovicës: “Qy ky Muja at’herë çka maron/*jallah* Muja, bre, po çohet n’kamë...”⁶⁶ . Në këngën e lahutarit Nezir Keqa nga Kotorri i Drenicës: “*jollah* n’kamë tu krali shpejt a shkue.”⁶⁷ Në këngën e Cenë Latifit nga Zasella, Shala e Mitrovicës: “*jolla* n’kamë, bre, Muja na u çue”.⁶⁸

Përveç elementeve religjioze të islamizit, në këngët kreshnike ka edhe elemente të tjera orientale. Në këngën e lahutarit Shaban Groshi nga Shkreli i Rugovës, vajzën bukuroshe të veshur si djalë, shërbëtorët e begut nuk e krahasojnë me Zanën e malit, por me figurën orientale të *pehrrisë*: “..., shoqi i ktij kurr n’kulla s’na ka dalë/ me kjenë djali si *pehrr*i në mal”.⁶⁹ Elementet orientale janë të pranishme edhe në rrafshin etnografik. Kështu në këngën e lahutarit Halil Mehmetaj nga Trubovci i Istokut kreshniku shqiptar paraqitet i veshur me *shallvare*: “krejt *shallvaret*-o copa po i ban”.⁷⁰ Ndikim i kulturës orientale duhet të jetë parapëlqimi i këngëve të dashurisë nga kreshniku, siç del nga kënga e lahutarit Halil Mehmetaj nga Trubovci i Istokut: “Halil Aga qeftue m’ish kanë,/ sa me qejf-o djali e ka marrë,/mirë po i bjen e ma mirë qi po i këndon,/ kush e ndjeu, pa mend e ka lanë-/ e ka marrë at kangën arshikisht”⁷¹

16.Ka personazhe që mungojnë në zonën perëndimdore si Bejno Bajraktari,⁷² Igjidi Brahimi,⁷³ Shishman Mehmet Aga⁷⁴, Emin Mixha,⁷⁵ Mevlan i Ali Agës,⁷⁶ Zilfi Çalija⁷⁷, Tankosa e Bardhë,⁷⁸ Krashnajk Rama,⁷⁹ Ban Çunguri,⁸⁰ Ali Janadoba⁸¹, Exhini,⁸² Lluka i Banjallukës,⁸³ Krajkovi Shabani,⁸⁴ Momqi i Anadollit,⁸⁵ Dollcja i Anadollit,⁸⁶ Simone Vukani,⁸⁷ Janko Kapetani,⁸⁸ Ahmet Bylikbashi⁸⁹, Sheish Mehmet Aga,⁹⁰ Millosh Grebeni,⁹¹ Stavre Kapedani,⁹² Gjarpan Aga,⁹³ Nevlen Alia⁹⁴ etj.

17. Është i pranishëm elementi hebraik: “Halili vret Qyrte Jahudinë”.⁹⁵

18. Përmenden më rrallë toponimet legjendare si Lugjet e Verdha, Kunora e Bjeshkës etj. Vihen në qarkullim toponime të reja, të palokalizuara si *Kraleva*: “Muo izmetin ti mo ma harrojsh,/ene Bejnon n’Kralevë mo ma lejsh!”,⁹⁶ ose toponime reale dhe historike: “Ani Zoti sabah kur e fal/qyr çka bajke begu i *Pazarit*...”⁹⁷ dhe: “-Fol, bre djalë, Mitati i ki thanë./Kur të bim-o në fusha t’Banatit”⁹⁸

19. Në vend të trajtës *Tunë* që përdoret në zonën perendimore: “ A p’e shef qat lumë të gjanë?/Atje i thonë “te lumi i Tunës”,⁹⁹ në zonën lindore mbizotëron trajta sllave, *Dunava*: “Ngat Dunava krejt ish kanë qillue...”,¹⁰⁰ “Tim Alija gjogin qi p’e ban/merrke rrugëve n’Nemc për me shkue./Kur po shkojke n’stom t’Dunavës s’Zezë...”¹⁰¹.

20. Motivi i kushtit që është i pranishëm edhe

^[63] EL, I, f. 534

^[64] Po aty, f. 497

^[65] Po aty, f. 398

^[66] KK, I, f. 76

^[67] KK, III, f. 371

^[68] KK, I, f. 106

^[69] Po aty, 342

^[70] Po aty, f. 113

^[71] Po aty, f. 112

^[72] Dr. Qemal Murati, Këngë të moçme kërcovare, Tetovë, 2000, f. 68, 75 dhe H. Osmani, vep. E cit, f.226

^[73] Q. Murati, vep. e cit., f.83, 88

^[74] Po aty, f. 91, 94, H. Osmani, vep. e cit., f. 177, 179

^[75] Q. Murati, vep. e cit., f. 105, 109

^[76] H. Osmani, vep. e cit, f.221, 248

^[77] Po aty, f. 243

^[78] KK, I, f. 222

^[79] Po aty, f. 298

^[80] Këngë kreshnike II, Prishtinë, 1991, f. 28, 360

^[81] Po aty, f. 46

^[82] Po aty, f. 62

^[83] Po aty, f. 144

^[84] Po aty, f. 197

^[85] Po aty, f. 213

^[86] Po aty, f. 267

^[87] Po aty, f. 323, 420

^[88] Po aty, f. 471

^[89] Po aty, f. 498

^[90] KK, III, f. 61

^[91] Po aty, f. 61

^[92] Po aty, f. 144

^[93] Po aty, f. 155

^[94] Po aty, f. 332

^[95] Po aty, f. 48

^[96] Po aty, f. 198

^[97] Po aty, f. 189

^[98] Po aty, f. 210

^[99] EL, I, f. 76

^[100] KK, III, f. 24

^[101] Po aty, f. 314

^[23] KK, III, f. 155

^[24] Hafezat Osmani, Epikë popullore shqiptare, Shkup, 1999, f. 130

^[25] EL, I, f. 109

^[26] H. Osmani, vep. e cit., f. 262

^[27] EL, I, f. 253

^[28] Po aty, f. 255

^[29] Këngë popullore legjendare, Tiranë, 1955, f. 300 (Më tej KP Legj.)

^[30] EL, I, f. 365

^[31] Sokol Martini, Kangë kreshnike, Tiranë, 2004, f. 155

^[32] EL, I, f. 247

^[33] Po aty, f.65

^[34] Cyprien Robert, Les Slaves de Turquie, Paris, 1844, f. 134

^[35] Dhimitër S. Shuteriqi, Nga kënga e popullit, Tiranë, 1991, f. 481

^[36] V. Sejko, vep. e cit., f. 47-48

^[37] Po aty, f. 220

^[38] Po aty, f. 220

^[39] Po aty, f. 220

^[40] KK, I, f. 79

në epikën arbëreshe,¹⁰² që shtjellohet gjerë e gjatë në zonën perëndimore,¹⁰³ në zonën lindore mungon fare.

21. Nuk ka tekste heroike-komike të tipit Gjeloshe Onbashi,¹⁰⁴ Martesa e Plakut Qefanak,⁴ Qerosi frikakac⁵ etj.

22. Është modifikuar figura e Tali Budalinit, i cili në tekstet e zonën perëndimore përfaqëson një kreshnik bablok, të dhënë pas gostive e të pirit: “Se aj t’kish kenë Kreshti raki m’e pijë,/ kurr s’e lëshon Tali Budali...”,⁶ kurse në tekstet e zonës lindore paraqitet si një plak i urtë, i shtruar, që mundohet të shmangë grindjet e ngatërresat, që me ndërhyrjen e tij vendimtare ndryshon fatin e luftimit etj.

23. Gjatë dyluftimeve nuk ka skena të plota dhe dramatike, siç ndodh në këngët e zonës perëndimore si *Gjergj Elez Alija*⁷ apo *Muji e Behuri*.⁸

24. Mungon motivi i pabesisë së vëllamit.⁹

25. Mungon motivi i dhunuesit të vendeve të shenjta.¹⁰

26. Mungon riti pagan i gjamës.¹¹

27. Zë vend më të madh motivi i çlirimit të robërve e të robinave.

28. Përgjithësisht femra është më pasive dhe nuk merr guximin të kundërshtojë meshkujt, siç ndodh në ndonjë rast në tekstet e zonës perëndimore.¹²

29. Ka më pak tekste që trajtojnë luftën për mbrojtjen e kullotave nga pushtimi i *shkqeve*. Kjo gjë mund të shpjegohet me faktin se shtegtimi i kopeve (transhumanca) do të ketë qenë më e kufizuar në viset fushore të Kosovës në krahasim me malësitë e Veriut ku dega kryesore e ekonomisë ka qenë blegtoria. Në Kosovë nuk ka qenë fjala thjesht për të mbrojtur kullotat malore , bjeshkët, po për të mbrojtur tërë territorin, sidomos tokat pjellore, të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, të cilat lakmoheshin nga ardhacakët sllavë.

30. Nuk ka skena me të ngrëna e me të pira që e kalojnë masën, siç ndodh shumë herë në këngët e zonës perëndimore. Shkaku i kufizimit të të pirave, sidomos verës, duhet të jetë përkatësia islame e bartësve dhe e auditorit të këngëve kreshnike, të cilët në jetën e përditshme e kishin të ndaluar të pinin verë e raki. Sipas këngës *Tridhet’ag’ n’llanxh’ kan’ msy* të lahutarit Shaban Groshi nga Shkreli i Rugovës: “Një haxhi i këshillon agët të lenë rakinë e t’ua kushtojnë jetën fesë...”¹³.

31. Ka më shumë versione për këngën e Gjergj Elez Alisë, i cili del edhe me emra të tjerë. Mendoj se në disa nga këto versione ka më shumë ndikime nga epika boshnjake. Madje në ndonjë tekst thuhet shkoqur se ky kreshnik ishte nga Bosnja: “Veç ni njeri s’po din ai m’e thirrë/n’fund të Bosnjes Gjergj Elez Alija.”¹⁴

32. Është trajtuar më gjerësisht figura e Musës Kesexhi. Kjo është fare e natyrshme, po të kemi parasysh se, siç del nga epika legjendare, ky kreshnik i ka zhvilluar bëmat e tij trimërore në Prilep e në Kaçanik: “Prej hysmetit t’Mbretit na ka dalë,/n’Lug t’Prejlepes kullat m’i ka ngrehë...”¹⁵. “-Për çish punë nuk e di./E kina menden të t’çojmë n’Kaçanejk./Po tej Musën të xhallë të na e bish”.¹⁶

33. Në disa tekste të epikës legjendare ashtu si dhe në ndonjë baladë janë ndërkallur më shumë elemente nga jeta qytetare. Këtë dukuri e ka vënë në dukje edhe studiuesi E.Mehmeti: “Kështu, në variantin urban të baladës mbi dashurinë tragjike të dy të rinjve ngjarja zhvillohet krejtësisht në një ambient qytetar oriental”.¹⁷

Elemente të jetës qytetare, të ndërkallura në këngët kreshnike të zonës lindore janë:

Kundrat (këpucët): “Kunrat n’kamë, bre, djali i ka shti...”¹⁸.

Tuxharët, dyqanet: “Vrafti zoti tuxharë e zotni,/para dugajs të gjithë tek kanë msy...”¹⁹

Bahçja me lule: “...tridhetë çika qaty si i gjan,/aty e kan-o bahçen sall me lula...”²⁰.

Dysheku i mbushur me pupla dhe çarçafti: “Kqyr shka bani Pasha Osman Pasha:/ni dyshek

sa t’mirë qi po ja shtron/krejt i mushun n’perna të gusanit/e qarshafin përmi po ja qet”.²¹ Ose: “Ni dyshek, po, çika e ka shtrue/ krejt i mushur n’pendla të gusanit.”²²

Hamami: “E ka marrë e n’hamam e ka çue,/hyzmeqarin me ujë po ja çon./ja ka lanë sapunin në skamli”²³

Çadra e kuqe: Pasi e ka veshur Halilin si vajzë, për ta maskuar, Velike Kokona i jep edhe një çadër nga ato që mbajnë zonjat dhe zonjushat e qytetit: “Çadër t’kuqe në dorë i ka dhanë”.²⁴

34.Shtohet elementi tregimtar, kurse elementet lirike vijjnë duke u rrudhur. Kështu, vihet re se në këngët kreshnike të zonës lindore mungojnë sekuencat me karakter tragjik, janë pakësuar përjetimet e personazheve, të shprehura me anë të monologut të brendshëm etj.

35. Në tekstet e epikës legjendare është më e dukshme prania e historicitetit: “Ai, zoti sabah kur e fal./qyr çka bajke Begu i Pazarit-/kët tellallin qi p’e qet:”/A ka ba, bre, nana kun ni djalë,/a ka rritun motra kun ni vlla/e ni letër, thotë, ai për m’e marrë/ n’Kosovë t’gjan-o letrën për m’e qitë/ me ja dhanun Begut Ahmet Beg?”²⁵

36. Përdoret më dendur etnonimi *shqiptar*. Dy mund të jenë shkaqet e kësaj shpeshtësie: kjo zonë ka qenë më e rrezikuar nga procesi i shkombëtarizimit dhe i asimilimit; këngët janë mbledhur në një periudhë më të vonë kur ishte rritur në një shkallë më të lartë vetëdija kombëtare, kur edhe te njerëzit e thjeshtë ishte ngulitur dallimi midis fesë dhe kombësisë: “Qyr shka bani Gjyre Bylykbashi:/ n’terzihane, bre, Gjura à hi./ *shqiptarisht* ai teshat i ka veshë,/ ka marrë rrugën n’Jutbinë ish kenë ra...”²⁶.

37.Motivi i kapjes së lepurit në mal dhe i bashkimit të tij me tufën e kecape nuk është integruar në këngën për Imerin e Mujit, siç ndodh në zonën perëndimore, por në këngën për një kreshnik tjetër të mitur, për Ahmetin e Ri:” E po shkon Ahmeti n’mal me dhi;/ n’menges djali dhitë, tha, po i bien./kah po vjen ai ni lepur p’e nxen/e n’pojat me dhi p’e ngujon”.²⁷

38.Përqëndrimi i madh i kreshnikëve nuk shprehet me anë të klishesë epike se ata e shikojnë barin që rritet, por me detaje të tjera: “Tridhet shkie kryet p’e palojnë,/ ver me gojë kurrnjani qi s’po ban”.²⁸

39.Ndryshe nga këngët e zonës perëndimore ku zakonisht dasma zgjaste tri javë, në këngët e zonës lindore më së shpeshti dasma zgjat tri ditë: “...mirë po kcejnë, heu, krushqt e mirë po knojnë./Tri ditë Muja dasmën nuk e nali”.²⁹ Ose i “Mejherë dasmën aty e paskan kallë, tri ditë dasmën-o nuk e kanë nalë”.³⁰

40. Në luftimet e tyre, kreshnikët përdorin kryesisht armët e zjarrit, sidomos pushkën.

41. Për të dhënë kushtrimin, përdoret vetëm pushka habertare. Nuk përmendet edhe topi habertar, siç ndodh në zonën perëndimore.

42. Është më e kufizuar prirja që këngët kreshnike të asimilojnë baladat.

43. Është në rënie dukuria e hiperbolizimit. Bie fjala, për të zënë kafshët ku ndodhet shpirti i jashtëm i zanave, Muji i zonës perëndimodore mbledh qindra gjahtarë, zagarë e langoj: “Shpejt janë mbledhë treqind gjahtarë,/me shtatëqind e me zagarë,/me treqind e ma langoj./derën Mujit ja kanë msy”.³¹ Për të kryer të njëjtin veprim, Muji i zonës lindore shkon fillikat, merr me vete vetëm dy langoj e një zagar: “Përmas Muja gjogun qi p’e kthen, / n’kullë të vet, bre, Muja qi po shkon,/m’i ushqejke dy langojt e vet,/ ma ushqejke zagarin e vet./Gjogut n’shpinë, more, Muja po m’i bien,/dogri shkojke n’stom të Drinit t’Zi”.³²

44.Ka vepruar më fuqishëm ligji i modifikimit, i cili ka sjellë risi (rinovime) të shumta. Kur Muji i gjen dy fëmijët e zanave të lidhur në djep, ata kërcënoheshin edhe nga korbat që donin t’ua kërrenin sytë: “Shkoi tu ga-po çka me pa me sy /ndjepa t’lidhun ishin kjenë dy thmi./ra u kishin, po, korbat përmi./dojshin t’shkretët, shih, më i lanë pa sy”.³³

Muji që merr fuqi mbinjerëzore nga zanat nuk e mat forcën e tij duke ngritur një gur një mijë okësh si në zonën perëndimore,³⁴ por duke shkulur një lis: “Përgjashtë shpelle e madhja po na qet,/ â avitë e gji sa shum po i jep./U avit djali, lisit po ja ngjet,/n’t’djathhtë e n’ t’shmajhtë sa fuqi qi po i jep,/ me gjithë rrajë prej toke po ma hjek./

^[1] Po aty, f. 319

^[2] KK, III, 376

^[3] KK, I, f. 322

^[4] KK, III, f. 92

^[5] Po aty, f. 189

^[6] KK, I, f. 314

^[7] KK, III, f. 155

^[8] Po aty, f. 115

^[9] KK, I, f. 9

^[10] Po aty, f. 93

^[11] EL, I, f. 57

^[12] KK, I, f. 7

^[13] Po aty, f. 2


^[14] EL, I, f.105


Figura e Muja Elez Alija, nga Kujtim Zeka

e gjoj djalë n’prua si t’ish kjenë i fletë”.³⁵

Në tekstet e zonës perëndimore, Muji u kthen dhitë e egra dhe vëllamërohet me zanat, pasi këto të fundit i sjellin nusen dhe krushqit, kurse në tekstet e zonës lindore, ai ua pret kokën zanave: “...prej Klladushe krushqit po fillojnë./Qat’herë Muja çallgitë kur po i ndien./Qat’herë Muja shpatën po ma nxieri,/trijave kryet mejherë ua shkurton”.³⁶

Kur grinden Muji dhe Halili, në tekstet e zonës lindore, nëna i këshillon të bijtë që ta zgjidhin mosmarrëveshjen midis tyre, duke shkuar te *kadia*: “ Nana e vet-o Mujës ça i kish thanë:/-Hiç, bre Mujë, nër vedi mos u kapni./shyqyr asht kadija i hyqymetit;/te kadija shkoni ju e pvetnu”.³⁷

Në një variant të këngës për Gjergj Elez Alinë, Arapi i Zi paraqitet si një përbindësh me tri koka: “As m’e pa at Harapin e Zi/shih, tre krena ai në krye m’i ki...”³⁸ Në një variant tjetër të po kësaj kënge, kreshniku del si një bujk që është aq i fuqishëm sa ngre lart parmendën bashkë me qetë, për t’u treguar drejtimin e duhur atyre që e pyesin: “Ku e ka shpin-o njaj Elez Alija?/Lezi vetë e trimi kish qillue/e parmenda na i kish qillue;/me gjithë qe n’hava ai parmendën ma kish çue,/andaj rrugën-o jau kish kallxue.”³⁹

Në një variant të zonës lindore për vajzën luftëtare, kur merr vesh të vërtetën, dhëndri nuk pranon të hyjë në gjerdek me nusen, e cila detyrohet të kthehet përsëri në derë të babait: “Aman nana djalin po m’ja thrret./Dej te dera begu vijke shpejt./Nxuer unazën çika e po m’ja ep./Mirë po e di kush à begu i shkrehtë-/iku begu e s’hini n’xherdek./U kthye Fata çikë në shpi të vet”.⁴⁰

45. Në ndonjë tekst të zonës lindore është brendatrupëzuar motivi i Përmbytjes së Madhe, i cili është i pranishëm në epin e Gilgameshit.⁴¹ Në këngën *Muja e mbyt djalin e vet tue e shtrëngue prej malli* të lahutarit Sefer B.Krasniqi nga Juniku i Deçanit, thuhet: “Lum e lum-o, lum bafshin për veti!/Çudi e madhe ka ndodhë në Klladushë-/tri javë dit-o shi qi kish pasë ra./ shi i madh, heu mos raftë me e harrue!/Tri javë ditë gjimue kish pasë moti,/n’bark të nanës fëmija me u tremë./Fort kish vra, bre, reja, koftë e bardhë!./Ka lanë, besa shum nana pa djem,/sa shum lisa ajo ka shkrumue./Janë la n’ujë, mor, mali edhe fusha./Janë çue projekt sikur lumej t’ishin./. Veç kjameti te dera kish ardhë,/si di zoti, i madhi, për me e prue,/robt e vet të tan-o me i marrë”.⁴²

46.Ka ndonjë gjurmë të zbehtë të mitit që bën fjalë për shkatërrimin e botës: “-Mos u tut, bre daja Kahriman./se kshtu emër zoti-o ka bo!/-Athue gjolet sod-o po gjimojnë/edhe toka po don me na lshue?”⁴³

B. NË FORMËN E TEKSTEVE

1. Është më i rrudhur elementi estetik, janë më të pakta figurat stilistike.

2. Janë më të rralla përshkrimet e natyrës, mungojnë fare peizazhet alpine si ai që gjendet te kënga *Martesa e Halilit*⁴⁴ e mbledhur në Curraj të Epër.

3. Mungojnë portretet fizike të personazheve si ato që hasen në këngët e zonës perëndimore: “A e do, bijë, Gjeto Mujin?/S’e ka shoqin ka vrà e ka kthjell,/E ka ftyrën ma kuq se gjaku,/T’dy

^[45] KK, I, f. 3

^[46] Po aty, f. 8

^[47] Po aty, f. 187

^[48] KK, III, f. 13

^[49] Po aty, f. 37

^[50] KK, I, f. 347

^[51] Epi i Gilgameshit, Tiranë, 1990, f. 103-104

^[52] KK, III, f. 225

^[53] Po aty, f. 336

^[54] EL, I, f. 71

mustakt i ka lidhë mbas krahi”.⁴⁵

4. Në vend të hyrjes përthirrëse (invokative) “Lum për ty, o zot e i lumë zot!”, përdoren edhe klishe të tjera atipike si: “Paj m’e pa, bre, ni çudën të vogël./çudë e vogël ser’ m’e pa me sy!”⁴⁶ Ose? “Lum për ty, o për ditën e sodit!”⁴⁷; “A m’e pa, bre, ni çud-o m’e ni!”⁴⁸. Në ndonjë rast, në formulën pagane integrohen elemente të islamizmit: “Lum për ty, o zot e i lumi zot!/Çka m’e pa, bre, ni seri të madh-/ tridhetë dit-o turku po i ninon,/n’tridhet e nja Bajramin e feston”.⁴⁹

5. Përgjithësisht këngët e zonës lindore janë më të zgjatura, më të mbufatura, megjithëse asnjëherë nuk arrihet në epicizim. Në studimin e tij *Vajzat luftëtare*, E Mehmeti shkruan: “Variantet e grupit të dytë të shënuara në pika të ndryshme në Kosovë, të cilat në pikëpamje të motivit qëndror korrespondojnë me variantet qëndrore të eposit si dhe me përrallat mbi vajzën luftëtare janë më të gjata, i karakterizon fryrja e syzheut, shpeshherë degëzimi i syzheut etj. Në to, dialogun e zëvendëson përshkrimi, stilizimi dhe narracioni i gjerë epik. Faktorët e tillë të strukturën kompozicionale, ndryshe nga variantet e grupit të parë bëjnë që syzheu i këtyre këngëve të mbufaset: Prandaj në epikën tonë legjendare si dhe në këto variante është një proces i vonshëm”.⁵⁰ Edhe Shaban Sinani ka vënë në dukje se variantet e rapsodive shqiptare të kreshnikëve vijnë duke u zmadhuar sa më shumë që i largohen vatrës qëndrore në drejtim verior, duke pësuar një humbje cilësore.⁵¹

6. Nuk ka tekste me strukturë dialogjike si Gjuri Harambash.⁵²

7.Heterometria ndeshet më rrallë. Parapëlqehen vargjet e gjata si:’ani, e o n’drrasë të gjoksit plumat e po i bijshin...”.⁵³ “N’Drum të Gjanë, more, trimat sa shpejt janë dalë”.⁵⁴; “Bashkë me gjog prej tok’s Gjergjin p’e hjek...”⁵⁵; “...rrebtë n’shojshojnë me shpata qi kanë sjellë...”⁵⁶.

8. Ndonëse edhe në tekstet e zonës lindore mbizotëron vargu i bardhë, aty haset më shpesh rima siç ndodh në këngët:’Si u ba Muja trim”⁵⁷, “Fatimja e Bardhë i del në mejdan Uroshit”⁵⁸, “Gjergj Elez Alija”⁵⁹; “Lufton motra e Gjergj Elez Alisë”⁶⁰, “Mujin e ban firar mbreti”⁶¹ etj.

9. Mungon enumeracioni epik, me të cilin bëhet paraqitja dhe hierarkizimi i kreshnikëve, siç ndodh në këngët e zonës perëndimore: “Çohet Muji atherë na u kite pri./Shikon ma i pari Çetebashe Muja,/Për mas tij Sokole Halili,/Për mas tij Dezdar Ag Osmani,/Mrapa u shkonte Zymeri shtatë vjeç”.⁶²

10. Përdoret më rrallë teknika e rimarrjes, e cila shërben për të krijuar ngadalësimin epik.

11. Gjuha e këngëve kreshnike është më e rënduar me barbarizma që nuk hasen në këngët e zonës perëndimore. Mendoj se këto barbarizma janë pasojë e trysnisë më të madhe që ka ushtruar kultura sllave dhe ajo turko-orientale mbi banorët e Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore.

Sllavizma: “...treqin krushqit në rrugë qi janë dalë,/kanë marrë *horen* sa mirë qi po e luejnë”.⁶³ “Mirë *ponoshin* Muja jau ka dhanë”⁶⁴ : “...edhe Vidën ai e ka *svojitë*”⁶⁵; “Ju hodh gjogu *duarit* përpjetë”;⁶⁶ “...te berbert-o shokt ai ren po i çon,/mirë po i ruen, *gollaki* po i ban”;⁶⁷ “...zemra britë në *llubinë* po m’ja rreh”;⁶⁸ “...e sa t’vinë, tha, *kazar-o* me dhi”;⁶⁹ “Mir pozdravljen Ivani ja ep”.⁷⁰

Turqizmat janë të pranishme në të gjitha epikat e popujve të Ballkanit. Duke folur për këtë dukuri, J.M.Sheptunov bën edhe diferencime: “Në përgjithësi duhet të shënojmë se në eposin serb elementet turke janë më të shumta se në eposin bullgar”.⁷¹

^[45] S. Martini, vep. e cit., f. 70

^[46] KK, I, f. 10

^[47] Po aty, f. 16

^[48] Po aty, f. 202

^[49] Po aty, f. 48

^[50] E. Mehmeti, vep. e cit., f. 134

^[51] Shaban Sinani, Mitologji në eposin e kreshnikëve, Tiranë, 2000, f. 18

^[52] EL, I, f. 455

^[53] KK, II, f. 25

^[54] Po aty, f. 51

^[55] KK, III, f. 13

^[56] Po aty, f. 323

^[57] KK, I, f. 1

^[58] Po aty, f. 334

^[59] KK, III, f. 8

^[60] Po aty, f. 41

^[61] Po aty, f. 237

^[62] KP. Legj., f. 224

^[63] KK, I, f. 97

^[64] Po aty, f. 104

^[65] Po aty, f. 127

^[66] Po aty, f. 206

^[67] Po aty, f. 296

^[68] Po aty, f. 365

^[69] KK, III, f. 17

^[70] KK, III, f. 25

^[71] I. M. Sheptunov, Eposi i sllavëve të jugut, AIKP, Dosja 33+34, f. 18

Disa *turqizma* që nuk ndeshen në këngët e zonës perëndimore janë këto: “...hem me i marrun tridhetë *tallbuhane*...”⁷²; “A ktu je ardhë, bre, bani prej Zadfori,/ mu *jardëm* ti sod ktu për me mshitë?”;⁷³ “... dhetë *jemeke*, thotë, jau paska çue”;⁷⁴; “me kamë t’para gjogu po *kazmit*”;⁷⁵ “Atëherë foli Mehmeti i Ri:/-Nguli kamët *batil* - i ka thanë...”;⁷⁶ “Tridhetë agë shkojn’ Mujën për m’e pa./*Gjeçmisholla*, Bylykbashe Muja”.⁷⁷

12. Përveç krahasimeve të njohura, përdoren edhe krahasime origjinale si: “N’dorë p’e merr at shpatën dimiski,/bash si bukla n’mi rojes i ra;/ shpejt pa krye, tha, ata i ka lanë”.⁷⁸

Janë më të pakta klishetë epike që përdoren për të përshkruar kalërimin e kreshnikut. Mbizotëron formula: “Tim e mjegull kenka bo.”⁷⁹

Nuk ka tekste epike në prozë siç ndodh në zonën perëndimore me tekste të tilla si: “Në Shpellë të kreshnikëve”.⁸⁰

15. Mbylljet klishetike të këngëve kreshnike nuk janë aq të larmishme sa mbylljet e këngëve të zonës perëndimore.

C.NË INTERPRETIM

1. Përveç të kënduarit homofonik, me shoqërim muzikor instrumental, praktikohet edhe të kënduarit bifonik, pa shoqërim muzikor, siç ndodh në Kërçovë të Maqedonisë.⁸¹

2. Lahuta ashtë mënjeluar me shumë nga sharkia dhe çiftelia.

3. Në ndonjë vendbanim të Kosovës përdoret termi sllav *gudaç*.⁸²

4. Në vend të termave teknikë *kangë lahute*, *kangë të moçme*; *kangë kreshnike* etj.,⁸³ për të emërtuar tekstet e epikës legjendare, ndonjë lahutar përdor termin sllav *krainë*.⁸⁴ Lahutari Myrsel Muslia nga Zasella, Shala e Mitrovicës: “S’di a â kanë kshtu apo nuk â kanë: kshtu *krainën* Mujit gjith ja knojnë”.⁸⁵ Lahutari Zymber Istrefi nga Kovaçica, Shala e Mitrovicës: “S’di a â kanë, more, a nuk â kanë;/mos me kan-o, hiç, s’e kishin thanë,/ hem *krainën* hallku nuk ja knojnë”.⁸⁶

5. Ka qenë më e përhapur dhe më e kodifikuar dukuria e të shpërblyerit të këngëtarit me para.⁸⁷

Dallimet midis këngëve kreshnike të mbledhura në zonën perëndimore dhe atyre të mbledhura në zonën lindore kryesisht kanë të bëjnë me elemente apo me tipare të dorës së dytë. Këto dallime nuk kanë çuar në krijimin e dy tipave të veçantë apo të dy traditave poetike të mëvetësishme. Këngët kreshnike që kanë qarkulluar në të dy zonat e lartpërmendura kanë qenë vetëm variante individuale apo krahinore të një tradite epike homogjene dhe unike.

Edhe dallimi më i dukshëm midis këngëve kreshnike të mbledhura në të dy zonat, siç është prania më e madhe e elementeve islamike në tekstet e zonës lindore, nuk e ka cenuar thelbin e tyre, i cili nuk lidhet me përkatësinë fetare të protagonistëve, por me motive të tjera. Për këtë dukuri, Maximilian Lamberti është shprehur kështu: “Por ky ndryshim fetar nuk përmendet asnjëherë si një motiv vendimtar e lëvizës i luftimeve. Motivet vendimtare e lëvizëse janë përhera grabitja e grave, gjahu, dëshira për të marrë diçka (një kalë, një kullë, një grua), dëshira e aventurave”.⁸⁸

Në qoftë se këngët kreshnike shqiptare do të ishin huazuar nga sllavët e jugut, ato do të kishin një lëndë më arkaike dhe me shumë vlera poetike në një trevë fqinje me botën sllave dhe me një komunikim më intensiv me të, siç është zona lindore. Përkundrazi, vihet re se tekstet e mbledhura në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore paraqesin një trajtë më të zhvilluar, përmbajnë rinovime më të shumta sesa tekstet e zonës perëndimore, e cila ka atributet e zonës qëndrore. Përgjithësisht, sa më shumë që janë larguar nga kjo vatrë, është vënë re një rënie relative e cilësisë së këngëve kreshnike dhe një dobësim i forcës së tyre poetike.

Studim krahasues i romanit „Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit“ të Jusuf Buxhovit me rastin e botimit në frëngjisht nga “L’Harmatann” i Parisit

MIDIS KAMYSË DHE KADARESË

Nga Aleksander Zoto

Është e pamundur të pohohet që leximi i “Dekameronit” të Bokaçios, i “Ditarit të murtajës” të Daniel dë Fosee (De Foes), i “Ambre” të Katlen Vinsorit (Kathleen Winsorit), i “Kalorësit mbi çati” të Xhinios (Giono) ose edhe i “L’oeuvre au noir” të Margarita Jursenarit (Marguerete Yourcenar), t’i ketë paraprirë hartimit të “Shënimve të Gjon Nikollë Kazazit” të Jusuf Buxhovit, përderisa ketë vepra, nëse nuk gabohemi, nuk kanë qenë të përkthyer në shqip, pa dyshim, as në serbokroatisht. Nga ana tjetër, është e pamundur të përfytyrohet që Buxhovi të mos ketë njohur romanet e Ismail Kadaresë që i kanë paraprirë romanit të tij, sepse, megjithëse të ndaluar nga pushteti serb, ata kanë qarkulluar midis shqiptarëve të Kosvës, qoftë edhe në pak kopje.

Është e pamundur, gjithashtu, të imagjinohet që Buxhovi nuk e njhte “Murtajën” (La Peste) e Alber Kamysë, këtij klasiku të letërsisë botërore. Pra, është me interes të shohim se si romani i tij, që rrëfen peripecitë e një epidemie murtaje në sfondin e luftës së fshehtë dhe të hapur midis otomanëve dhe shqiptarëve, vendoset në linjën e romanit të Kamysë dhe të disa veprave të Kadaresë dhe takon temën e tyre ose, më saktësisht shtyhem i të shikojmë sesa ai arrin t’u shpëtojë atyreve, të përballojë sfidat që paraqesin këto vepra për të parë, pasi as që mund të vihet në dyshim që ai të ketë pasur synim të vetëm emitimin e tyre, riprodhimin, nëse mund të thuhet, e Kadaresë ose të Kamysë në dorë të dytë; krijimtaria e tij e mëparshme e përjashton a priori një proces të tillë dhe një lexim sadopak i vëmendshëm i “Shënimve të Gjon Nikollë Kazazit” e mbështet këtë mendim.

Në fakt, s’bëhet fjalë për një “remake” (nga angl.”ribërje”) të “Kështjellës”, i pari nga romanet e Kadaresë, të cilat i jemi referuar. Së pari, sepse Buxhovi rrëfen në të për një epidemi murtaje të shkaktuar nga pushtuesit turq, me synimin politik më tepër se ushtarak, kundër banorëve të qytetit dhe të rrethinës së Gjakovës, synimi është të dobësohet pa kthim dhe të gjunjëzohet një komb tashmë i nënshtruar nga qeveria e Portës, por që ruan një karakter tepër të pavarur, duke e qëlluar për vdekje në përmasa të mëdha. Për më tepër veprimi vendoset në një datë të saktë, në vitin 1747, zgjedhje kjo që me siguri nuk është rastësore, por ka një bazë historike në kryengritjen që shpërthyen gjatë shekullit XVIII kundër sundimit osman.

Në romanin “Keshjtjella” përkundrazi, futja e minjve të infektuar në kështjellën e rrethuar përbën një nga manovrat e njëpasnjëshme, me anë të të cilave Tursun pasha përpiqet të bëhet zot i saj; nga ana tjetër, rrëfimi zhvillohet pa referim kronologjik të veçantë dhe ngjarjet shihen kryesisht nga ana turke.Së fundit, nëse Buxhovi, nën shembullin e Kadaresë, aludon për armët bakteriologjike të këtij shekulli, ai zhvillon paralelisht një temë që kolegu i tij i Tiranës vetëm sa e ka skicuar (dhe pa folur për murtajën) në një skaj të novelës së tij “Krushqit janë të ngrirë”:atë të “zgjidhjes përfundimtare” (solution finale), sipas shprehjes së trashëguar nga nazizmi.

Në fund të fundit, vepra e Buxhovit rimerr më tepër sesa përsërist “Kështjellën”, përderisa ajo ilustron dhe zhvillon disa faqe të këtij romani, ku Intendenti parathotë vështërsitë e ardhshme pas pushtimit të Shqipërisë, pavarësisht nga fitorja ushtarake

dhe mjetet që duhen përdorur për ta integruar pëfrundimisht këtë vend në Perandorinë otomane.

Nga ana tjetër, si mund të mos takoheshin rrëfimet e dy romancierëve shqiptarë përderi sa njëri, ashtu dhe tjetri, e kthejnë ballafaqimin e popullit të tyre me otomanët në një metaforë të ndeshjes së tij të sotme kundër shtypësve të tjerë? Kështu shpjegohet, pa dyshim, fakti se rrëfyesi të “Shënimet...”, si dhe ai i Kadaresë te “Ura me tri hare” quhen Gjon dhe janë murgj, pra i referohen që të dy figurës së shquar të Gjon Buzukut, murgut themelue të letërsisë së shkruar shqiptare.

Së fundit, disa konvergjenca janë të pranishme për arsye të referimit të përbashkët (pak a shumë të saktë) te doket dhe zakonet politiko-ushtarake të Perandorisë otomane. Ibrahim Pasha, p.sh., (përveç titullit të tij “kajmekam”) të bën njëherazi të mendosh për Tursun pashën, hero i “Kështjellës” dhe Hurshid pashën, një nga figurat e “Kamares së turpit”, që e di se është i dënuar edhe ai dhe pret vetëm çastin kur koka e tij do të bjerë.Klasifikimi i kombeve të perandorisë në tri kategori – popujt e asimiluar ose të konsideruar si të tillë, popujt në asimilim e sipër dhe, së fundit, popujt rebelë- të kujtojnë gjithashtu pesë etapat që paraprijnë, në të dytin e romaneve të sipërpërmendura, “zhdukjen” e plotë dhe përfundimtare të vendeve që i ninshtroheshin ligjit të “kra-kra”-së.

Këto pika të shumta takimi midis Buxhovit dhe atyreve të Kadaresë për të cilat u fol më sipër, e veçanërisht te “Ura me tri harqe”, janë tepër të dukshme, të pohuara aq qartë sa s’ka vend për të folur për plagjiaturë.Më tepër mund të konkludohet për njëfarë homazhi, me një syshkelje miqësore ndaj veprës së mjeshtrit (vëmë re, në veçanti, që murgu i Buxhovit, po ashtu si dhe i Kadaresë, e nis kronikën e tij në një muaj mars), madje për një lojë shkrimi ndërtekstore, siç e praktikon si një prirje Mishel Turnier, Premtimi i të cilit na jep shembullin më të njohur.Faktikisht, dallimet janë më të shumta se ngjashmëritë, sikur Buxhovi të kish vënë nderin e tij në lojë për t’u shkëputur nga vepra e Kadaresë, duke

e përshëndetur atë në kalim e sipër.Një inventar i shkurtë vetëm i të dhënave materiale që dallojnë dy romanet do të lejonte të gjykojmë për këtë.

Kadareja (rrëfimtari i të cilit i përket një epoke para asaj të Buzukut) mjjfatohet me një emër simbolik – Gjon -, ndërsa Buxhovi i jep të vetit një gjendje civile më të detajuar dhe e lidh shprehimisht me kujtimin e Buzukut, nëpërmjet Colit, beniaminit të tij, i cili ëndërron të çojë më tej veprën e stërgjyshit të vet të madh, duke shpikur alfabemin original që ende s’ e ka gjuha; Gjoni i Kadaresë, pra, del si përfaqësues i Shqipërisë paraotomane, ndërsa nga ai i Buxhovit, që ka si vëlla e kusheri Lam Mulën, i kthyer në mysliman, prej nga del kjo temë ankese, praktikishte e papranishme në veprat e Kadaresë të përmendura këtu:ndarja e popullit shqiptar midis islamizmit dhe krishtëritimit. Dallimi i tretë:figura e emblemore e Buzukut duke si e dyzuar te Buxhovi. Meqë përkthimi i tij i Biblës në shqip saksiononte qenien e një gjuhe dhe të një kulture shekullore, baba i letërsisë shqipe ringjallet njëherazi te Coli, poeti që do të dëshironte të shkruante shkronja të mirëfillta shqipe, dhe te Gjon Nikolla, herë pas here arkitekt si dhe prift e kronik.Një dallim i katërt, së fundi, lidhet me mënyrën e rrëfimit dhe jo më me rrëfimtarin. Te Kadareja, rrëfimi bëhet, si të thuash, me kalim të drejtpërdrejtë nga pena e Gjoni të syri i lexuesit, ndërsa te Buxhovi ka një dyfishim, përsëritja ose “mise en abyme” të aktit të të shkruarit:murgu i tij është jo vetëm autori i kronikës që e lexojmë, pore edhe i një fletoreje shënimesh, me sa duket e caktuar për të ushqyer këtë kronikë, nga e cila ai na jep andej-këndej disa pjesëza. Kështu vetëpërmbajta e shënimeve paraqitet si një nga ngjarjet që përfshin kronika dhe kështu ato bëhen elemente përbërës i saj..Këtu gjejmë sërish, me nuanca të vogla ndryshimesh, mënyrën e famshe të Zhidit te “Prerësit e parave të rreme” (“Les Faux-monneyeurs”), më tepër sesa atë që ka përdorur Kadareja në “Kronikë në gur”, roman ku gjejnë jehonë kujtimet e rrëfimtarit dhe copëza kronikale që u atribuohen dëshmitarëve të tjerë.

Pra, të kuptuara dhe të vendosura siç duhet, afritë që nxorëm midis romanit të Buxhovit dhe këtyre veprave të Kadaresë, na nxisin më tepër kuriozitetin ndaj tij;ato vërtetojnë vlerën dhe peshën e dëshmisë që ky autor sjell mbi fatin e popullit të vet, jo pa e bërë atë shembull, ose e thënë ndryshe, të aftë për një shtrirje përtej vetë Shqipërisë.

Pikërisht këtë përmasë njerëzore të librit kërkojmë të nxjerrim tani, me anë të një paraleleje tjetër, që na fton me ngulm, së paku për nga tema, sepse edhe aty pikëtakimet do të shfaqen shumë më të kufizuara.

Në fakt, romani “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit” i Jusuf Buxhovit nuk është gjithnjë një “remake” e “Murtajës” (“La Peste”) të Kamysë. Së pari, e rithemi, sepse rrëfimi i Buxhovit është vendosur në një kuadër historik, a, të paktën, mëton të jetë një krijim fiktiv me frymëzime historike.Nga ana tjetër, edhe pse konisderatat morale, madje filozofike, të lidhura me fatin e këtij ose të atij personazhi nuk mungojnë dhe kërkojnë meditimn vetjak të çdo lexuesit, ai trajton para së gjithash një avanturë kolektive.Drama e Kamysë prek gjithashtu një bashkësi, por që është, në thelb, mbarë njerëzimi;pra ai të drejton te një entitet

(Vijon në faqen 13)

⁷² KK, I, f. 96

⁷³ Po aty, f. 98

⁷⁴ Po aty, f. 129

⁷⁵ Po aty, f. 136

⁷⁶ KK, III, f. 211

⁷⁷ Po aty, f. 385

⁷⁸ KK, I, f. 21

⁷⁹ H. Osmani, vep. e cit., f. 280

⁸⁰ KP Legj., f. 300

⁸¹ Q. Murati, vep. e cit., f. 17

⁸² Folklorë, III, Shkodër, 1940, f. 8

⁸³ EL, I, f. 7

⁸⁴ Folklorë, III, Shkodër, 1940, f. 6

⁸⁵ KK, I, f. 79

⁸⁶ Po aty, f. 135

⁸⁷ Folklorë, III, Shkodër, 1940, f. 9

⁸⁸ Maximilian Lambertz, Epika popullore e shqiptarëve, Çështje të folklorit shqiptar, 6, Tiranë, 1989, f. 48

1. Parafrazë

“Si është e mundur që eskadronët e vdekjes i kanë shpëtuar ndëshkimit?” (fq. 7) do ta shpreh shqetësimin e tij kryepersonazhi i romanit “Eskadronët e vdekjes”, si fillim i një paralaje në rrugëtimin e trishtë nëpër ngjarje, qofshin ato të sajura, apo të përjetuara, që flasin përmes dëshmime bindëse një periudhe të veçantë të veprimeve barbare të soldateskës serbe mbi një popull të tërë, duke iu mohuar gjithçka, deri edhe jetën. Mbi heroizmin e këtij personazhi sillet gjithë ndërtimi i ngjarjes, e kuptuar drejtë, pavarësisht pasojave që do të ketë.

“Ki kujdes për njerëzit! Atje eskadronët e vdekjes vendosin për jetën dhe vdekjen e të tjerëve. Sidomos të atyre që ua turbullojnë ujin... Ti nuk e di se çfarë janë në gjendje të bëjnë...” (fq. 9). Kjo maksimë do ta përcjell gjatë gjithë rrugëtimin të tij Mifi L. nëpër “kronikën e një kasaphane”, që përshkon gjithë fabulën e romanit.

Romani “Eskadronët e vdekjes” mund të përkufizohet me një fjali që shpalos gjithçka brenda këtij libri, ku vdekja dhe jeta bashkëveprojnë në çdo çast, për të zbërthyer një realitet që bota i bëri sehir për shekuj, por në fund u bind se barbarët gjithmonë mbetin brenda lëkurës së vet të barbarisë së pariparuar. U deshën luftëra, krime, zhdukje masive të njerëzve, që përmes një politike, sa vrasare, aq edhe mashtruese në sy të një bote, që më në fund ta kuptojnë se po këta demokratët e një kohe tjetër dalin të jenë kreatorët e këtyre “veprave”, që sot u vijnë bumerang i fuqishëm, për t’i bërë ta riparojnë gabimin historik. Më në fund, si duket janë bindur se është koha e trajtimit të këtyre “bekimeve” që bënë në konferenca e samite ndërkombëtare të Berlinit, Londrës, etj.

Por, vjen një ditë dhe drejtësia do të triumfojë mbi të gjitha. Mirë është kur ballafaqohen sy më sy e keqja dhe e mira, krimi dhe pafajësia, që të kuptohen qëllimet.

2. Libri që lexohet tri herë dhe një histori e tmerreve

“Asgjë tjetër më fuqishëm nuk mund ta çajë lisin, sa pyka e vet”, thuhet në një proverb popullor. Kryepersonazhi, Mifi L.

Romani “ESKADRONËT E VDEKJES”
(Kronikë e një kasaphane), i Bardhyl Mahmutit

KAPËRCIM NËPËR NËNTË RRATHËT E FERRIT

Nga Xheladin Mjeku



në këtë roman vjen si dëshmitar i denjë, përmes të cilit shihet brendia e këtij lisi, që në fakt ka një trung të kalbur; një zbraztësi që e ka konsumuar koha, por në grahamat e fundit shpreh mllefin e krijuar në shekuj ndaj një populli të pafajshëm dhe liridashës.

Romani “Eskadronët e vdekjes” i Bardhyl Mahmutit sjell të kompletuar me ngjarje e fakte një periudhë gjenocidale në trojet iliro-dardane, ku krimi e dhuna e ushtruar nga një makineri e tërbuar cerberësh realizohen në mënyrë sistematike, duke krijuar kështu një kasaphanë, ku gjejnë vdekjen mijëra njerëz të pafajshëm, të cilët qëndrojnë në trojet e veta, pavarësisht vuajtjeve, torturave, dëbimeve të pafund, por të bindur se mund të prehen të qetë vetëm në krahërorin e tokës së tyre stërgjyshore.

Rrëfimi i ngjarjeve, ndonëse është sjellur në prizmin e një bashkëveprimi të përjetimeve të realitetit të ndodhur dhe ndjeshmërisë së interpretimit të tyre, ai gjithësesi ka edhe karakter dokumentar. Ndërtimi artistiko-letrar e ruan frymën e interpretimit të ngjarjeve, pa ua tjetërsuar vërtetësinë realitetit të ndodhura, veprime këto që i përcaktojnë vlerat themelore të romanit.

Shtirja tematike në një periudhë të veçantë kohore, pas mbarimit të luftës në Kosovë dhe hyrjes së forcave paqëruajtëse ndërkombëtare, do të përshkohet me veprime të ndryshme nga soldateska serbe, që po i numëronte ditët dhe orët e fundit, që pas vetes kishte tërhequr shumë pengje për

t’i shfrytëzuar si mburojë nga bombardimet eventuale. Shumica e këtyre pengjeve ishin të burgosurit politik, ku për fatin e tyre të mëtutjeshëm nuk do të kujdesej askush, meqë ende ishte situatë e nderë, ndonëse kishte filluar të vendosej një paqe e brishtë që pehatej mes frikës dhe sigurisë.

Ngjarjet këtu janë trajtuar në nëntë pjesë, si mëvetësi e çdonjërit nga kapitujt, ku secili më vete sjell një rreth të shtrënguar ferri, për të ndërtuar kështu kompozicionin e veprës, si një tërësi e veprimeve dhe ngjarjeve që do të takojmë. Një lexim i këtillë imponohet nga shumë arsye, por qenësorja është fryma e krijuar nga këto pamje, që krijojnë një kronikë të plotë të një historie të përjetuar brenda këtyre rrathëve të ferrit karpatian, që ia kalon çdo veprimi tjetër çnjerëzor, të njohur ndonjëherë në botë.

Emil Zola në qëndrimin e tij për fabulën e romanit, ndër të tjera thotë: “Kuptimi i fabulës do të ishte ndonjë “dramë e vogël”, histori e cila i nevojitet shkrimtarit për të formuar skeletin e kaptinave të saj”. Bardhyl Mahmuti do ta formoi këtë skelet romanor përmes historisë dhe faktografisë së sforcuar me shembuj e argumente të takuara gjithkund në terrenin ku janë zhvilluar këto ngjarje të përmasave gjenocidale.


Në leximin e parë telegrafik hetohet që romani “Eskadronët e vdekjes” shquhet për trajtimin e ngjarjeve tematike të luftës në kontekstin e zhvillimit të drejtpërdrejtë dhe asaj të mbyllur, ku gërshetohen veprimet e një planimetrie të ndyrë në eliminimin e

kundërshtarëve dhe fshehjen e realiteteve të zhvilluara në terren. E veçanta e romanit është mënyra e rrëfimit të ngjarjeve në vetën e parë përmes dëshmitarit, i cili është pjesëtar i popullit serb, prej nga vijnë gjithë këto tragjedi. Rrëfyeti, në këtë rast, gazetari i shquar Mifi L., me shkrimet e tij të shumta gazetareske dhe raportimet për agjensitë e huaja të botës për realitetin e ngjarjeve dhe situatave të krijuara shpreh hapur mospajtueshmërinë me veprimet gjenocidale, deri në përmasën shfarosëse të një populli të pafajshëm; shpërfaq realitetet e ndodhura gjatë gjithë zhvillimeve të luftës, për t’a vënë në dijeni edhe opinionin ndërkombëtar, që skajshmërisht do të krijojë revoltën e pushtetit ndaj tij, duke e trajtuar në formë të ndryshme torturash, të burgosjeve dhe kërcënimeve të njëpasnjëshme për likuidim nga forcat elitare të pushtetit. Këtu gjejmë të gërshetuara kronikën dhe romanin historik, me elemente biografike, ku janë brumosur një mori ngjarjesh, që konsiderohen krejtësisht të vërteta dhe mirë të faktuara, ku pasqyrojnë tragjedinë njerëzore të shkaktuar nga politika represive e soldateskës serbe me gusto të shfrenuar shfarosjeje të një populli të tërë.

Mifi L. do të përballet vazhdimisht me gjykatës e prokurorë, nën akuzat për dhënie të informacioneve të rrejshme për zhvillimet e luftës në Kosovë, duke e dëmtuar imazhin e “patriotëve” që vepruan në ushtrinë dhe policinë serbe. Një përballje me veprimet e absurditetit shoqërorë, të cilin synon ta sjell sa më të saktë, për hir të së vërtetës që e kishte prekur në kohë, me qëllim që opinionin lexues ta çliroj nga frika permanente e një nënshtrimi moral e shpirtërorë, edhe pse po i kushtonte shumë. Këtë sakrificë shpirtërore, morale dhe etike do ta përballonte në çdo situatë që po i krijohej nga ndërkamcat e përgatitura nga pushteti.

Por, kundruall këtij realiteti të publikuar nga Mifi L., mbi të cilin e rëndojnë akuza të rënda, pikërisht këto akuza do t’i demnatojnë shumë institucione ndërkombëtare, duke i argumentuar me të njëjtin realitet të gjetur në terren, ku vrasjet e fëmijëve, pleqëve, njerëzve të sëmurë, dhunimet e femrave; pastaj torturimet dhe vrasjet e të rinjëve, të burrave të paarmatosur, zhdukjet pa gjurmë të kufomave, që të gjitha këto e sjellin në një pikë të njëjtë argumentimin, për të bërë kështu që edhe mbrojtja para gjyqit të jetë e qëndrueshme me faktografi të bollshme. Një qëndrim vertikal në veprimet e tij Mifin e bënë të pathyeshëm para soldateskës serbe, e cila tashmë nuk po zgjidhte forma e mjete, qoftë edhe për të “padëgjueshmë” e vet, në orvatjet me çdo kusht ta ruaj situatën, (për aq sa do të kenë mundësi), nga shpërthimi i revoltave populllore.

Në këtë kompleks narrativ të ngjarjeve, ku synohet ndriçimi i të vërtetës së një veprimtarie të barbarisë serbe, autori sjell shumë fakte e prova që e ngrisin në nivelin e një dokumentimi kronologjik me pamje e dëshmi të mjaftueshme, për ta kuptuar saktë qëllimin e përmbushjes së



planeve të hershme të akademikëve serb, të Garashaninëve, Qubrilloviqëve e Qosiqëve, që nuk janë të paktë në numër. Lufta e re, me mjete e plane të vjetra ndaj shqiptarëve do t'i nxjerrë në sipërfaqe të gjitha qëllimet shekullore të shtetit serb në raport me shqiptarët etnik. Këtu bota detyrohet të këndellet, duke e kuptuar tashmë qëllimin e kësaj barbarie të tërbuar për gjak e gllabërim të tokave të huaja.

Rene Maria Alberes derisa po merrej me çështje të romanit, në studimin e saj me titull “Synimi i romanit: Proteu”, ndër të tjera thotë: “Vlera e një romani qëndron padyshim në fuqinë dhe në bindshmërinë e atij vizioni që jep, atij zëri që flet; apo edhe të asaj arkitekture që imponohet vetiu, që zbulon veti të cilësuar hapësire imagjinare.” Ky mendim mbase arsyeton gjithë strukturën e realizimit të romanit “*Eskadronët e vdekjes*”, ku narracioni kap tematikën me saktësinë e argumentit dhe shpërfaq realitetin në përmasat madhore të bindshmërisë së faktorit ndërkombëtar. Ky në realitet ishte misioni parësor i këtij romani, që konsiderohet realizim i suksesshëm.

Në romanin “*Eskadronët e vdekjes*” lexuesi rrugëton nëpër një dramacitet tragjik, ku personazhet takohen mes jetës dhe vdekjes. Aty është ndërtuar një narracion i gjërë përmes detajeve me ngjarje e situata, ku eksplorohehen ndërlidhjet mes reales dhe surreales. Galeria e personazheve në roman është e stërmbushur me emra e figura reale dhe të sajua, ku Kryepersonazhi Mifi L. i takon dhe bashkëvepron me ta në momente të caktuara, në situata e relacione të shumta, gjithandej kah zhvillohen ngjarjet, që do ta përcjellin në vazhdimësi.

3. Në vend të përkufizimit

Përmbyllja e një drame kaq tragjike, ku me përkushtim janë kapur tema e ngjarje të shumta, përfshirë këtu edhe ngjarje nga burime të huaja; pastaj ndërtimi i karaktereve të personazheve kundruall ngjarjeve që trajtohen në roman, do të kurorëzohet me një libër që paralajmëron Mefi L, i cili në tërësi sjell kronikat e njëpasnjëshme të këtij ferri të krijuar nëpër të gjitha situatat, duke i krahasuar ngjashmëritë e Hitlerit me Millosheviqin, vetëvrasjen e Hajnrih Himlerit me atë të Vllajko Stojilkoviqit dhe përfundimin tragjik të jetës së Ernest Kaltenbrunerit dhe Radomir Markoviqit, pa mos i harruar edhe ngjashmëritë e kampit të Aushvicit me Maçkaticën, për të konstatuar se, “*dallimi ndërmjet Rajhut të Tretë dhe Jugosllavisë së Tretë qëndronte vetëm në përmasat numerike të gjenocidit*” (fq. 506).

Bardhyl Mahmuti në romanin “*Eskadronët e vdekjes*” arrinë të krijoj jo vetëm mjeshttrinë artistike, por edhe atë narrative, ku gërshetohet ndërtimi i romanit historik dhe kronikës, që bazohet kryesisht në rrëfime të vërteta të shoqëruara me dokumente historike, dosje origjinale dhe shkrime gazetareske të kohës, qoftë nga shtypi vendor, apo ai i huaj. Një ndërlidhje e këtille e subjektivitetit dhe mesazheve në frymën e ndjesive shpirtërore, ku dhimbja dhe dashuria për atdheun dhe lirinë, si bashkëveprime e mbajnë gjallë kujtesën e personazheve.

“*Eskadronët e vdekjes*” nuk lexohet veç si krijim letrar, as si përshkrim kronologjik i dëshmimeve historike. Ai sjell një gamë shumë më të gjërë trajtimi të ngjarjeve dhe shpalosje të dëshmimeve të një tmerri, që përveç vdekjes, qëllim tjetër e kishte edhe zbrazjen dhe spastrimin e plotë të një hapësire të jetuar që nga Iliria, për të krijuar kështu një terren për kusuritje me historinë.

Këtu madhështia e heroizmit e ruan madhështinë e trollit arbëror deri në arritjen e lirisë së kërkuar në shekuj.

(Vijon nga faqja 11)

paksa abstrakt, qoftë edhe i mishëruar në fate të veçanta. Po ashtu, megjithëse ai paraqet efektet e vërejtura klinikisht të një epidemie murtaje, kjo nis dhe përhapet vetvetiu, në një farë mënyre si një fatalitet, dhe megjithë zgjedhjen e Oranit si vend skene, nuk bëhet fjalë posaçërisht për Algjerinë. Në romanin e Buxhovit, përkundrazi, fatkeqësia jepet qartë, me shkaqet dhe fundin e saj, në kohën dhe vendin e saj. Në fund të fundit – por pa u kufizuar në një “subjekt” rreptësisht të përcaktuar ose të përvijuar – Buxhovi aktualizon dhe zhvillon një nga kuptimet e mundshme të “Murtaja” (“La Peste”) e Kamysë: vuajtjen që u shkaktohet njerëzve nga njerëz të tjerë, dhunë që përdorin disa për të nështruar më mirë të tjerët, madje për t’i zhdukur fizikisht. Pikërisht këtu është, në fakt, një nga murtajat që nënkupton “Murtja” e Kamysë, në mos shprehimisht, së paku me aluzionet e tekstit ose me përgjithësimet ku ai të shpie.

Sipas datës së shkrimti dhe daljes në shitje – pra realiteteve që e sollën dhe të cialve ai u vën qëllimisht dhe dlmosdoshmërisht jehonë – romani i Kamysë evokonte së pari, mesiguri, totalitarizmin, këtë përbindësh të kohëve moderne. Autori njëherazi ka pasur edhe kurajon, edhe qartësinë, mjaft të rralla në periudhën fill pas luftës, të denoncijë si murtajën e kueqe, edhe atë zezën. Por ai e bën këtë me terma të qarta dhe jo më me zhvendosje, me komente me të cilat ai e shoqëron atë. Rrjedhimisht, përtej këtyre rezonanace ose shkrimeve “aktuale” të tekstit, të bëra më të ndjeshme në atë kohë nga kujtimi i menjëhershëm i flijimit (holocauste), kujdesi i Kamysë për t’i siguruar veprës së tij një përmasë polisemike (ai donte, siç shprehet vetë, që ajo “të lexohet në shumë nivele”), kjo i jep atij një karakter “atopik” (ngjyra algjeriane, e përsërisim, nuk llogaritet aspka), dhe “akronik”, duke përjashtuar disa tregues që dalin nga e kaluara e Tarrout dhe e Rambertit. Do të dukej sikur ai ka dashur kështu ta çojë më me siguri lexuesin drejt pyetjes thelbësore: cilat mund të jenë, në një vështrim absolut, sjelljet e njeriut përballë vdekjes së verbër, e, më përgjithësisht, përballë të gjitha formave të vuatjeve fizike dhe morale, në të cilat mund të shfaqet e keqja?

Një tjetër veçori e murtajës së Buxhovit, përballë asaj të Kamysë, është se ajo nuk ka pamjen e një fatkeqësie të shfaqur befasisht. Sigurisht romancieri frëng e shtjellon me etapa progresive, por mbetet, siç e theksmuam më lart, që ajo të shfaqet “exnihilio” se është e tërë njëherazi, pa iu dashur të lindë. Te Buxhovi, përkundrazi, ajo vjen nëpërmjet një vënie në skenë sa sekrete aq edhe të hollë: ajo përbën për dije, por figuron edhe për sot (në kontekstin e sotëm mbi disa realitete social-politike dhe për gjuhën e dyfishtë), një përpjekje për gjenocid, së paku të pjesshëm, aq të shyrë sa të mund të shkatërrojë të mbijetuesit çdo përpjekje, sado të vogël, për t’u mbrojtur. Kështu, vdekja fizike e disave do të sigurojë vdekjen politike dhe morale të të tjerëve.

Fshehtas, i maskuar në përkujdesje, ky plan djallëzor nënkupton, në fakt, në dredhat e veta, një art të përkryer të helmimit, të frikësimit, derisa shkakton psikoza të vërteta, duke krijuar kështu kushtet e favorshme për të parandaluar ose asnjëherë qëndresën e popullsisë, për t’u paraprirë kundërveprimeve të tij.

Këtu hasim elementet që afrojnë romanin e Buxhovit me ata të Kadaresë në paraqitjen alegorike të Perandorisë Osmane.

Çuditërisht, synimet e kësaj “supërfuqie” janë shprehur qartë te Buxhovi, të “Strategjia osmane” e njëfarë Kavijusit. (Prapa kësaj dyshohet për mbështetje në një realitet historik). Nga ky traktat janë frymëzuar gjërisht mendimet e një poeti tjetër epik të madhëstisë osmane, i quajtur Osman Inxhi Karaogllu, sipas rrëfimit të Gjon Nikollës. E ashtuquajtura strategji nuk është pohuar, sigurisht, në librin e Karaogllusë si një synim makiavelik. Ajo duhet të përfundojë me kurorëzimin e njeriut të ri osman, të farkëtuat sipas një modeli të vetëm ideal, i vetmi mjet për të siguruar shpëtimin e Perandorisë. Gjithashtu ka prirje për të lexuar aty një aluzion të dyfishtë ndaj realiteteve bashkëkohore, së pari, ndaj ideologjisë

komuniste, që ka rishpikur mitin e njeriut të ri, por edhe ndaj shkrimeve të Çubrilloviqit, teoricien i “rregullimit të çështjeve shqiptare”, në të mirën më të madhe për Serbinë. Futja në lojë e dy veprave në fjalë ndoshta gjen këtu shpjegimin e saj: mos jemi të ftuar ta kujtojmë Biblën e paemër dhe të paemërtuar të shovinizmit dhe të ekspansionizmit serb prapa asrjetimeve të tij të veshura bukur, ashtu si në roman, njëra nga këto vepra (ajo “e paraqitshmja” me pamje “të ndershme”) e nënkupton tjetrën (atë të urryerën) nga u frymëzua në të vërtetë?


Merret me mend në një referencë tjetër ndaj sistemit komunist me mbledhjet ose më mirë me dërdëllisjet e pafundme (mania “marksiste-leniniste”), ku përfaqësuesit e pushtetit qendror, kur nuk i anullojnë a shtynjë, për efekt takt ose thjesht për përbuzje, bëjnë sikur janë në një mendje me mjediset e shquara, për të diktuar, në fund të fundit, vetëm vullnetet e tyre. E si të mos përfytyrosh në këtë faqe autonominë relative të pranuar dikur për krahinën e Kosovës, autonomi që sot është likuiduar krejt.

Përballë kësaj shtypjeje shtetërore, qëndresa shqiptare niset nga një ndërgjegje e vetme, një kapërcim i njeriut, i jetës dhe i vdekjes, e jo nga konsideratat politike. Prej këtij rrjedh një përmasë filozofiko-morale, që i jep romanit gjithë rëndësinë që ka.

Pa qenë e mundur të zbulohen në këtë fushë përkime të qarta midis romanit të Buxhovit dhe këtij ose atij të Kadaresë, gjendet megjithatë atmosfera e përgjithshme, e cila, tek i dyti, përshkron veprat e frymëzuara drejtpërsëdrejti nga tema e “besës”.

Njeriu shqiptar paraqitet si një “homo religiosus”, në kuptim etimologjik; ai përcaktohet vetëm nëpërmjet lidhjeve të tij: me vëllëzërit e tij, me tokën, gjuhën, të kaluarën. Romani i Buxhovit “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit” na jep të kuptojmë se, meqë as Krishti e as Muhameti nuk u kërkonin të hiqnin dorë nga kjo “besë”, që ishte e rrënjosur thellë në qenien e tyre, shiptarët mund t’i përkushtoheshin padallimisht njërit ose tjetrit, sipas rrethanave. Romani “Shënimet...” na përkujton gjithashtu se sa shqiptarët, nga ky fakt, kanë mësuar e zbatuar tolerancën, respektin e çdo besimi, e, prej kësaj, të çdo kombësie... Kulti i përbashkët i “besës” nënkupton para së gjithash një sërë angazhimesh, ligjesh e zakonesh, që rrjedhin nga besa e fjalës së dhënë. Kështu, shpjegohen kujtimet e përseritura të historisë së tij të gjatë; ato janë po aq shenja e përjetësisë së tij, sa edhe të nevojës që ai ka, në orët e vështira, të ringjall heronjtë e tij mbrojtës, t’i mëshirojë ose t’i ndiejë që rijetojnë përmes magjisë së fjalës. Më shumë se prej kujtdo tjetër: kujtesa i vjen nga poetët e tij (Colit i shtohet personazhi shumë simbolik i rapsodit popullor Selami Takraku), nga këngët e legjendat që përjetësojnë kujtimin e sprovave. Kështu përballë një të keqeje të harruar, që të zë papritur, kundërveprimi i parë është pyetja e së kaluarës, këshillimi me të vjetrit, me ata që kanë mundur të shikojnë ose të dëgjojnë të tregohet sesi ka mundur ta kufizojnë atë, një shekull më parë, gjatë epidemisë së 1646-ës.

Nga kjo rrjedhin edhe këto elemente



të tjera: përseritja me këmbëngulje e disa toponimeve, zanati i arkeologjisë që ushtron Gjon Nikolla kahas prirjes së tij fetare dhe odiseja e Kelmendëve, një familjeje shqiptare, që përshkon shkurtimisht romanin. Të mërguar në Bosnje që prej disa brezash, para se të rikthehen e të vendosen në Gjakovë, si dyshekëpunues, këta endacakë do ta gjejnë identitetin dhe përkatësinë e tyre të humbur vetëm duke u bërë një me baltën e varrit. Copa e poçarisë së vletër ilire, që Gjoni ka nxjerrë nga thellsia e dheut, afrimon edhe vlerën shenjtërore të tokës, përveçse vërteton lashtësinë e qytetërimit nga kanë rrjedhur shqiptarët. Së fundit, duhet thënë se ka lidhje të plotë midis koncepteve tokë-identitet-kujetesë. Vetëdija e trashëgimisë është futur shumë imtimisht në shpirtin shqiptar, saqë krkonikani njëherazi me predikimin e rizbulimit dhe të pasurimit të kësaj trashëgimie gjatë brezave, arrin të vërejë se jo gjithmonë, në fakt, lipset kërkim ose studim i veçantë, pasi ajo ka kaluar në gjakun e shqiptarëve dhe shfaqet në jetën e tyre të përditshme. Historia duhet njohur, në fund të fundit, kur ta kanë cënuar identitetin tënd për shekuj me radhë vetëm për ta përvetësuar a ripërvetësuar sa më mirë atë e të ruash kështu vazhdimësinë e qenies sate.

Kulti i këtyre vlerave te shqiptari çon në një formë stoicizmin, që e bën atë të shohë vdekjen në sy, meqë ai ka kryer atë çka duhet, atë që kërkon prej tij “besa”. Madje, herë-herë, ai duket si i nënshtrohet një magjepsjeje të vdekjes; së pari, sepse kjo vdekje e lavdishme, e denjë, e virtytshme, mund të lindë një këngë pavdekësi, dhe, e dyta, për atë se kjo vdekje, tek e fundit, paraqet jetësinë e një populli, si dhe për arsyet se ajo është sakrificë, mposhtje e gjuhëzimit. Kronikani arrin deri aty sa të shpjegojë, në mos të përligjë për këtë, zakonet vetëvrasëse të disa fiseve ilire, sipas dëshmimeve të historianëve latinë. Pasioni dhe krenaria e tij kombëtare do të shkonin pothuaj, në disa prej fjalëve të tij, në larësimin elitat, sikurse të mos vërente edhe ai vetë se ka edhe shqiptarë të aftë për vepra të ulta dhe për tradhti. Njëri prej tyre, Çosaleshi, bie kaq poshtë në bashkëpunim me armikun, sa autori i mohon shugurimin e tokës, duke lënë kështu të qarkullojnë dyshimet për qenien e tij shqiptar: askush s’është në gjendje të thotë nga vjen, nga e ka prejardhjen, thua se s’ka prejardhje fare.

Të gjitha këto zgjatje simbolike dhe metaforike lidhen me të papriturat e një beteje me përmasa me të vërtetë epike: nga njëra anë, një popull i tërë që mobilizohet, qëndron dhe që forcën për të mbijetuar e gjen te burimet e tij më të thella, dhe, nga ana tjetër, makina e ditur politike e një fuqie peradorake dhe, po të mos flasim me gjuhën e La Fontenit, një e keqe që kudo përhap tmerr... muratjë, përderisa duhet thirrume me emrin që ka”. Kështu libri shkon shkallë-shkallë deri në zgjidhjen e tij te fitorja, të paktën edhe e përkohshme, e gjenisë njerëzore mbi të keqen me anë të skenave dh të pamjeve rrëqethëse, që shfaqen si një kërcënim therës. Aty gjejmë frymën e frikërave të mëdha mesjetare, ankthet mijëvjeçare të njeriut përballë fatkeqësive apokaliptike. Edhe në vetë etimologjinë e saj, fjala “mortje”, “murtajë”, në shqip, është sinonim i vdekjes. Ndaj, edhe nëse shqiptari mund të shkojë si individ deri aty sa të kërkojë vdekjen, siç e kemi vërejtur, si kolektiv ai priret drejt jetës, drejt një vullneti të pamposhtur për të qenë, për të ruajtur identitetin e vet.

Shtrirjes dhe ngjeshjes së një drame që priret drej epopesë, u shtohen, për lexuesin perëndimor, shijet e forta të një ekzotizmi ballkanik. Libri i Buxhovit, në këtë pikë, ruan denjësisht vendin e tij përballë kronikave të famshme të Ivo Andriçit (nga të cilat do të harrojmë këtu, vetëm për interesa letrare, idetë e padenja për një humanist, që ai shpalli gjatë kohës që punonte në Ministrinë Serbe të Punëve të Brëndshme. Me anën e atyre ideve ai propozonte “rrëgët” për rregullimin përfundimtar të çështjes shqipëtare). Shtjellimet që paraprijnë, sidoqoftë, e vertetojnë mjaftueshëm: ekzotizmi oriental nuk e bën romanin e Buxhovit një vepër thjeshtë argëtuese, një arratisje thjesht romaneske. Ngarkesa e tij emocionale dhe rëndësia e çështjeve që ai shtron, e mendimeve që ai ushqen, e prekin edhe më me siguri lexuesin, vika që ai e zhyt atë në një pjesë të Europës ngatimë, edhe sot, e tronditjes më të dhëmshme, fati i të cilës, duam ose jo, prek kontinentin mbarë.

Floresha Dado përfaqësohet tashmë si një personalitet i njohur në fushë të studimeve letrare. Sigurisht, që studimet e saj, kryesisht ato të rrafshit teorik, janë tërheqja dhe kontributi i saj më i spikatur.

Karakteristikë e dallueshme e këtyre studimeve, është se ato, marrin shkas dhe nxiten prej realitetit të letërsisë shqipe e më gjerë. Prandaj, mund të thuhet se në to, shpalosen jo thjesht dhe vetëm koncepte, vizione e sinteza teorike, por këtu përcillet një pjesë e konsiderueshme nga gjeografia/shtrirja dhe historia e kësaj letërsie, me tërë spektrin e larmishëm stilistik dhe estetik - që ajo ka mbartur në rrjedhë të shekujve.

Po qe se do të bënim një karakterizim të kontributeve të sjella prej kësaj studiueseje, ato do të kishin të bënin: a. me *larminë* dhe thellësinë e argumenteve të sjella, b. me *prirjen* për t'i përcjellë ato argumente me një stil të dukshëm polemist c. me *mbështetjen* e fortë e të sigurt teorike të tyre d. me *ligjërimin* sa shkencor - aq edhe me gjuhë të qartë, larg komplikacioneve abuziviste e po ashtu e. me *një qasje* të sigurtë ndaj sfidave teorike të trajtuara dhe duke ruajtur përherë një diskurs shkencor me vizion të *hapur*, pra, shtjellim tezhash me sens propozues dhe jo me *prirje imponuese*.

Këtë prirje e shfaq edhe vepra e saj më e fundit, ajo e botuar kohëve të fundit, me titullin: *POSTMODERNIZMI Poetikë e 'antirregullit'*, në radhën e nëntë librave të tjerë të mëparshëm, ku mund të përmendim monografinë për Çajupin ("Jeta dhe vepra"), "Proza nëpër teknikat poetike", "Intuitë dhe vetëdije kritike", "Sfida teorike të historiografisë letrare" etj. Qysh në titull të librit, e kuptojmë tërheqjen e studiueses për t'u përballur me një dukuri sa komplekse, aq edhe të pastabilizuar ende në qasjen teorike ndaj saj, në nivel të letërsisë botërore e kuptohet, edhe asaj shqipe - që nuk mbetet kurrsesi pas këtyre rrjedhave letrare moderne.

Besojmë se libri zgjon interes, jo vetëm për lëndën e pasur letrare - ku hulumtohet me skrupulozitet (në vepra të Anton Pashkut, Rexhep Qosjes, Mehmet Krajës, Bashkim Shehut, Visar Zhitit, Agron Tufës, Fatos Kongolit, Virion Graçit dhe autorëve të tjerë) - por edhe për qasjen "dilematike" rreth problemit të përcaktimit të kufijve mes modernizmit dhe postmodernizmit. Si një kundërvënie estetike e të dytit (pra e postmodernizmit) - ndaj të parit (modernizmit), që në fakt, ende mes studiuesve të shumtë nuk parashihi që të ketë vlerësime fort të përcaktuara, apo fort të dallueshme mes tyre. E kjo, lidhet me vet kufijtë e lëvizshëm mes këtyre lëvizjeve mjaft të bujshme letrare, kryesisht të shekujve XX -XXI.

Profil i studiueses Floresha Dado

NJË JETË NË “PERBALLJE” ME SFIDAT LETRARE

Nga Ymer Çiraku



Autorja, duket se nuk mbetet thjesht dhe vetëm në konstatime referenciale prej sudiuesve të tjerë të njohur rreth këtij argumenti, pra, të njohjes së një paqartësie rreth dallimit prerazi mes tyre, por e hulumton këtë dukuri (le ta themi figurativisht e prezantuar si një lloj *hermafroditë*-je apo *dytësie letrare*), duke u ndalur nëpër një varg veprash konkrete, kryesisht ato në prozën romanore shqipe.

Me të drejtë autorja e këtij studimi, nënvizon konceptin e njohur se letërsia si akt krijimi, është/mbetet e pavarur nga përpunimi i mendimit teorik. Ajo nxitet veçse nga ndjeshmëria e autorit shkrimtar ndaj realitetit njerëzor dhe pastaj, është vet letërsia, ajo që ndikon në përpunimin e mendimit teoriko-letrar prej të tjerëve. Por ndërkaq, në kohët e sotme, nën ndikimin e rrjeteve të një informacioni tejet kompleks e vërshues: teknologjik, filozofik, kulturor e shpirtëror, sigurisht, që edhe letërsia, nuk mund që të mbetet në pozita të pastra autonomiste, por përcjell fluksin e ndikimit dhe orientimit estetik të saj, prej rrezatimit të këtyre lëvizjeve jashtëletrare mjaft intensive.

Janë me interes në këtë studim vështrimi i poetikës posmoderne në disa specifika të dallueshme, sidomos ato që kanë të bëjnë me të ashtuquajturën "prishje" të kufijve gjinorë, ku vrehen natyrshëm kombinime e kolazhe zhanresh, që në fakt, sillen prej krijuesve (me sa duket) si një manierë - për të sjellë e fuqizuar në vepër, përparësi specifike prej seicilit zhanër. Apo evidentimi i kësaj poetike në shfaqjen e "thyerjes" së narracionit, si një ligjërim energjik ky dhe shumë shtresor, që krijon efektin artistik të leximit të thellë, ardhur prej strukturës së njohur të palimpsestit.

Në vargun e studimeve dhe veprave monografike të karakterit teorik të autores, është edhe ai me titull "*Sfida teorike të historiografisë letrare*". Sigurisht, që mbetet një guxim shkencor marrja



përsipër e shkoqitjes në rrafshin teorik të një morie sfidash të natyrave të ndryshme, shkencore e jashtë shkencore, nga ato që kanë të bëjnë me gjetjen e rrugëve më të sigurta për hartimin e një historie të letërsisë. Studiuesja e ka të qartë këtë ballafaqim të vështirë e delikat dhe pikërisht, mbase kjo, ka qënë edhe një arsye më shumë në "vendimin" e saj për t'u marrë me këtë argument. Një botim si ky, i llojit kritik, me parashtrim pikëpamjesh e debatesh letrare, gjykojmë se ka vlerë të dyfishtë: risjell një fond të gjerë modelesh konceptuale të historive të ndryshme të letërsisë, por ndërkaq, është edhe një grishje dhe ftesë për hartimin, ose më mirë, për shkrimin e historisë së letërsisë shqipe në nivel akademik, më se të pritshme e më se të realizueshme në kohët e sotme.

Theksuam shkrimin dhe jo rishkrimin e historisë së letërsisë shqipe, se në gjykimin tonë, çdo botim i këtij lloji - që sheh dritën e botimit, është në vetvete një histori e pavarur apo histori unike letërsie, realizuar sipas koncepteve të zgjedhura teorike prej autorit, apo një grupi autorësh. Një vepër kjo, që do të quhej pastaj e kryer, e çertifikuar, për mirë apo me rezerva ndaj saj, sigurisht nga gjykimi/vlerësimi i vet lexuesit të saj. Një botim vijues/pasues i këtij profili, edhe pse mund që të ketë të njëjtin objekt studimi, pra letërsinë shqipe (me po ata shkrimtarë përkatës), është dhe mbetet sigurisht një vepër e re. Në këtë kuptim, mund të thuhet se në traditën tonë historiografike letrare, kemi aktualisht një mori tekstesh e manualesh mbi historinë e letërsisë shqipe, të botuara dhe të qarkulluara në arealin kulturor shqiptar dhe jashtë tij, në disporën arbëreshe dhe në qendra të ndryshme albanologjike, me autorë shqiptarë dhe të huaj, të shkruara nga individë apo nga ekupe studiuesish, me destinacione parauniversitare, universitare, apo njohëse masive, të natyrës enciklopedike - drejtuar

lexuesve të huaj. Duke qënë të hulumtuara dhe të shtjelluara këto procese letrare sipas rastit: mbi bazën e periudhave historike, mbi formacionet letrare qarkulluese, mbi individualitetet e shkrimtarëve, sipas gjinive letrare etj.

E gjithë kjo tipologji botimesh tashmë jo të pakta, ka qënë objekt i një studimi të vëllimshëm nga autorja dhe për më tepër, krahas synimit paraqitës të këtyre kontributeve nëpër vite (përcjellë si informacion filologjik), është parë e udhës për të hetuar tendencat dhe kontributin e kësaj trashëgimije. E cila, me një rrokje/vështrim të parë, mund të të ngjajë modeste si vëllim dhe si tipologji prirjesh stilistike, por që kur i hyn hulumtimit të saj, e kupton se je duke u përballur me një pasuri komplekse dhe njëherësh me një sfidë, për nga qasja e një interpretimi sa më të sigurtë.

Do ta quanim vlerë të kësaj vepre studimore, ngritjen e debateve dhe tezave shkencore mbi bazën e asaj se çka sugjeron realiteti letrar e shkencor dhe jo e kundërta, siç ndodh në disa raste, kur studiuesi, ka ca ide e teza të vetat paraprake dhe sipas e në funksion të tyre, kërkon pastaj në mënyrë të sforcuar modele ilustruese për ato teza, nëpër rrjedhat e proceseve letrare. Janë të shumta burimet e cituara rreth argumenteve të ndryshme, aq sa vepra, është edhe një bibliografi e pasur burimesh letrare, si dhe merr formatin e një "antologjie" pikëpamjesh të llojllojshme kritike. Kështu, vetëm në çështjen e periodizimit të letërsisë shqipe po të ndaleshim, do të ndeshim të ballafaquara një mori pikëpamjesh, që e formulojnë këtë periodizim: mbi bazë qarqesh letrare, mbi bazë individualitetesh (nisur nga vështrimi i saj si *letërsi atipike*), mbi bazën e shtatë shkollave letrare (që nga tekstet filobliblike e deri tek ato moderne), mbi bazë rrymash letrare, mbi bazë periudhash social-historike, mbi bazë diskursesh, që nga ai heroik e deri te ai historik etj.



Vihet re se autorja është e vëmendshme dhe jo preferenciale *a priori* kundrejt autorëve të caktuar, kontribues në rrethin e dijeve letrare, duke dëshmuar kësisoj, etikë dhe mbështetje e vlerësim mirënjohës prej kolegu. Vlera këto, që jo rrallë në këto kohë, i shohim (për fat të keq) të jenë tronditur jo pak, vrejtur si modele qëndrimesh këto të ardhura nga matanë lagjeve shkencore, ku debati i kujdesur/i përkorë dhe intelektual (ashtu si e ka kuptimin dhe qëllimin të jetë), është kthyer shpesh në grindje të pakontrolluara. Në vepër parashtrohen kontribute, teza, debate e polemika letrare të qarkulluara nga studiues të ndryshëm dhe në kohë të ndryshme, duke i vlerësuar ato, për aq sa kanë mundur e arritur që të ndriçojnë rrugët nëpër të cilat është endur filli i letërsisë shqipe. Por autorja, nuk pajtohet me tendencat e debatit azgjësonjës, një debat ky, që nuk do të prodhonte veçse amulli dëshpëruese, duke dëshmuar kësisoj, se ajo është ndjekëse e të ashtuquajturës kritikë me *perspective*. Domethënë, që pas çdo diskuri, sado kritik, të ndihet i projektuar modeli i afirmimit të një vlere të caktuar.

Rolin e historianit të letërsisë, studiuesja e vlerëson si mjaft delikat, sidomos në procesin e shqyrtimit dhe klasifikimit të letërsisë së traditës. Për të realizuar një studim serioz e objektiv, ai duhet që ta ketë mirë parasysh se duhet që të njohë e të vlerësojë drejt një zinxhir *pritjesh* të veprave letrare, në kohë të ndryshme. Çdo vepër, nuk ka vlera në vetvete. Ato shfaqen veçse në raport me lexuesin, prandaj edhe historiani i letërsisë, kërkohet që të jetë zëri i kualifikuar dhe njëherazi, të jetë sintezë e shumë receptimeve. Në këtë kuptim, studimi i tij mbi letërsinë e traditës, ka një qasje reagimi dyfish: ndaj *veprës letrare* (si pasojë e leximit ndryshe të saj, nën ndikimin e kodeve të reja të buruara e zbuluara prej saj), ndaj *historive paraprijëse* të letërsisë (nën ndikimin e horizontit të pritjes kundrejt asaj kohe të dikurshme). Kjo pozitë *sui generis* është edhe misteri dhe bukuria e kësaj dijeje, që mban përherë gjallë shpirtin e kërkimit dhe të zbulimit të pandërprerë të kodeve dhe strukturave të reja artistike, mbi tekste që sigurisht, nga ana e tyre nuk ndryshojnë asnjëherë, qysh prej vullnetit autorial.

Një vepër si “*Sfida teorike të historiografisë letrare*”, ka jo vetëm peshën e një argumenti të rëndësishëm, që merr përsipër të shqyrtojë procesin letrar, por edhe të ketë rolin e vet sado ndihmues dhe kontribues për hartimn e një historie të pritshme akademike të letërsisë shqipe. Një vepër, që vazhdon të ndihet si shumë e munguar. Pra, edhe këtu, shihet koncepti i kritikës me *perspektivë* i kësaj studiueseje, e cila, me sa duket, udhëhiqet nga ai “urdhër” edhe për dietarin e letërsisë: *Unë kam një endërr...*

Duhet kujtuar se studimet letrare të rrafshit teorik, përveç vështirësive që paraqesin për vet natyrën e tyre gjerësisht hulumtuese nëpër një morie të madhe veprash, ndërkohë, ato kanë edhe një numër mjaft të kufizuar lexuesish. Pra, nuk e sjellin fort lehtë atë kënaqësinë, që do të vinte nga ndjekja e një lexuesi sa më të shumtë, që përbën kredon e çdo krijuesi. Por gjithsesi, studime të këtij formati, kanë rol të rëndësishëm, pasi përmes tyre, përcillen disa “çelësa” mjaft të rëndësishëm e të dobishëm, për ta rrokur në mënyrë sa më të sintetëzuar e të vështuar dhe gjykuar/vlerësuar si *sistem* një proces letrar. Dhe F. Dado, ka një kontribut të vyer prej shumë vitesh në fushën e studimeve teorike të letërsisë.



BOTË E ÇMENDUR

Tregim nga Gjergji Mihallari

“Mendja një grusht me miza është, po e hape pëllëmbën e dorës, vështirë se i mbledh ato!”

E kishte dëgjuar dhe stërdëgjuar këtë shprehje me një pafundësi numërimi të shqiptimit, në biseda të ndryshme nga të moshuarit dhe brezi i atyre që quheshin burra të pjekur. Kjo shprehje e kishte shoqëruar qysh nga fëmijëria dhe deri në këtë moshën e tanishme, kur edhe ai bënte pjesë tek burrat e pjekur. Në fëmijëri, e kishte brejtur mendimi për të gjetur enigmën e shprehjes, me gjithfarë pyetjesh dhe aludimesh, se si mund të ishte mendje një grusht me miza. Kishte ndalur edhe frymëmarrjen, duke përqëndruar dëgjimin me veshët pipëz përpjetë. Të paktën të dëgjonte zhurmimin e mizave brenda kokës, se nëse mendja ishte një grusht me miza, me siguri ato do të zhurmomin dhe zukatnin si mizat që sillen rrotull në ajrin e nxehtë të një dite vere. Sado që e stërmundoi vehten, nuk zbuloi gjë në kokën e tij, të dëgjonte atë ronitje të kolonisë së mizave që ishin brenda kokës së tij, të mizave që formomin trurin e tij.

Me kalimin e viteve kuptoi të vërtetën e shprehjes. Mençuria e popullit, tir edhe shprehjet më të çuditshme dhe më domethënëse.

Nuk e di pse kjo shprehje po i trokiste shpesh në mendimet e tij, në këto kohë që jetonte në këtë vend të huaj. Mbase nga ato që shihet me sytë e tij. Veprime që në atdheun e tij, do të quheshin anormale, dhe ata që i kryenin, do të etiketoheshin menjëherë si të çmendur, të shkarë nga trutë, të lojtur nga trutë. Shkurt, do të vështroheshin dhe trajtoheshin në një mënyrë ndryshe nga turma, mund të shkonte deri në atë masë sa tu qëndronin larg këtyre tipave. Më e keqja mund të vështroheshin edhe si rrezik për turmën...

Ditët e para të mbritjes, kishte hipur në autobus. Përballë tij një djalosh, i gjatë si skërfyell dhe që nxinte si qymyr, kishte filluar të lëvizte trupin sikur po vallëzonte. Filloi ta shoqërojë lëvizjen edhe me fjalë që po i këndonte. Vështrimin e largoi tek djaloshi përballë, duke e sjellë rrotull tek udhëtarët e tjerë dhe tek pamjet që i parakalonin në ambientin e jashtë, përtej xhamit. Ata, udhëtarët e tjerë, të përhumur në vetminë e tyre, as që u bënte përshtypje gjestet dhe tingujt e lëshuar nga djaloshi. I ngeli në buzë një buzëqeshje që u shua pa lindur mirë. Edhe vështrimin e hidhte tjetër kund. Nuk dëshironte që djaloshi t’i dallonte buzëqeshjen në fytyrë. Dreqi e mori, edhe këtu duhet të ndeshem me të shkarë nga trutë, ishte mendimi që i përshkoi trurin. Ky mendim i kujtoi ditën e largët në vendlindje, kur duke gjerbur lëngun e kafes tek lokali përballë punës, në harkun e gjysëm ore kohë, i kishin kaluar përpara fytyrës gati dymbëdhjetë tipa me probleme mendore. Atë buzëqeshje të shtrirë në fytyrë, tjetri, mund ta merte për të keq. E në këtë qytet të madh, me

gjithfarë fytyrash dhe racash, nuk dihej me kë gjendeshe përballë. Ndeshje të bardhin e të ziun, të verdhin dhe mulatin. Një lukuni e tërë njerëzish ku nuk dalloje vendalium nga ardhacak, turistin nga endacak...

Në ditët dhe muajt në vazhdim ndeshi jo një herë, por shumë herë të “shkarin nga trutë”. Pritë të mbledhë mizat i shkretë, do të thonin në vendin e tij. Kush këndonte për hesap dhe qejf të vet, e kush lëvizte trupin e vallzonte në atë copë vendi ku kishte mbështetur këmbët në dyshtemenë e autobuzit, trenit. Ndaj nuk po i bënte përshtypje kjo sjellje apo shpërthim i brëndshëm i hovit të të panjohurve të shumtë. Ndonjëherë ishte gati të shpërthente edhe vetë, kur koka bluante lloj-lloj mendimesh dhe lodhja i varej deri në majë të gishtërinjve. Por, shpejt e shpejt, i vinte fre vehtes. Ende ndjenja e paragjyqimit për veprimet e të tjerëve dhe çfarë do të mendonin të tjerët për të, kur të reagonte në atë mënyrë, ishte e fortë dhe stopuese.

Mëngjesi ishte paki freskët, por me qiell të pastër. Larg, shumë larg, në një cep të tij, disa njolla të bardha resh. Nuk kishin ngrystësinë e grisë të plumbtë të reve që bartin shiun. Më tepër ishin si një dekoracion lulesh të bardha, në blunë e thellë të konkavës së pafundme. Iu gëzua këtij fakti, për arsyen e vetme se duhej të punonin jashtë, duke suvatuat fasadën e një shtëpie. Ende e ndiente deri poshtë rrobave ujin e shiut të një dite më përpara. Duhej të mbarohej sa më shpejt puna. Ishte një torturë e vërtetë, kur shiu derdhte furinë e vet mbi mbulesën plastike me të cilën kishin mbuluar faqen e murrin ku punohej. Nuk mjaftonte shiu, por edhe era e fortë që ta përplaste mbulesën mbi fytyrë dhe pështillej trupit. Kishte çaste kur e mendonte veten se gati po e paketonin si copë mishi, në një qese të madhe plastike. Por, edhe pse mëngjesi nuk diktonte shenjat e një dite me shi, shiu erdhi me rrëmbim dhe një forcë më të madhe se dita e shkuar. Solli me vete edhe erën e fortë. Ajo fishkëllente dhe frynte sikur perëndia e erërave të kishte hapur grykën e thesit. Mbulesa plastike filloi të rrëshqasë prej çatisë, ku ishte e fiksuar duke u mbështjellë pas disa dërrasave të mëdhë dhe të rënda. Duhej të forconte bazamentin e dërrasave, tu vinte diçka të rëndë mbi to. Nëse rrëshqiste mbulesa, do të shkante dëm gjithë puna dhe munda.

Mbushi disa kova plastike me gurë dhe ujë, për t’i vendosur mbi dërrasat e sheshta ku ishte mbështjellë plastmasi. Me vështirësi, duke u shtërnguar pas shkallës nga era që frynte nga të mundej dhe gjithë egërsi, i ngjiti në çati. Si tërhoqi me mundim drejt vendit të mëparshëm bazamentin e drunj të mbulesës që tërhoqej vazhdimisht nga fuqia e erës, vendosi kovat e rënda mbi to. Ishin pesëmbëdhjetë copë prej tyre, që i ngjiti lart, gati puthitur me trupin nga pesha e rëndë. Kur u bind që efekti i erës nuk mund të lëvizte mbulesën në gjithë gjatësinë e

çatisë, zbriti në katin e mëposhtëm ku filloi të vazhdojë punën. Shiu kishte bërë punën e vet. Blua e trashë ishte lagur, por, edhe flokëve vazhdonin të lëpiheshin pika uji që mësynin qafës e vazhdonin rrugën nën rroba në lëkurën e nxehtë.

Era dhe shiu, herë pushonin dhe herë fillonin. Dukej sikur në intervalet e qetësisë, ato, përgatiteshin për të mbledhur forcat dhe të fillonin mësymjen me një furi më të madhe. Ngjitje-zbritjet nga çati ishin sa kur mbaronte shiu, për të parë nëse mbulesa nuk kishte lëvizur nga vendi, por edhe gjatë furisë së tij dhe erës. Kur dëgjohej zhurma gërvishtëse e lëvizjes së dërrasave, ai ngjitej shpejt e shpejt lart. Duhej të luftonte me erën, për të mos i rrëmbyer mbulesën, por edhe me shiun që po i futej me ftohtësinë deri në palcë.

Kur gjithçka mbaroi, ndërroi këpucët e rënda të punës, duke veshur një palë atlete. Kërkoi të ndëronte edhe bluzën, por ajo ishte e lagur. E gjendur në çantën e shpinës, kishte pirë ujë me bollëk, pasi ai e kishte haruar të varur në gardhin rrethues. Ofshau fort gjithë zemërim. Nuk kishte ç’të bënte. Do t’i duhej të kthehej drejt shtëpisë i lagur qull. Në trup po e shponte e ftohta, duke ia mornicuar lëkurën. Edhe në buzë ndjeu dridhje. Cigarja e ngezur vetëm sa ngrohte idenë e tij fikse që tymi i saj, e ngrohte nga brenda. U ul afër fundit në autobus. Ngrohtësia e motorit, filloi ta sjellë pak në vehte. Ende hungërinte si një bishë. Nuk mund të harronte edhe grindjen me punëdhënësin. Gjatë ngjitje-zbritjeve të kovave të mbushura me ujë e gur, njëra prej tyre ishte përmbysur, duke dëmtuar suvanë.

-Hej të vravtë zoti, ku i ke sytë, apo të plasën? -kishte shpërthyer bosi gjithë inat.

Nuk i ktheu përgjigje. U kapërdi thellë. Shtërngoi duart pas mbajtëses së kovës. Nuk e dëshironte në këtë moment një grindje. Jo! Më mirë do t’i thonte dy fjalë kur të mbaronin punë. E përtypi si kotkë pështyme mllefin gjatë gjithë kohës së punës.

-Zoti Arjan, sot ishte dita ime e fundit! Nesër të lutem dua të më bësh pagesën, -foli qetë, duke u sforcuar në ruajtjen e qetësisë. -Më thuaj orën kur të vij për lekë!

-Pse mor djalë, dita e fundit?-ia ktheu tjetri gati me mospërfillje. -Apo s’ke më bythë për këto punë?

-Kam zoti Arjan, kam bythë e fuqi, por nuk duroj dot më mallkimet e tua, -vazhdoi përsëri qetë ai. -Sytë do më plasnin kur ta vendosë zoti, dhe ai vetë e di kur do të më vrasë!

Nuk vazhdoi më tej bisedën. Bosi kishte ngelur tek kamionçina e punës, kurse ai nxitoi hapat tek stacioni i autobuzit. Atëhere ngriti krye zemërimi që e kishte mposhtur dhe mbajtur të shtypur në grykë. Po ziente si të ishte një enë me presion. Gati edhe shikimi ishte turbulluar. Njerëzit në autobus brenda, i dukeshin si miza. Duhej të fliste, të nxirte dufin. Po me kë të fliste? Koka zhurmonte sikur brenda të kishte një zgjua bletësh.

-Më thotë bota je i marë, unë për ty do t’i ve zjarrë,

.....

Filloi të këndonte me zë të lartë. Por pas dy vargjeve të para, e preu me thikë zërin. E harroi tekstin e këngës.

-Ej patriot, pse nale?-dëgjoi një zë nga mbrapa dhe një dorë iu mbështet mbi sup. -Jepi, mos ki turp e gajle! Këndo si të dush e si ta dojë e bardha zemër.

-E do këndoja, po ia harrova fjalët, -ia ktheu ai tjetrit. -Nuk më pëlqet fare se ç’thonë të tjerët. Kjo botë qënka e ndyrë dhe e çmendur!

-Ditë e keqe mesa shof patriot!

-Si të gjitha ditët kur je në kurbet! -ia ktheu.

Nga fillimi i autobuzit filloi një këngë tjetër:

Hajredin pasha o po na bjen o Radikës

Jalla ç’u bot o ju mallet e Dibrës,

Boni mexhlis në atë fushë t’gjuricës...

Një tjetër patriot po ia merte këngës. Me siguri edhe ai kishte patur një ditë të keqe. Më mirë ta shfrefe dufin dhe zemërimin duke kënduar. Fundja-fundit, kjo ishte bota ku jetonin. Botë e çmendur

Dom Shani

Viti 1993. S'ka pak që janë ripahë kishat dhe xhamitë të mbylluna që më 1967. Dom Shani, ndër ma të rinjtë ndër priftat e shuguruem aso kohe, po merr në dorë frenat e famullisë së vet të re. Asht i gjatë dhe i fortë si një kalë. Ka kokë të madhe, mban syze me skelet të trashë, të zi. Energji sa të duesh. I pëlqen puna me të rinjtë dhe nuk heqë nga goja fjalën në gjermanisht "cuzamen", që më duket se do me thanë "së bashku" ose "bashkarisht".

Dom Shani ka tashma edhe një makinë që ia kanë dhurue ata të "Renovabis", një fondacion gjerman që i pëlqen të punojë "cuzamen". Asht një furgon volkswagen krejt i ri, shtatë vendsh.

Shofer i makinës u ba Njaci, djali i motrës së Dom Shanit. Njaci asht një tip po aq energjik sa daja i vet, por i mësue me punue nëpër ndërmarrjet shtetnore të komunizmit, nuk e ka fort qefë rregullin, oraret, e sidomos marrdhaniet me pronën i ka të dyshimta.

Njaci vazhdon me besue se jeton në një vend ku ai ban sikur punon dhe të tjerët bajnë sikur e paguejnë, edhe pse në këtë rast ata që e paguejnë janë daja i vet me shokë.

E pra, Dom Shani po ban përpjekje të paimagjinueshme me e futë Njacin në vathë, në rrugë të Zotit, domethanë. Kësisoj, Njaci, ma së pari asht i shtërnguem, jo vetëm me asistue ndër celebrime meshësh, por edhe me i marrë e respektue të gjitha sakramentet shenjte, përfshi këtu edhe rrëfimin.

Dje përshebull, meqënëse Dom Shani nuk e ndjente vetën mirë, kishte ardhë me dhanë meshë një prift i ri italian, që e flet shqipen boll keq, por që i ndjehen haptazi përpjekjet e jashtzakonshme nga mesha në meshë.

Ndërkaq Dom Shani, që nuk e duron veten në dyshek edhe ashtu i sëmundë si asht, i jep vetes kurajë dhe hyn ngadalë e pa u vue re në kishë, dikur nga fund i meshës. Ai hyn në një prej rrëfyestoreve për me mujtë e me e ndihmue sadopak djaloshin italian.

Dhe kjo paska pas qenë tamam ajo, darka, kur Njaci, mbas shumë luftnash me veten, paska pas vendosë me u rrëfye, duke shfrytëzue ratin e ardhjes së priftit italian.

Ka mendue me vete Njaci, se italianit mundet me ia thanë ma lirshëm edhe punët ma të këqia e më shpëtue veç me ndonjë këshillë të shqiptueme keq.

EtëashtfutëNjaciashturryeshëmnë rrëfyestore e t'ia ka nisë vetë pa e pyetë kërkush enumeracionin e mëkateve të veta, duke nisë nga ma të fundit: -Kam vjedhë një gomë makine rezervë, të re, dhe e kam shitë, padre.

Veç kur po dëgjohet një si fshamje matanë kabinës

-Ashtu?!

-E shita. Më duheshin do pare...

Dhe fill mbrapa sundoi një pauzë:

-A ti Njac qenke, ë?!

Sëfundmi, nga enti botues "Gjergj Fishta" është botuar libri:

"DARKAVE, NGA NJI MBAS BUKE"

Tre miniatura nga
Stefan Çapaliku



Internimi

Në vitin 1985 ishanjë i ri shembullor. Më donin të gjithë. Por fati im i keq që kisha lindë në katundin ma të humbun të botës: në Qafë Diell. Nuk kalonte askush nëpër atë qafë se s'kishte ku të shkonte. Pak përpara se të mbaronte fshati jonë, atje mbaronte edhe rruga. Pra ishim disi fundi i botës (Finibus terrae). Punonim të gjithë në një kooperativë të tipit të ulët. Mbillnim duhan dhe ndanim nga 20 lekë të vjetra për ditë pune. Kësisoj që të gjithë donin të iknin prej këtu, por ishte shumë e vështirë. Njanës aq i mirë, sa të më jepej e drejta e studimit nuk isha; biografi të mirë politike nuk kisha, por as edhe krejt të keqe ama...

Dhe fati e desh që të vinte njëherë në katund një prej udhëheqjes së naltë, që im atë e njihte se edhe ai ishte prej të njatit katund dhe qe bashkëmoshatar me babën. I vetmi ndryshin mes të dyve kishte qenë se diku nga fundi i Luftës, ai kishte dalë

në mal partizan, kurse baba në të njajtin mal, me bagëti.

Prita sa mbaroi mbledhja dhe i dola para duke u prezantue, si djali i shokut të tij të rinisë.

- Si e ke hallin? - pyet ai, si njeri që nuk kishte qef t'i bante bisedat tërkuzë.

- Due të më heqësh prej këtu! - i thashë.

- Po duhet të bash diçka, për me të heqë prej këndeje - tha udhëheqësi, që si duket i kish pëlqye toni im.

-Çka përshebull?

-Po qe, si me të thanë... rrah dikë përshebull.

-Si?!

-Po. Rrahe në mënyrë që të mblidhet Këshilli dhe të propozojë që të internojnë. Di unë pastaj se ku të shpie. Rrugë tjetër nuk më kujtohet tash për tash.

Kaq tha ai dhe u zhduk. Nuk kam pa në tanë jetën teme njeri ma konkret se ai, udhëheqësi i Partisë në Rreth dhe Kryetar i Komisionit të Dëbim

-Internimeve.

Atë natë ndenja krejt pa gjumë duke përfytyrue sesi do t'i rrahja një e nga një të gjithë fshatin. Si do mund të reagonin ato e të tjera marrina si këto. Mirëpo kur erdhi mëngjesi...

Kur erdhi mëngjesi vendosa që të rrah të parin që do të më dilte para. Më doli axha Ndoc, një burrë i mirë e komshi i emi prej kohe.

-Axha Ndoc me ma ba hallall bre burrë, por më duhet me të rrahë...

-Si?!!! - tha Ndoci, por nuk pati kohë me marrë përgjigje se u këput si fiku pucalec nga grushti im.

Axha Ndoc mbeti pa ndjenja. Unë nuk mund ta ndihmoja se s'kishte kuptim që ai që të rreh, po ai edhe të nihmon. Shikova rrotull se mos ishte dikush, por askush.

Atëhere e lashë axhën Ndoc ashtu lëmuç e në tokë e t'u futa te klubi duke thanë me za të naltë se kisha nevojë për një raki të mirë me ardhë në vedi se sapo kisha rrahë axhen Ndoc. Mirëpo vëreja se askush nuk po më besonte.

- Kam rrahë axhën Ndoc. Ia kam çue dhambt gjak. Ia kam rrasë kryet në pluhun. E kam lanë pa ndjenja. Ka rrezik që vdes, po nuk shkoi dikush prej jush te Shtegu i Uratës me e marrë e me u kujdesë për të.

Kur nja dy a tre ma të rinj se unë u nisën për te Shtegu i Uratës me e ndihmue Axhen Ndoc, ai nuk u gjet aty. Rrotull nuk kishte shenja dhune, kurrfarë pika gjaku nuk dukeshin. Axha Ndoc paska pas shkue vetë në shpi e mbushë hundët me duhan.

Mirëpo unë doja ta realizoja planin tim me se z'ban. Kësisoj vendosa ta rrahja për herë të dytë axhen Ndoc, kësaj here edhe ma fort dhe në sytë e dy a tre katundareve që ktheheshin në shpi me nga një rrotë buke kollomoqe në bohçe.

-A e shihni moj gra? Qe, shiheni, nëse keni sy në ballë, sesi po e rrahi axhen Ndoc, se ma ka prue në maje të hundës ma ka prue.

Vetëm mbasi që ia lashë ndër duer atyne grave axhen Ndoc, ika prej vendit të ngjarjes dhe kërkova vetë një mbledhje të Këshillit Popullor. Doja që Këshilli të tregohej i rreptë me mue, kërkoi që ndaj meje të merrej masa ma e randë.

Por nuk qe e thanë. Anëtarët e Këshillit u ngritën të gjithë të diskutonin dhe ta interpretonin këtë gjest si një gja sporadike dhe që nuk kish fare të bantë me sjelljen time të përditshme. Madje dikush tha se te unë shikonte të ardhmen e fshatit. O Zot! Qe krijue një situatë e tmerrshme, unë që doja t'ia mbathja e ata që nuk më linin.

Atëhere nisa të shtiresha si i marrë. Thyeja pullazet me gurë, gjuaja me llastiqe pulën e vetme të mbetun, që një vit ma parë në fshat, rrahja çdo ditë axhën Ndoc, i cili qe i vetmi që më kishte kuptue, se më thoshte në vesh:

-Bjer more bir, bjer, se ndonjë hall do ta kesh ti. Bjer more të pastë axha...

Dhe mbas gjithë kësaj zallamahije u desh që t'i jepja 500 lekë ndën

dorë shoqes Tarazhe, që të çohet e të propozonte hapë e shkoqë në mbledhjen e Këshillt, se unë duhesha dëbue nga fshati si element antiparti.

O Zot! Ma në fund u shka pa katundi. Shkova fill e te miku i babës në qytet e ky i fundit me caktoi me punue në fermë, këtu në breg deti, ku më kanë dhanë edhe karrocë me kalë dhe jam ba furnnitor. Shtoi kësaj edhe namin se rrahi njerez pa arësye, jam mirë. Po, po, falemnderës Zotit e Jezu Krishtit jam krejt mirë. Madje tesh që ndërroi edhe sistemi politik, shpejt kam me u ba edhe kryetar i Shoqatës së Persekutuemëve.

Ormiri

Ormir Elbasani arriti në Francë në prag të Milleniumit. Bash në zaman të luftës së Kosovës. Ai shkoi atje dhe u paraqit si një viktimë lufte, i ikun për të shpëtue kokën. (Ormir Elbasani kishte një kokë frikmënisht sferike).

Kam ikë nga Drenica, deklaroi ai në fillim, i bindun se francezët qenë familjarizue tashma me heroizmin e kësaj krahine. Dhe për ta përforcue këtë të vertetë shtoi edhe faktin se thirrej Ormir Thaçi. E ku ta dinte Ormiri i shkretë se edhe po të thoshte mbiemrin e vet të vertetë, autoritetet e atjeshme do ta pranonin si refugjat lufte. Kësisoj Ormir Elbasani u klimatizue përbukuri me emrin Ormir Thaçi atje në Francë. Madje mbas dhjetë vjetësh mori edhe pasaportën franceze me emrin Ormir Thaçi.

Ndërkaq Zoti kishte vendosë që ta linte gjithnjë e ma vetëm. Fillimisht i vdiq e ama dhe tash në fund edhe i vëllai. I vetmi që e lidhte me vendlindjen.

Me vdekjen e të vëllait Ormir Thaçi erdhi në Elbasan për të shitur shpinë dhe për t'i dhanë përfundimisht lamtumirën këtij vendi.

Mirëpo Ormir Thaçit i duhej ta shiste shpinë si Ormir Elbasani se përndryshe nuk kish si të vertetonte statusin e tij si trashëgimtar i vetëm.

Shkoi në gjendje civile dhe pyeti sesi mund të aplikonte për t'u paisë me një kartë identiteti me emrin e tij të vertetë.

-Më falni, por në rregjistrin tonë të popullsisë nuk ekziston një person që thirret Ormir Thaçi - i tha zyrtarja matanë kompiuterit.

-Si?!

-Eh, more zotni...

-Çfarë?!

-Kanë ndodhë gjithfarë sendesh në këtë vend...

-Si përshebull?

-Si përshebull dikush ka ardhë dhe mund të ketë ble identitetin tand...

-Pra mund të ketë një tjetër Ormir Elbasani në xhiro?

-Kaq më lejon ligja të ju them. Për më shumë nuk di. - kështu e mbylli bisedën zonja.

Tash Ormir Thaçi ishte krejt i lirë. Madje nisi të ndjehej si fluger...

"SA TË BUKUR, SA TË FRESKËT ISHIN TRËNDAFILAT!"


Tregim nga Harallamb Fandi

"Diku... dikur... shumë vjet më parë, mbaj mend të kem lexuar një vjershë. Vjersha ka kohë që është harruar, po vargu i saj i parë ka mbetur i pashlyer në kujtesën time: Sa të bukur, sa të freskët ishin trëndafilat!"

E gjithë kjo nuk është veçse fillimi i një proze poetike të Turgenjevit. Kur isha nxënës në vitin e tretë të gjimnazit, unë atë e kisha mësuar përmendësh në gjuhën e origjinalit, sepse ajo ishte e vetmja që mësonim në shkollë. Por ja që më pas, ashtu si Turgenjevi që e harroi vjershën dhe ruajti në kujtesë vetëm vargun e parë, edhe unë vetëm rreshtat e parë, me vargun për trëndafilat mbajta mend. Shumëkush do të çuditej se si mund të harrohej aq lehtë një bukuri ndër më mbresëlënëset dhe, për më tepër, diçka e lidhur me një kujtim që të ka përkëdhelur sedrën për një kohë të gjatë. Se për mua kujtimi ka qënë vërtet i këndshëm, ndonëse u shoqërua me shijen paksa të hidhur të një zhgënjimi që iu ngjit nga pas. Dhe, sikur të mos ishte ky i fundit, nuk do të guxoja ta tregoja, thjesht ngaqë do të rrezikojta të kaloja kufijtë e modestisë.

Ishte profesori ynë, M. Sh., që në një mëngjes të bukur, në oborrin e shkollës plot dritë e zhurmë nxënësish, më ndaloi dhe më tha: "Kam diçka interesante për ty!" Sipas tij, duhej të recitoja në origjinal gjatë një "Mbrëmjeje miqësie" në sallën e teatrit të qytetit. Profesori s'mbaroi me kaq. Në skenë do të isha vetëm unë, i veshur me frak e papijon (veshje që, "për të qënë brenda", censorët e quanin me përçmim "borgjeze", po që nuk ua mbante ta pengonin, sepse u ishte thënë që kështu do ta pëlqenin "vëllezërit sovjetikë"). Në errësirën e skenës së ndriçuar vetëm nga një qiri do të

shquhej paksa një pianiste (profesorja N.), e cila do ta shoqëronte recitimin me melodinë e njohur " Liqeni i Komo-s". Gjithshka i kushtohej kujtimit të një dashurie pa një puthje, që sot, për shumë të rinj, do të tingëllonte humbje kohe. ("Dashuri koti", do të vinte i menjë- hershëm reagimi i tyre). Po atëhere nuk ishte si sot. Tjetër gjë ishte për të gjithë ne, aq më tepër kur shumë nga mësuesit herëpashere gjenin rast dhe i mëshonin fort shprehjes: "S'ka ç'ju duhen dashuriçkat. Shikoni mësimet!" Ne, domosdo, mësimet shikonim, por, kur e binte rasti dhe, në ndonjë film apo në disa rreshta të ndonjë libri, gjenim atë që na e ndalonin, fillonte festa. Këtë festë prisnin të gjithë dhe nga unë. Po nuk paskish qënë aq e lehtë. Provat që filluan mirë, ngaqë s'kisha vështirësi me gjuhën e huaj, një ditë prej ditësh ngecën. Të gjithë prisnin më shumë, po ku ta gjeje atë më shumë...? "Djalosh, ke dashuruar ndonjëherë ti?", thujse më bërtiti në një pasdite provash profesori B. T. E dija që më donte dhe ngacmimi ishte më shumë intim, po "e haja" unë t'i thosha "Po" profesorit?... Sapo të merrej vesh përgjigja ime, do të tundej gjithë gjimnazi! "Jo", i thashë me gjysmë zëri dhe me fytyrën flakë. "Pse s'thua ti që ne po lodhemi kot "tha ai, duke vërvitur me inat një shkurës, që mbante në dorën e zbardhur nga fërkimi i tij tërë nevrik. "Profesor...", nxitova të flas pas pak për ta rregulluar disi situatën. "Ç'profesor, profesor!...", më ndërpreu ai, "Pjesa është me dashuri. Këtu mungon ndjenja. Si mund të shprehesh ti kur nuk ke dashuruar ndonjëherë?" "Po unë kam dashuruar", thashë, i penduar që e lëshova me nxitim atë bombë. Fytyra e profesorit ndryshoi dhe, nga gjithë nuancat e shprehjes, unë kapa vetëm



ngrohtësinë e vështrimit, që u përforcua me një goditje dashamirëse grushti në gjoksin tim. Që prej atij çasti ndryshova "kursin", u hapa, natyrisht jo menjëherë, se kisha frikë mos fillonin romuzet. Po edhe kaq mjaftoi që provat dhe shfaqja të pëlqeheshin aq sa, pas skenës, shokët më përqaфонin dhe nga salla nuk vonoi të vinte shprehja: "...të gjitha gratë, duke të dëgjuar, kanë qarë"

Po njëra, ama, nuk qau... Çefra. Ajo s'ishte në sallë dhe më dëgjoi më pas, në hollin e Shtëpisë së Kulturës, ku zhvillohej konkursi për shkollën e lartë për aktorë. Unë nuk shkova kot atje. Besoj se kryesorja që më shtyu ishte dëshira e pa- përmbajtur për të mos u ndarë nga arti. Deri atëhere pikturoja, shkruaja, bile kisha botuar dhe prozën e parë poetike, po s'desha të isha amator. Dhe ja, papritur, u shfaq mundësia e artë: konkursi. Konkursesit nuk ishin shumë dhe as që isha interesuar për përgatitjen e tyre, sepse... naiviteti më bënte të fluturoja: unë që kisha bërë të qanin të gjitha gratë, me reci- timin tim do t'i a nxirrja dy lotë dhe Çefras, që ishte kryetarja e komisionit dhe vendimet i merrte vetë, atypëraty. Ajo më dëgjoi me vëmendje. Kur mbarova, me shumë takt dhe me gjuhë të ëmbël, më tha: "Nuk fiton". M'u desh një kohë e gjatë për ta marrë veten dhe të bindesha që kishte të drejtë. E vërteta qe se s'kisha zë për aktor, pa le që më pas nisa ta kruaja shpeshherë laringun për ta pastruar, duke bezdisur dhe të tjerët. Gjithsesi, arti jo vetëm që nuk më la të mërzitem, po më ka dhënë për vite të tëra kënaqësi të pafund. Sidomos nga ato që s'i mbaj dot për vete. Më është bërë zakon që kur gjej diçka të bukur apo interesante, ashtu si fëmijët, dua me domosdo t'ua tregoj dhe të tjerëve. Nuk tërhiqem edhe sikur dikujt mund të mos i duket e tillë. Ja, edhe në këtë rast, me Turgenjevin. E kam pyetur shpeshherë veten: Si ka mundësi që, si Atij dhe mua, të na ketë mbetur në kujtesë vetëm fillimi i të njëjtit shkrim...? E çfarë, mund të thoshte dikush, me këtë fakt rastë- sor kërkon të na mbushësh mendjen se qëndron pranë e pranë me shkrimtarin e madh?

Unë nuk do të ndruhesha për të thënë: "Po". Sepse, si shumë të tjerë, jam i bindur që sa më i madh të jetë shkrimtari, aq më shumë të bën të ndjehesh a të shohësh deri në hollësi si ai gjëra që s'do t'i kishe parë kurrë. Një hollësi e tillë, filigranë shkurësimesh të bardha në trajta trëndafilash që hapeshin në ujë, më erdhi përpara syve në një mëngjes, shoqëruar me shushurimëllokoçitjen e valëve të detit në bregun shkëmbor të qytetit tim. Dhe nga trëndafilat...

"Kujtesa te çoi drejt e të Turgenjevi...?" - mund të vijonte pyetja e shoqëruar ndoshta edhe nga ndonjë buzëqeshje ngac- muese për "qasjen e guximshme". Po unë nuk do të mërzitesha. Përkundrazi. Do të vazhdoja pa u tërhequr që ta bëja edhe "ngacmuesin" të besonte në sineritetin tim. Sepse, duke më besuar, do ta shihja të hynte lehtësisht në të njëjtën lekundje me atë të jo pak njerëzve, të cilët arti i ka bërë të lidhen qoftë dhe me një varg të vetëm, të thjeshtë në dukje, po që në kujtesën e të gjithëve është shfaqur dhe do të shfaqet përherë si mrekulli:

"Sa të bukur, sa të freskët ishin trëndafilat!"

31 korrik 2013 - janar 2022

AMANDA

Në lule, në diell
Amandën unë ndesh
Rreth polit, rreth botës
ajo Shkëlqen,ajo buzëqesh

Në frymën e trëndafilit kur shoh
në frymëmarrjen e puhisë
në lëngun e qershisë
Amandën e njoh

Kur harpë e artë tringëllinë
kur erë perëndimi të vrullojë
në krahët që shushurijnë
Amandën unë dëgjoj

Gjithçka,engjulli rrezon
pamjen tënde hyjnore
si Krijuesi i botës qiellore
magjinë tënde pikturon

Shih, shpirtërat nxitojnë
lajmëtar të engjullit në vdekje
kah prehje e artë vrapojnë
nga përqafim i zotit në prekje

shih, lumenjët që nxitojnë
me shpejtësi shkumëzuese
kah deti ata nxitojnë
zëshëm si shpejtojnë

Por kurrë imi mallëngjim
cakun e vet s' do të arrij
I zbehur, i përqeshur, imi psherëtim
i vetmuar do të rrij

përjetësisht perëndeshë
si yll për syrin tim e ndritshme
lartë mbi mua buzëqesh
dhe mbetesh e paarritshme

(Erik Johan Stagnelius 1793-1823)

UNË PRES

Unë pres dhe ngadalë ecin orët pranë zjarrit tim
derisa yjet shtegtojnë dhe netët ikin kuturu
Unë pres një grua nga i largëti shtegtim
më të dashurën, më të dashurën me sytë blu

Unë mendoj për një lule fshehur në borë zbardhur
dhe ëndërrova një qeshje të dredhur, të pakuptuar
mendova se e pashë më të dashurën duke ardhur
nëpër një pyll, ndër shkurrete natës borë-rënduar

I kënaqur doja të ëndërruarën ta bartja në duar
nëpër kaçube aty ku kam kasollën timen shtëpi
dhe për të dashurën ta lëshoj një klithmë për të kumbuar.
Mirë se vjen, ti e pritura me vite në vetmi!

Unë pres pranë stufës sime koha pikëllohet
derisa pyjet këndojnë dhe ikin qiejt kuturu
Unë pres një shtegtare nga rruga tek afrohet
më të dashurën, më të dashurën me sytë bl

(Dan Andersson 1888-1920)

DASHURIA

Shpirti im është një kostum ngjyrë qielli,
e lash në një shkëmb pranë detit
dhe e zhveshur erdha tek ti dhe i ngjaja një gruaje.
Si grua u ula pranë tryezës tënde
dhe piva një gotë verë dhe u mirrja erë ca trëndafilëve.

Ti më pe që isha e bukur dhe i ngjaja diçkaje që ti
e kishe ëndërruar

unë harrova të gjitha, harrova fëmijërinë time dhe
vendlindjen time
e dija vetëm që ledhatimet tua më mbanin të robëruar

Dhe ti more një pasqyrë duke buzëqeshur dhe
m'u lute ta shoh veten në të
e pashë që krahët më ishin shkërmoqur
dhe ishin thyer

e pashë që bukuria ime ishte e sëmurë dhe nuk
kishte dëshirë tjetër veçse-të zhdukej
O, më shtrëngo në përqafimin tënd aq fortë
sa të mos kem nevojë për asgjë tjetër.

(Edith Södergran 1892-1923)



LIRIKA SUEDEZE

Përktheu nga origjinali
Qerim Raqi

SYTË E TU JANË ZJARR

Sytë e tu janë zjarr dhe shpirti im katran e rrëshirë
kthehu kah unë para se të ndizem si një gacë në prush
Një violinë jam unë me të gjitha këngët në kuti shtrirë
ti mund ta bësh atë të luaj, si të duash çfarë të duash

Kthehu nga unë kthehu te unë
dua të digjem dua të shuhem
Unë jam dëshira unë jam malli,
kufiri mes dimrit e pranverës

Shtrënguar janë të gjithë telat,
le të këndojnë çmendurisht të dehen të shkunden
me një të fundit këngë kumbuese
të kënaqen vitet e mia të dashurisë

Kthehu nga unë kthehu tek unë
si një mbrëmje vjeshte le të përvëlohem
gëzim i vrullshëm emblemë jonë e artë nga gjaku
derisa të qetësohet e të shoh hapat e tu tek largohen
ti, shoqëruesja ime e fundit e rinisë sime të zjarrtë

(Erik Axel Karlfeldt 1864-1931)

NË FILLIM SYTË E TU ISHIN DET

Në fillim sytë e tu ishin vetëm det
të kaltër e të gjelbër, shndërrues pasqyrues si ai
pa brigje deti, kërkues
Pastaj sytë e tu ishin vetëm njeri.
Kurrë nuk kam parë sy që hyjnë aq thellë tek një tjetër
hulumtues, kuptues plotë ngrohtësi e vullnet.
Në fund sytë e tu ishin vetëm pikëllim
të pakufishëm, të pangopshëm
për jetën dëshpërues
të thyer pikëllues
Atëherë ti më ishe më afër se gjithçka tjetër në botë.

(Kerstin Söderholm 1897--1943)

GJITHÇKA QË POSEDOJA

Gjithçka, gjithçka që posedoja
e jotja ishte më shumë se imja
çdo gjë të bukur që dëshiroja
e jotja ishte, e jotja, e jotja

Me zë të lartë me ty flisja
sa ashkush në botë s'e di
Në rrugët e pafund
ti më ishe imja vetmi

Natën kur rrija zgjuar
dhe nuk mendoja asgjë
merrja frymë, ty të ndjeja, ty
Ti më ishe çdo gjë

E pajetë është jeta
kur ty më s' të kamë
Bota një gëzhjojë e madhe
pa bërthamë.

(Karin Boye 1900-1941)

MË SË SHUMTI MË PËLQEN KUR TË SHOH DUKE ECUR

Më së shumti më pëlqen tek të shoh duke ecur
Ti nuk ecën shpejtë sikur ne
drejt një caku të largët si iluzion
që shpejtë kalon

Ti ecën si e mbyllur në veten tënde
bebëza e syrit tënd i qesh rrezës
sikur ti të jesh krejt kuptimi
i ecjes dhe ekzistencës

Lulekëmboret t' i përkëdhelin pulpat e këmbëve
dhe një fëlterez e verdhë t'i ngulë sytë
asnjë larvë dhe asnjë bretkocë
s' ka frikë që këpuca e jote e mbytë

Një dallëndyshe të fluturon mbi kry
dhe t' i prekë flokët e tua
edhe kërmijtë e rrugëve ngadalë afrohen
për t' i puthur gjurmët tua

Ti ecën me dashuri në shikimim tënd
në të shumëllojshmen botë shtazore
edhe tek gjarpri i zi i një shkurreje
ti sheh një veti të mirë, hyjnore

Po, errësira largohet kur ti ecën
dhe vdekja më s' ekziston
është vetëm një roje mike e çdo gjëje
që këtu në tokë mbretëron

(Olof Lagerkrantz 1911-2002)

SERENADË

Halat e pishave dhe gjethet e mështeknës
të vyshkura bien mbi tëndin mullar të sanës
Fli në shtratin prej kashte, e gëzuar fli, e qetë
nën hijen e reve të mesnatës

Kur deri te korniza e dritares dimri i ftohtë vie
si një adhuries i veshur në të bardha
ëndërro një ëndërr që të të mbaj ngrohtë
aty nëpër muret e çara

Ëndërro për pëshpëritjen e verës duke lozur
kur stuhia alarmon e bënë dyluftim
ëndërro që në shtëpinë e gjelbër të mështeknës
Ty të zuri gjumi në përqaftimin tim

(Erik -Axel Karlfeldt 1864-1931)

MELODI

Vetëm ti ecën lëndinave, jeton çdo burim,
çdo lëndinë këndon emrin tënd.
Qiejt dhe parqet digjen
pëshpërisin gjethet si ari dhe bien në prehërin tënd.
Dhe pranë bregdeteve të shkumëzuara unë ndjej zërin
tënd
shushurimën përkundëse të valëve si ngushëllim
M'i jep duart e dashur Errësirën ta frikësojmë.
Dhembja të dalë nga krahërori im.
Vetëm ti ecën lëndinave vetëm unë të shoh
duke ecur largësive dridhen telat e përjetshëm,
Më thuaj, nga e merr atë forcë që shndërrohet në melodi?

(Bo Bergman 1869-1967)

MË MER MË SHTËNGO – NGADALË MË LEDHATO

më merr-më shtrëngo- ngadalë më ledhato
më përqafo me kujdes edhe ndonjë çast
për të trishtin realitet paksa vajto
më shiko kur fle ëmbël për një çast

nga unë mos u largo- ti te unë do të qëndrosh
rri derisa unë vetë këtë mendje ta kemë
me dorën tënde të ngrohtë ballin t ‘ ma ledhatosh
edhe një çast më shumë bashkë me ty të jemë

(Harriet Löwenhjelm 1887-1918)

NË FOLENË E BUTË TË DUARVE TUA

Në dritën e kthjellët mëngjesore të syve tu
zemra ime zgjohet- gjithçka është dritë.

Në këngën e dashurisë së buzëve tua
gëzimi im jehon- gjithçka është këngë.

Në folenë e butë të duarve tua
shqetësimi im fle - gjithçka është e qetë.

(Erik Blomberg 1894-2965)

PËRQAFIMI

Unë pushoj në përqafimin tënd dhe dëgjoj të rrahurat e
zembrës sate
Është sikur të dëgjosh zemrën që rrahë në gjirin e vet jetës;
Flokët e tua janë pyll pranvere në të cilin ëndërroj, një pyll
i errët,
me aromë toke, lulesh dhe shiut që bie,
dëgjoj zhurmën pemëve të larta, të barit të rritur
dhe ujit të madhë.

Të ka pirë rinia, të ka përmytur dashuria;

Mbështjellur je rreth trupit tim si një hardhi rrushi
goja jote është si një pëllumb i përgjakur

Ti harron gjithë botën dhe je vetëm një ritëm,
gjaku yt rrjedhë si rrjedhë lumi e deti

dhe këndon pa dhembje, me gëzim
si këndojnë gjinkallat në barin e ngrohtë me aromë vere

(Artur Lundkvist 1906-1991)

STRUMBULLARI I DIELLIT JE TI

Strumbullari i diellit je ti
që depërton poshtë nëpër
barin tim të njomë
ndriçuar nga lëngje të ëmbla
që zgjohet nga therria jote

Diell mund të jeshë ti tani
që ngre përpjetë pyllin tim të prerë
tërheq nga vetja dhe hyn nëpër
vjollcëgshtenjën e trëndafilkuqen
drejt buzëve mbërthyesë që thërrasin
pë t’u gjetur

Valëzat godasin klap-klap
fundin e anijës sime
Gjëmime të gjata vijnë
drejt bregdetit tim
Valë të zjarrta me lavë që mbulojnë
tokën time

Tani janë qetësuar paksa
janë tërësisht të qeta e lehtë të shuara
derisa buzët përsëri të thërrasin nga larg
dhe ti të vish pa i dëgjuar

(Ann Smith 1930-2018)

GRAFITE ZJARRI

Gjatë muajve të mërzitshëm jeta ime ndizte shkëndijat
vetëm kur bëja dashuri me ty.
Sikur xixëllonja që ndizet e fiket, ndizet e fiket-
dhe përmes xixëllimave mund t’ ju shkosh pas rrugës së
tyre

mes ullinjsh qiellit të natës.

Gjatë muajve të mërzitshëm shpirti ishte pa shpresë dhe
pa jetë,
por trupi vinte drejt tek ti.
Qielli pëlliste natën.
Ne milnim vjedhurazi kosmosin dhe mbijetonim

(Tomas Tranströmer 1931-2015)

KEMI BËRË DASHURI

Tani kemi bërë dashuri
derisa perëndimi i diellit është bërë i stërkuq
jemi ledhatuar derisa lumenjët
kanë gjetur qetësinë e tyre
jemi puthur derisa majat e gonxheve kanë çelur
dhe nën qepallat e syve tanë epshorë
janë përkundur e kanë lundruar të dehur zambakët
tani kemi luajtur simfoninë e dashurisë
derisa trupat tanë violina
kanë shpërthyer vazhdisht në zgjime të reja
tani kemi përdorur fjalën për të mbjellë
dhe heshijen për të korrë
melodi e dallgëve të detit ka pikuar
çaste qetësie dhe gëzimi
në shtrëngimin e duarve tona
Tani kemi lozur lojën e dashurisë
si lojë dhe seriozitet

Kemi qeshur me kënaqësinë për të dhënë
dhe kënaqësinë për të marrë
kemi bërë dashuri përtej kohës, lirshëm
kemi pushtuar qiejtë më të thellë të gëzimeve
dhe në çastet tona më të guximshme
kemi prekur përjetësinë

(Maria Wine 1912-2003)

JANË LUMENJ SYTË E TU?

Lumenj të zi rrjedhin qiellit
pëshpëritjet e tyre vallëzojnë gjakut tim
Ç’rëndësi ka nëse i shmang
dhe e fsheh fytyrën time ndaj pushtetit
dhe bukurisë së tyre të madhe
Rrobat e mia tashmë janë djegur në plazh
më duhet tërë jetën të jetoj lakuriq
se asnjë anije nuk do të më bartë të gjallë
nga ky bregdet

Përmytmëni atëherë lumenj nga zemra ime
që është zemra e tokës dhe qiellit!
Shpërthemëni dhe ikni tutje me krahë yjesh!

O shtylla shtegëtimesh
rrathë dhembjesh e gëzimesh
le të shpërthejnë harqet e ritmeve tua
kah lëkurë e ndritshme ndër vena

Ky është zjarri që më çliron nga vetja ime
(Ruth Hillarp (1914-2003)

KURRË S'DO TA KUPTOSH

Ti kurrë nuk do ta kuptosh
se kur u largove unë qëndrova edhe më tutje aty
pranë barit të shtypur ku ishe ulur ti
unë vura dorën
mbi barin e shtypur dhe ndjeva sikur
unë të kisha më tepër nevojë të kujdesem për mungesën
tënde
se të kujdesem për ty
më dukej sikur asgjë s’ mund të kthehej
nëse do të ktheheshe
ti do t’ i prishje pushtimet e dhembjes
dhe ti kurrë nuk do ta kuptosh sa dhembshurisht dhe sa
fuqishëm
folat me hijen tënde mbi barë
më dukej sikur unë që nga ai çast kisha dhembje për ty
sikur përpiqesha të mësohem
me atë që na pret të gjithëve
dhe se çmimi për të marr njeriu një mësim
është ndjenja e braktisjes
e cila që në fillim ka përfjashtuar dhe rrënuar besimin
për një dashuri të qëndrueshme

(Bruno K. Öijer 1951)

SYTË

Për sytë e mi shqetësohem
- të tutë i dua
Sytë e mi i mbyll kujdesshëm
- të tutë i puth
Nuk di cilët do të ishte më vështirë t’ i humbja?
Më duhen katër sy për të jetuar

(Lars Englund 1917-1959)

E KËTILLË ËSHTË DASHURIA

Ajo vie rrugës së zogjve
dhe ne e kuptojmë
që s’ kemi zgjidhje tjetër
Duhet ta pranojmë
siç e pranojmë një engjull
që zbret papritmas
në tokën tonë
Ne duhet ta pranojmë
siç e pranojmë një gojëdhënë
dhe duhet ta besojmë
siç beson një fëmijë

E këtillë është dashuria
mund të zgjedhnim
por s’ kishim zgjidhje tjetër

(Bo Setterlind 1923-1991)

MJALTË BLIRI ISHTE LËKURA E TË DASHURËS SIME

Mjaltë bliri ishte lëkura e të dashurës sime.
Kurrë nuk e harroj kohën e rënies së luleve.
Hijet e pemëve dhe thirrjet e fëmijëve
ishin valë që i ndiqnim me sy të qeshur.
Aromën e verës së viteve të shkuara, e ruajmë ,
nëpër shtigjet që bulëzojnë përsëri
Mjaltë bliri është lëkura e të dashurës sime.

(Bo Carpelan 1926-2011)

ETYD PËR PUHIZËN

Më pëlqen mënyra e saj e ecjes
Më pëlqen mënyra e saj e ecjes
me erën në flokët e saj
Më pëlqen si ecën
era me flokët e saj
dhe mënyra
si hynë era në flokët e saj.
Më pëlqen ajo kur ecë .
Më pëlqen mënyra e saj
si ecë me erën në flokët e saj.
Më pëlqen mënyra e erës me flokët e saj
më pëlqen mënyra si ecën era në flokët e saj.
Më pëlqen ajo më pëlqen era
kur ecën me erën në flokët e saj
dhe mënyra e erës që pëlqen flokët e saj
Më pëlqej ajo kur ecën me erën në flokët e saj.

(Claes Andersson 1937-2019)

NJË DITË

Një ditë ti zgjohesh Nga
një boshllëk i madh
Dikush të mbanë kokën
duke të dhënë me lugë
dromca jete
**
Kur bëjmë dashuri
gjërat përreth meje janë miqësore
Pa më pyetur
depërtojnë në shqisat e trupit tim
ashtu siç janë, në lirinë e tyre,
Jashtë çdo domethënje
më përfshijnë në një dehje kureshtjeje
**

Ekziston
thellë në mua
një pikë qetësie
që askush s’ mund ta prishë.
Sikur të mund
ta mirrja një copë në dorën time
dhe t’ia jipja dikujt
asaj që e dua

(Göran Sonnevi 1939 -)

Para se të merrja udhën për në Veliko Tërnovo në verë të vitit 2003, në bllokun e shënimeve, ku kisha listën e disa gjërave, që më interesonin, kisha shënuar edhe një emër: Bllaga Dimitrova. Jo thjesht se ajo kishte pasë kaluar fëmininë dhe mësimet e para i kishte marrë në atë qytet, por edhe për dy-tri arsye të tjera...

... Për herë të parë emrin e Bllaga Dimitrovës e pata hasur në kapakun e një poeme me titullin “Liljana” në vitin e largët 1959. I kushtohej Liljana Dimitrovës, një luftëtare antifashiste me jetë interesante, e cila, gjatë Luftës II Botërore, qysh herët merr pjesë në veprimtarinë dhe drejtimin e Bashkimit të Rinisë Punëtore; kalon në ilegalitet më 1941, internohet, arratiset dhe, ndonëse vuante nga sytë me një miopi të theksuar, e vijon veprimtarinë ilegale, duke organizuar demonstrata e aksione. Dërgohet me detyrë nga Sofia në Plovdiv, ku një ditë të vitit 1944 rrethohet nga milicia dhe nuk dorëzohet e gjallë, duke rënë kështu në moshën 25-vjeçare (1918-1944). Me këtë heroinë të poemës, autorja rastësisht kishte të përbashkët mbiemrin, po edhe dy anë të tjera: ilegalja pati mbajtur pseudonimin *Bllaga*, po edhe vetë autorja e poemës kishte qenë anëtare e së njëjtës organizatë rinore antifashiste gjatë luftës.

Për një kohë të gjatë, deri në fillim të viteve '90, në kujtesën time kishte mbetur vetëm si një nga poetet më të shquara të Bullgarisë, kurdoherë me portretin e një gruaje të bukur, madje emrin e saj vazhdimisht e përqasja me atë të Elisaveta Bagrjanës, një tjetër shkëlqim i poezisë bullgare të shekullit XX. Mirëpo, pas rënies së regjimit totalitar të Todor Zhivkovit në nëntor 1989, me fitoren e Bashkimit të Forcave Demokratike, ajo shfaqet edhe si politikanë e nivelit të lartë – zgjidhet me votim nga populli si zëvendës-presidente e vendit bashkë me Zhélju Zhélevin si president.

Veçse motivi i vërtetë, që më shtyu të rrëfej për të, nuk ka lidhje me sa më sipër, por me do hollësi të tjera:

- me “takimin” me të, nëpërmjet një libri, i cili, edhe pse jo ndër më kryesorët e më të vëllimshmit të saj, është një libër i veçantë, qoftë për biografinë letrare e politike të shkrimtares së shquar, qoftë për kohën kur u shkrua, qoftë edhe për lexuesin shqiptar;

- me dëshirën dhe, më pas, me pamundësinë për t’u takuar me të sy më sy, më 2003;

- me ndeshtrashat e jetës së saj si shkrimtare, redaktore, përkthyes, veprimtare shoqërore, si karakter antikonformist.

Duhet të ketë qenë një ditë e vitit 2000, kur, në një nga sallat e Tiranës, mora pjesë në paraqitjen e përmbledhjes me poezi dhe ese *Ballkaniada*, të Bllaga Dimitrovës. Titulli në origjinal ishte BALLKANIADA-ADA, i botuar në Sofie vetëm para një viti, më 1999. Poeti dhe studiuesi i njohur Agim Vinca e kishte shqipëruar pasi e kishte marrë, po atë vit, në festivalin ndërkombëtar “Mbrëmjet e Poezisë” në Strugë. Në shqip ishte botuar në Prishtinë. Sikundër shkruan në vend të parathënies, Vinca qe befasuar kur në këtë libër gjeti një cikël me poezi kushtuar Kosovës. “Lufta sapo kishte mbaruar, - shkruan ai, - njerëzit e dëbuar me dhunë po ktheheshin në vatrat e veta,

PËR NJË “MBRETËRËSHË” TË POEZISË

Bllaga Dimitrova
(2.01.1922 -- 2.05.2003)

Nga Abdurrahim Myftiu

kurse ajo, një poeteshë e njohur, po dilte para lexuesve me një libër kushtuar kësaj drame.”

Mbase e vutë re, titulli në origjinal ka shtojcën “ADA”, fjalë që në bullgarisht ka kuptimin “ferr”, “skëterrë”. Ky cilësim buron nga ndjesia eprore e heroit lirik të të gjitha poezive të cikleve për Bosnjën dhe për Kosovën – ndjesia e dhimbjes së thellë dhe tronditjes shungulluese, që e bën poeten të këlthasë nga njëra poezi në tjetrën: “Gjëmë, gjëmë!”, “Një kosë e tmerrshme kosit Kosovën”, “Kush do ta ndalë këtë krim?”; që e bën poeten, tashmë në moshën e tretë, ta cilësojë shekullin e saj të 20-të në një titull poezie “Shekull refugjat”, shoqëruar me nëntitullin “Kosova është afër”.

Në një cikël tjetër, të datuar “Verë 1999”, me poezi trivargshe, poetja na grish të shohim e të dëgjojmë, duke vizualizuar edhe mendimin më të thellë në skena gati kinematografike: “Pema shartohet / degë më degë. / Dhimbja – fjalë pas fjale.”; “Në Kosovë çirren mëllenjat, / këndojnë bilbilat, cicërojnë harabelat. / Mes tyre nuk ka spastrim etnik.” “Natë mbi Kosovë: “Det i pafund errësire. / As yll, as dritë, as zjarr. / Veç një klithmë zogu mbi varr.”



Kurse në tufën e eseve në fund të librit, në vijim të poezive lakonike me tri vargje, Bllaga Dimitrova përsiat si ballkanase e vërtetë, mediton për “Homo Ballkanikusin”. Përsëri me një ndjenjë të thellë dhimbjeje për fatin e ballkanasit: “Fat muhaxhiri, refugjati. Ky është një mallkim i përgjeshëm i tij: gjithçka ta fillojë nga e para dhe kurrë të mos e shpjerë gjer në fund të filluarën.” Më tej: “Ne kemi njohur gjatë kohëve robërinë shekullore, konfliktet ndëretnike, luftërat vëllavrasëse e gjakderdhjet djallëzore, të nxitura shumë herë nga fuqi të jashtme, kurse në këta 50 vjetët e fundit – totalitarizmin dhe censurën e ashpër...” Ndërkohë, në një trivargësh më parë, ajo kishte vërejtur: “Në Gadishullin e diellosur Ballkanik / secili është i madh, i parë, me nam, botëror! / Pak si shumë për të na mbajtur mend bota.”¹

Pasi kaloi java e parë në Veliko Tërnovo, shënimi i emrit të saj në bllokun tim qysh në Tiranë më nxiti të interesohem me dëshirën për të mësuar diçka më shumë për të. Jo thjesht prej librit në fjalë, që, duhet thënë se është një pikë uji në detin e korpusit letrar e publicistik të saj prej mëse 60 librash – poeteshë, prozatore, përkthyes, skenariste filmash, personalitet publik e politik. E dija se kishte lindur në Bjalla Sllatina, pranë qytetit Vraca, por fëmininë e kishte kaluar në Veliko Tërnovo, pra në qytetin ku do të qëndroja tri javë. E dija se gjithë periudhën tjetër të jetës e kalonte në Sofie, por mbase dikush do të më ndihmonte ta takoja atje më pas. Po përfytyroja si do të ishte në moshën e tanishme ai përshkrim i dikurshëm nga leximet dhe fotografitë – grua e bukur, me sy të kaltër të kthjellët, shtatëgjatë, leshverdhë. Mirëpo, në Veliko Tërnovo, në programet e ndryshme të Seminarit të Bullgaristikës, emri i saj as nuk u zu me gojë (?!). Një ditë pyeta dhe u ndjeva në siklet: mësova se ishte ndarë nga jeta vetëm tre muaj më parë, në 2 maj të atij viti, pra ishte rasti për ta përmendur. M’u dha të kërkoj në bibliotekë shtypin letrar të muajve të fundit. Më bëri përshtypje, kur lexova në faqet e një gazete se, në kremtimin e 80-vjetorit të lindjes së saj në kryeqytet, në janar 2002, kishin marrë pjesë vetëm tre shkrimtarë (?!). Mirëpo këtu në Veliko Tërnovo duhet të krenoheshin me të. Në një intervistë me rastin e këtij jubileu, pyetjes nëse *Fjala* kishte qenë gjëja më e rëndësishme në jetën e saj, Bllaga Dimitrova i qe përgjigjur: “Si jo, ashtu ka qenë. Qysh nga Veliko Tërnovo, atje ushqejnë nderim të madh për Fjalën. Nuk e di nëse në Tërnovo vazhdon kështu, kohët e fundit nuk e kam ndjerë këtë atmosferë, por nga fëminia ime mbaj mend, nënën e kam patur mësuese, edhe bibliotekën e Tërnovos, bibliotekën e dëgjuar... Më hapën kartelë anëtarësie herët, fare e vogël shkoja për të marrë libra. Dhe, për të vajtur atje, kaloja para shtëpisë së Petko Raçov Sllavejkovit dhe Penço Sllavejkovit, me ndjesinë e pandërprerë se përbri meje endeshin Fjala dhe krijuesit e Fjalës...”

Ja, pra, pse qe e pamundur ta takoja sy më sy... Isha vonuar. Ose ajo kishte ikur para kohe... Edhe pse në moshën 81-vjeçare (1922-2003).

Çka më nxori nga sikleti qe mendimi se poetët janë të pavdekshëm, sepse, me veprën e tyre, gjallojnë në të tashmen e në të ardhmen.

Pikërisht me veprën e saj të pasur e të shumanshme gjallon edhe sot Bllaga Dimitrova: me dhjetra përmbledhje poetike, pesë romane, libra me esé, përshtypje udhëtimi, përkthime, jetëshkrime, kritika letrare, publicistika, qysh para Luftës e deri në fillim të mileniumit të ri; redaktore në të përmuajshmen kryesore letrare “Septémvri” më 1950-1958. Detyra më e lartë e saj si krijuese qe redaktore letrare e thjeshtë, ashtu edhe doli në pension. Në vitin 2003, kur edhe u largua nga jeta, u botua vëllimi i parë i veprave të zgjedhura prej 22 vëllimesh, të dhjetin e pashë më 2009, vetkuptohet vëllimet e tjerë do të kenë dalë më pas. Në vitin 2015 është autorja bullgare më e shitur: në krye të renditjes “Greenwich” – për numrin e kopjeve të shitura të të gjithë titujve ndër autoret femra në periudhën 8 mars 2015 - 7 mars 2016.

Jeta letrare e saj pati baticat e zbaticat e veta. Në vitet ’70 u kritikua për pikëpamje “të gabuara” dhe nuk iu pranuan një sërë përmbledhjesh poetike. Peripeci pati me romanin e saj të tretë “Licé” (“Fytyrë”), i botuar më 1981. Kritika zyrtare e shpartalloi nga ana “ideore” e “estetike”, duke e karakterizuar si vepër, që vinte në shënjestër “fytyrën” e socializmit real në atë periudhë, duke vënë në pah shëmtimet e tij dhe shfytyrimin e personalitetit të njeriut në regjimin totalitar. Dhjetëra artikuj në shtyp e cilësuan vepër heretike, që nxinte realitetin. Kur u hoq nga qarkullimi, një pjesë e tirazhit pati vajtur tashmë te lexuesi, dhe pjesa tjetër u dërgua në një depo të posaçme burgu në rrethin Sliven. U lejua të qarkullojë vetëm më 1989, kur edhe ra Muri i Berlinit. Më



pas pati dy botime të tjera, më 1990 dhe 1997, duke përfshirë edhe shkurtimet e variantit të botimit të parë. Probleme pati edhe me poezinë. Përmbledhja “Kljuç” (“Kyç”), e dorëzuar për botim më 1988,

doli nga shtypi vetëm pas kthesës politike, më 1991.

Tri herë e patën ftuar të hynte në Partinë Komuniste Bullgare, por nuk kishte pranuar, edhe pse gjatë Luftës kishte qenë anëtare e organizatës së rinisë të asaj partie.

Dhe vjen logjike veprimtaria shoqërore e politike disidente e saj, në gjysmën e dytë të viteve ’80, kur në “kampin socialist” kishte nisur fushata liberale e “perestrojkës dhe gllasnosit” (“reformimit dhe transparencës”). Për shkak të kësaj veprimtarie në shoqata letrare e organizata joqeveritare, më 1987-1989 i hiqet e drejta e botimit. Më 1988 është ndër themeluesit e organizatës joqeveritare “Komiteti për mbrojtjen ekologjike të qytetit Ruse” dhe i “Klubit në përkrahje të gllasnosit dhe perestrojkës”. Më 1989, në pranverë, ajo proteston fuqishëm kundër fushatës së spastrimit etnik të turqve të Bullgarisë, duke folur haptaz në Radion “Europa e Lirë”, çka i bëri grupet nacionaliste shoviniste të manifestonin në verë para shtëpisë së saj në Sofie me thirrjet “Tradhtare! Tradhtare!” Merr pjesë në themelimin e partisë opozitare Bashkimi i Forcave Demokratike më 7 dhjetor 1989, zgjidhet deputete e kësaj partie në votimet për Kuvendin më 13 tetor 1991, kurse në janar 1992 bëhet e para zv/presidente grua e Bullgarisë, e zgjedhur në mënyrë demokratike të drejtpërdrejtë nga populli, bashkë me presidentin Zhelju Zhelev. Mirëpo, pak kohë më pas, e ndjeu veten të tepërt në koridoret e pushtetit, u zhgënjye nga politizimi i skajshëm, nga gjuha e urrejtjes dhe kundërvënia “blu / të kuq”. Dha dorëheqjen më 30 qershor 1993, iu kthye vokacionit të saj themelor dhe u muar vetëm me krijimtari letrare. „Me anë të kësaj dorëheqjeje, - u shpreh ajo, - unë po zgjidh duart e lidhura të mija, për të qenë qytetare e lirë, e jo për të

qenë, pa dashjen dhe vullnetin tim, peng veprimesh të fshehta... Tek ne po i hapet rrugë një diktature.“

Edhe ky kthim qe i natyrshëm, po të kemi parasysh zhgënjimet e vjetra dhe të reja në jetën e saj.²

Dhe, pas këtij kthimi, ajo mbeti një nga zërat lirikë më të fuqishëm në historinë e letërsisë bullgare, “mbretëresha e poezisë bashkëkohore bullgare”, sikundër e ka quajtur kritika.

Kurse autorit të këtyre radhëve për Bllaga Dimitrovën, veç dhimbjes së thellë të saj për njeriun e për Ballkanin, i mbeti gjallë edhe pengua, i vogël në dukje, por gjithsesi i pashlyer – pengua i pamundësisë për t’i shtrënguar dorën.

Nga vonesa ime, apo nga nxitimi i saj për t’u ndarë nga bota dhe njerëzit për të cilët krijoi?

Nuk e di...



Të gjitha citimet janë sipas përkthimit nga A. Vinca.

Ja një vjershë e marrë po nga përmbledhja “Ballkaniada”, kësaj here kushtuar një figure emblematike bullgare të diasporës në SHBA – Hristo Javashëv (1935-2020), lëvrues i artit mjedisor (*environmental art*), i *nouveau réalisme*, piktur instalacionesh, i shquar botërisht si paketues a mbështjellës artistik i shumë objekteve, ndërtesave, monumenteve, që përmenden edhe nga autorja:

*Kristo, ti dreq i vërtetë!
Lavdi dhe nder i Bullgarisë!
Shpikës vellos!
Iluzionist sensacionesh!
Fantast i shekullit!
Paketues i Niagarës,
i Urës Mirabó,
i Rajhshtagut,
i Empajër Stejt Billdingut.
i Hiroshimës me çadra japoneze!
Ti, që mund të paketosh gjithçka –
thatësirën, erën, detin,
retë dhe majat me borë!
Paketoje frikën e atdheut im!
2022*

Edited by Bejtullah Destani and Vullnet Muharemi

The School of the Albanians in Venice



The Centre for Albanian Studies